

GRATIS SHQ
ENG

Prishtinart

KORRIK 2024

Rama:

Do t'ia rikthejmë
këto pasuri
Prishtinës

Tullëtorja

destinacion i
ri urban për
art e teknologji

Meli Qena:

E dua
këtë teatër

Ish-Gërmia shtëpia e re e artit dhe artistëve



Rinjohja e
qytetit

Faqe 11

Arti dhe
rezistenca

Faqe 18

Rituali i shahut -
identitet urban i
Prishtinës

Faqe 78

Krijuesi i
tingujve të
përjetshëm

Faqe 88



Prishtina është qyteti që ka gjithmonë të hapura dyert për të gjithë. Është ai “kazani i shkrirjes”, që secilin e përfshin në vlerat e veta dhe shpejt bën që ta ndiejë si qytetin e vet më të dashur.

Foto (Ermal Meta): Motiv nga shtëpia monumentale e Hivzi Sylejmanit, tash pjesë e “Rezidencës 17”

Prishtina is a city that always keeps its doors open for everyone. It is a ‘melting pot’ that draws everyone with its values, making them feel as their beloved city.

Photo (Ermal Meta): A motif from the monumental house of Hivzi Sylejmani, now part of “Rezidenca 17”



Experience Luxury at Swiss Diamond Hotel Prishtina

Located in the heart of Prishtina, Swiss Diamond Hotel offers a perfect blend of classic charm and modern comfort. Enjoy opulent rooms, a world-class Spa, gourmet dining, and impeccable service. Whether for business or leisure, discover the pinnacle of hospitality in Kosovo's vibrant capital.

Swiss Diamond Hotel Prishtina - Where luxury meets comfort



Sheshi Nëna Terezë, nr. 3 10000 Prishtinë, Kosovë,
Tel. +383 38 220 000, reservations@sdhprishtina.com, www.sdhprishtina.com

Drejtore e kulturës
Sibel Halimi

Kryeredaktor
Artan Krasniqi

Gazetare/Redaktore
Alberina Haxhijaj
Jeta Zymberi

Lektore
Adelinë Selmani

Përkthyes
Salih Mehmeti

Bashkëpunëtorë/Kolumnistë

Ibrahim Berisha
Agron Krasniqi
Labinot Kelmendi
Elvira Berisha
Sihana Klisurica
Saranda Krasniqi
Nazim Zullufi
Erletë Rrustemi
Albert Krasniqi

Fotografë
Ermal Meta
Arben Hoti
Arben Llapashtica
Andi Qarri

Layout & disenj
Enis Vidishiqi

Marketing
info@utk-ks.org

Shtypi
Blendi

Përkrahur nga:
Drejtorja për Kulturë,
Komuna e Prishtinës
Unioni i Turizmit të Kosovës



Komuna e Prishtinës
Republika e Kosovës



Unioni i Turizmit të
Kosovës
Tourism Union of
Kosova

SHQIP

Rinjhja e qytetit



Jetë paralele përmes lenteve:
Një mënyrë e re të shikuarit të
kaluarën

Arti dhe rezistenca

Kultura gjatë viteve '90: Kur
arti zhvillohej me ngulm e pa
kompromis

Prishtina, 25 vjet frymon
lirshëm

Hapësirat e braktisura në fokus
- Rama: Do t'ia rikthejmë këto
pasuri Prishtinës

Tullëtorja - destinacion i ri
për art e teknologji

Ish-Gërmia - shtëpia e re e artistit
dhe artistëve

Meli Qena: E dua këtë teatër

ENGLISH

11 Knowing the City

14 Parallel lives through the camera
lens: New Ways to Assess the Past

18 Art and Resistance

22 Culture during the 1990s: When
Art Developed Persistently and
Uncompromisingly

26 Prishtina, 25 Years since Its
Freedom

34 A Focus on Abandoned Spaces
- Rama: We Will Return These
Assets to Prishtina

38 The Brick Factory - A New
Urban Destination for Art and
Technology

40 Gërmia - The New Home for Art
and Artists

46 Meli Qena: I Love This Theatre





Me këtë përmbajtje, në një kohë kur shtypi në letër ka nisur t'i takojë të së kaluarës, jemi krenarë të Ju ftojmë që të shëtisni me ne nëpër Prishtinën e artit dhe të kulturës.

With this rich content, in an era where printed press is fast becoming a thing of the past, we proudly invite you to journey with us through Prishtina's art and culture.

T` knoft` zemra në RLIOF për vlerat e trashëguara	50	"May your heart sing" for Inherited Values
Prishtina ka publik me shije të hollë për balet	53	Prishtina's Public Has a Fine Taste for Ballet
Artistja që bashkon muzikën me poezinë dhe imazhin	56	An Artist Merging Music with Poetry and Image
Ambasadorët kulturorë	58	Cultural Ambassadors
Rituali i shahut - identitet urban i Prishtinës	78	Chess ritual - an urban identity of Prishtina
Dy orë udhërrëfim për Prishtinën	84	Two Hours of Prishtina's Story
Arti në qeramikë	90	Art in pottery
E ardhmja e robave të mençura	93	The Future of Smart Wearable Technology
Vrapuesja e Prishtinës	102	Runner of Prishtina
Me botën butësisht të egër të Gërmisë	106	In the Gently Untamed World of Gërmia
Hajde në Gollak	110	Come to Gollak
Bagëti me GPS	113	Livestock with GPS

Përsiatje mbi artin, individualitetin krijues dhe edukimin për një shoqëri të lirë

A Reflection on Art, Creative Individuality and Education for an Open Society



Sibel HALIMI
DREJTORE E KULTURËS NË KOMUNËN
E PRISHTINËS

DIRECTOR OF CULTURE AT THE MUNICIPALITY
OF PRISTINA

Zhvillimi i kulturës dhe i artit nuk do të mund të arrihet derisa merret hise nga buxheti i kulturës për punë të tjera qeverisëse.

Ndarja e buxhetit për kulturën duhet të peshojë ngjashëm si projektet e tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e jetës dhe të mirëqenies së qytetarëve, pavarësisht se qytetarët rëndom kanë kërkesa ekzistenciale e më pak shpirtërore, megjithatë ky prioritet duhet të planifikohet nga lart – poshtë.

Në kontekstin e brendshëm, çdo shmangie nga investimet në kulturë është varfërim i jetës shpirtërore dhe reduktim drastik i dialogut shoqëror, e pasojat rëndom reflektohen te brezat e ardhshëm.

Në kontekstin më të gjerë, arti sot është komunikimi më i avancuar ndërmjet popujve e qytetërimeve,

prandaj ne duhet ta rikthejmë vëmendjen te kultivimi dhe zhvillimi i tij.

Një shoqëri e hapur dhe e lirë duhet të pyetet për secilën prej e gërvishtje të hapësirës së saj, duke mos pretenduar instrumentalizimin e përcaktuar në tonalitetin dhe tipologjinë e artit, por duke mundësuar krijimin e paradigmave shoqërore të zhvillimit të individit, çlirimin e tij, përmes krijimit.

Përtej kohës së jetuar, arti është përpjekje për të krijuar një 'rend' të ri shoqëror, atë të pranimit të tjetrit si i ndryshëm, i cili nuk rrezikon askënd, por duke frymuar lirshëm vetë, prodhon liri. Prania e "tjetrit" në artin krijues është thelbësore për vetëdijen dhe për

ekzistencën tonë si qenie të vetëdijshme shoqërore. Ndaj, çdo përpjekje për të krijuar art në një shoqëri, kur individi mbetet nën pranga të hekurta të traditës së organizimit sipas një "rendi të kazermës" të jetës shoqërore, nxit rebelim e revoltë, por së këndejmi këto janë edhe shenjat e para të shpërndarjes së individit nga mendësia e masës dhe rikthimi i tij si i ndryshëm në kolektivitet, së pari si sfidues pastaj si demiurg.

A vlejë sot si modele individualiteti pushtimi i qiellit me Abetare në kryeqendrën metropolitane të New York-ut, të Petrit Halilajt, Arti feminist i Zana Hoxhës, vokali shpërthyes i Dua Lipës në gjithë botën, dramaturgjia e

The development of culture and art remains incomplete as long as funds intended for culture are redirected to other projects. Budget allocation for culture should be as balanced as other essential projects that ensure citizens' life and well-being. Despite the latter having more social demands than spiritual ones, this priority needs to be planned from the top down. In this respect, every refrainment from cultural investment impoverishes spiritual life and social dialogue, affecting future generations.

In a broader context, art today serves as the most advanced communication between people and civilizations, urging us to be attentive to its cultivation and development.

An open and free society should be taken into consideration for every touch or scratch on its space, without claiming to instrumentalize art but creating societal paradigms through individual development. Beyond experienced time,

art consists of an effort to envisage a new societal 'order' that accepts the Other as different, who poses no threat to anyone, but by operating freely produces freedom. The presence of the Other in creative art is essential for our consciousness and existence as social beings.

Hence, every attempt to create art in a society where the individual remains stuck in the iron chains of the organizing tradition of society according to a 'military barrack order' stirs rebellion. However, these are the first signs of an individual detaching from mob mentality and returning to collectivity as different, first as a challenger and then as a demiurge.

Do the achievements such as Petrit Halilaj's Abetare who conquers the skies in New York, Zana Hoxha's feminist art, Dua Lipa's outstanding vocals, Jeton Neziraj's plays, Jakup Ferri's pictures, and the murals of Meeting of Styles Kosova festival serve as

Jeton Nezirajt, piktura e Jakup Ferrit dhe muralet e festivalit Meeting of Styles Kosova?

Secili e secila nga ta kanë shfrytëzuar hapësirën boshe brenda paradigmave të gjithëpranueshme, hapësirën brenda hapësirës, (brenda mediumit, qytetit, urbisit) për ta institucionalizuar individualizmin e tyre, që tashmë është bërë kolektivisht i pranueshëm.

“Asnjëherë nuk do të donim që arti të jetë vazhdimësi lineare e mendimit kolektivist, por të hapë shtegun e diversitetit për ta pranuar fillimisht dhe për ta dashur e aspiruar pastaj të ndryshmen, por edhe jokonvencionalen, alternativën.

Kryeqyteti duhet të jetë shembulli i një modeli të ri të rezistencës ndaj kuazivlerave të imponuara, cilatdo qofshin ato. Projektuesit e përkufizojnë hapësirën kurse artistët krijuar e modelojnë brenda saj hapësirën tematike e estetike.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ndërlidhshmëria në mes artit dhe artistit që e krijon atë, si hallka që pashmagashmërisht ndikon edhe në arsimimin dhe emancipimin shoqëror.

Mendimi kritik i zhvilluar në fëmijëri është vazhdimësia e individit të lirë, e rrjedhimisht edhe i krijimit të një mjedisi shoqëror i cili përjashton në vete dhunën dhe gjuhën e urrejtjes.

Ernesto Sabato ndërlidhshmërinë e artit me shoqërinë do ta shihte si fatalitet, meqë sipas tij arti bëhet duke u nisur nga njeriu, ndërsa njeriu, qoftë nëse është edhe gjeni nuk është i izoluar: ai jeton, mendon dhe ndien në raport me rrethanat e tij.

Pikënisja për të vendosur artin dhe shoqërinë në një tablo analize, mbase na shpie në konceptimin e shoqërisë si një totalitet, që e minimizon të ndryshmen

brenda saj.

Arti është “shmangia” e domosdoshme dhe e vetme nga format e ekzistencës njerëzore, për të shpëtuar individin dhe shoqërinë nga abuzimi prej politikës, ideologjive, religjioneve, teknologjisë dhe trendeve mondane të imponuara, si dhe formacioneve të tjera dogmatike, synimi i të cilave është mbajtja e njeriut “në rresht”, mbikëqyrja dhe kontrolli i tij, në biopolitikë (Giorgio Agamben) Toni Morrison-i më të drejtë shkruante se arti i vërtetë duhet të reflektojë të gjitha aspektet e shoqërisë dhe të sjellë një dritë të re mbi to. Përditshmëria është mbushur me tregime dhe veprime të cilat konzervojnë të vërtetën mbi ekzistencën tonë.

Një art ndikues në krijimin e shoqërisë së hapur është mënyra e jetesës së individit në përditshmëri.

Kjo perspektivë e mbështetur në të jetuarit ekzaminon praktika e ndjeshmëri të individëve në kontekstet e tyre shoqërore, transformon shoqërinë nga kolektivistja tek individualiteti, rikthen vëmendjen te grupet e marginalizuara, te problemet sociale e politike, si dhe vendos subjektin përjetues në qendër.

“Konteksti historik i kulturës dhe i artit në Kosovë është karakterizuar me një përpjekje çliruese nga një gjuhë dhe dominim politik.

Arti i rezistencës është pikërisht përfaqësuese e fatit kolektivist. Si rezultat, vëmendja tek individit mbetet e vobektë dhe si e tillë mbetet nën hijen e mbijetesës identitare. Përkundër kalimit të një periudhe të gjatë të pasluftës, epistemologjia e artit mbeti refleksion i të përjetuarës kolektive. Viteve të fundit, individit krijuar transformon veten drejt një arti, i cili shpërthen me gjithë forcën e tij.

Në këtë kontekst, sot arti përfaqëson shoqërinë në shumëdimensionalitetin e njeriut, i cili nuk është më në simbiozë të pandarë me shoqërinë, por individit me

models of individuality? Each of them has utilized the void space within commonly accepted paradigms, spaces within spaces (within medium, city or Urbis), to establish their individualism, which now has become collectively accepted.

“We would never wish for art to be a linear continuation of collectivist thinking but to pave the way for diversity, first to accept, then to love and aspire to what is different, even what is non-conventional and alternative.

Prishtina should be a prime example of a new resistance model towards imposed quasi-values. Planners define the space, while creative artists shape thematic and aesthetic space within it.

Another important facet is the connection between art and the artist, which inevitably impacts social education and emancipation.

Critical thinking developed since childhood provides an emancipated free individual, consequently enabling a social environment that excludes violence and hate speech. Ernesto Sabato saw the connection between art and society as a fatality, holding that art is created with human as its point of departure, and human, even if he is a genius, cannot survive alone: he lives, thinks, and feels in relation to his circumstances. Placing art and society within an analytical frame perhaps lead us to perceive society as a whole that diminishes what is different in it.

Art represents the only and necessary ‘deviation’ from forms of human existence to safeguard individuals and society from the abuse of politics, ideologies, religions, technology, and other imposed

të jetuarit, që ecën vetëm në rrugën e tij krijuese.

Prandaj, zhvillimi i individualitetit është mundësia e vetme për të krijuar një shoqëri të emancipuar e të hapur, dhe ku arti mund t'i ndihmojë në mënyrë të drejtë, si mirëmbajtës i institucionalizimit të individualitetit, duke filluar nga të gjitha fazat e zhvillimit të tij, por më e rëndësishmja mbeten arsimimi cilësor, mendimi kritik dhe kultivimi i shijeve estetike.

Meqë, definimet për të jetuarit në përditshmëri, e nxjerrin arsimin si formësues të pikëpamjeve për përcaktimin e tipologjisë së shoqërisë, atëherë arti dhe kultura marrin rolin e orientimit të saj nga kolektivja drejt individuale, duke rivendosur një raport të ndërsjellë.

Përfshirja e narracionit mbi pranimin e individit në garniturën e arsimit, pa e paragjykuar atë, shpërthen bërthamën homogjene. Cytja drejt shtrimit të pyetjeve rreth diversitetit integron natyrshëm të ndryshmen në përditshmërinë e të njëjtës, homogjenes.

Habitusi shkollor legjitimon subjektivitetin e marrëdhënieve. Në masë të madhe përcakton individin, mënyrën e tij të sjelljes, sistemin e vlerave, në këtë kuptim, habitusi do të duhet të ishte individual. Dinamikat shoqërore janë vazhdimësia e një sistemit të tillë arsimor, duke nxitur edhe shumë ndryshime përbrenda jetës së përditshme që janë reflektuar në botëkuptime dhe sjellje të individit.

Një shkollë në vëmendje tek individ i sjell atij më shumë opsione në dispozicion për formësimin e jetës, madje ndryshimet në strukturën e familjes janë nisur nga procesi i individualizimit.

Individualizimi apo "institucionalizimi i individualizimit", përfaqëson ndryshimin strukturor të institucioneve sociale, marrëdhënieve, si dhe ndryshimin midis një individit dhe shoqërisë.

Arti duhet t'i ndihmojë këtij zhvillimi social, sepse arti ruan në thelbin e vet diversen, të ndryshmen.

Arti synon ta shpëtojë individin nga "rreshiti" i turmës, derisa arsimi mësyn ndryshimet thelbësore brenda vetes, për ta shndërruar turmën në një shoqëri qytetare, të lirë dhe të emancipuar.

mundane patterns, as well as from other dogmatic formations whose aim is to keep human 'in line', to supervise and control him, in biopolitics (Giorgio Agamben). Toni Morrison rightly stated that true art should reflect all aspects of society and to bring a new light to them. Our daily life is replete with stories and deeds that preserve the truth about our existence. Impactful art in forging an open society is individuals' way of life in daily life.

This particular perspective, relying on what is experienced, examines the practices and sensitivities of individuals in their social contexts, transforming society from collectivity to individuality, focusing attention on marginalized groups, social and political problems, and places the experiencing subject at the very center.

The historical context of culture and art in Kosovo has been characterized by a liberating effort against political language and domination.

Resistance art represents collective destiny. Hence, the focus on the individual remains poor and falls under the shadow of identity survival. Despite a long period after the war, art epistemology remained a reflection of collective experience. In recent years, creative individuals have transformed themselves towards art that erupts with all its vigor.

In this light, today art represents society in the multi-dimensionality of human who is no longer in inherent symbiosis with society, but individuals with the experienced, who track their creative paths alone.

Therefore, the development of individualism is the only way to forge an emancipated and open society where art helps institutionalize individuality in all its stages, with the

most important ones being quality education, critical thinking, and cultivation of aesthetic tastes.

Given that many definition rank education as formative for determining typologies of a society, both art and culture assume their roles in orientating society from collectivity to individuality by establishing a mutual relation.

Inclusion of narratives about individual acceptance in education, without prejudicing him, dissolves the homogenous shell. Encouraging questions about diversity naturally integrates into daily life.

The educational habitus legitimizes the subjectivity of relations. It largely determines an individual's behavior and value system, which means this particular habitus must be individualistic. Social dynamics are a continuation of such an education system, ushering in more changes within daily life reflected in the views and behaviors of individuals.

A school centered on the individual offers more options at his disposal for shaping his life; even changes within family structure are dictated by the process of individualism.

Individualization or the 'institutionalization of individualization' represents structural changes in social institutions, relations, and the relationship between individuals and society.

Art should aid this social development by retaining diversity at its core. Art aims to safeguard the individual from mob 'line', while education brings significant changes within ourselves, transforming the mob into a civic, open, and emancipated society.

Borxhi ndaj Prishtinës

Duty to Prishtina



Artan KRASNIQI
KRYEREDAKTOR

EDITOR IN CHIEF

Kur mora përsipër që të drejtoj këtë edicion të revistës kushtuar artit dhe kulturës së kryeqytetit, pata një ndjenjë të thellë përgjegjësie dhe njëkohësisht ndjeva se po kthej një pjesë të borxhit në raport me atë që Prishtina më ka dhënë mua për gjithë këto vite.

Ky edicion i revistës PrishtinArt është një shëtitje në kohë dhe hapësirë në kulturën e Prishtinës.

Përmbajtja e revistës çelet me një artikull brilant nga profesori sociolog Ibrahim Berisha, që e vë gruan në qendër të vëmendjes, me atë që e ka quajtur si rinjohje e qytetit. Është një histori mijëra vjeçare e kompresuar në pak rreshta, që të mbajnë së lexuari pa lëshuar frymën e pa lëvizur kapakët e syrit. Një retushim i fotografive nga mjeshtri Arben Llapashtica, na

mundëson që të shohim në një vend dy pamje të Prishtinës në kohë të ndryshme.

Zhvendosemi në vitet '90, për të dhënë një kontribut modest në përnjohjen e atij thesari të madh kulturor që prodhoi dekada e fundit e shekullit XX, në një rast të paprecedentë, kur kulturë bëhej nën trysinë dhe kërcënimin e vazhdueshëm të policisë serbe. Shkëlzen Maliqi, edhe njëherë e elaboron pse kjo ishte formë e veçantë e rezistencës, me artin në thelb të saj.

Kronologjia e do që të ndalemi në ditën e çlirimit. Tash kur kemi mbushur çerekshekulli në liri është koha që krahas evokimit të kujtimeve për atë që ndodhi në qershorin e '99-ës, të reflektojmë për të tashmen dhe për të ardhmen. Një reflektim i tillë na vjen ekskluzivisht nga numri një i Prishtinës, Përparim Rama.

Kryetari, në një bisedë të gjatë, shpreh edhe vizionin e tij për rigjenerimin e hapësirave të braktisura dhe rikthimin e tyre në shërbim të kulturës. Ish-Tulltorja dhe ish-Gërmia, janë në thelb të këtij vizioni, derisa

When I assumed the role of editing this year's edition of the magazine dedicated to Prishtina's art and culture, I felt a profound sense of responsibility. At the same time, I felt I was repaying a debt to the city that has given me so much over all these years.

This year's edition of PrishtinArt magazine is a journey through time and space, diving Prishtina's rich culture. The issue opens with an insightful article by sociologist Ibrahim Berisha, focusing on women and what he calls the essence of knowing the city. His take encapsulating a thousand-year history in a few compelling lines grabs all the reader's attention. A photographic retouching by the

professional Arben Llapashtica enables us to see Prishtina from two different eras side by side. The rest of the content is a journey through the 1990s, giving a humble contribution to better understand that vast cultural treasure that grew during the last decade of the 20th century. It was a totally unparalleled situation when culture continued to thrive despite the pressures and threats from the Serbian Police. Shkëlzen Maliqi elaborates the reasons why this unique form of resistance took place with art at its core.

Given the chronology, we pause to reflect on the Liberation Day. Now, a quarter century into freedom, it is time not only to evoke memories of what occurred in June 1999 but

Rezidenca 17 është një shembull i mirë i shfrytëzimit të hapësirave publike në shërbim të komunitetit artistik.

E drejtorja e Kulturës në Komunën e Prishtinës, Sibel Halimi, shkruan për lirinë individuale si parakusht për krijimtari artistike.

Në këtë numër nuk kanë mundur të mungojnë personazhe si Meli Qena, që kanë një jetë kushtuar kulturës në Prishtinë. Sikurse as pasqyrimi i ngjarjeve që ndodhën e që pritet të ndodhin nga emrat më eminentë të kulturës sonë, si: Rame Lahaj, Petrit Halilaj e të tjerë.

Gjeografikisht kemi ecur nëpër lagje të Prishtinës, për të dokumentuar atë që ndodh në jetën e përditshme të qytetarëve. Ritual i shahut te Fontana e famshme e Ulpianës është pasqyruar në një artikull, e në një tjetër kemi ecur bashkë me turistë të huaj për të parë se si rrëfëhet sot Prishtina. Fotoreportazhet na shpërfaqin kulturën e kafesë a jetën e natës në Prishtinë, hijeshinë e luleve dhe artin urban përmes grafitëve.

Në Gërmi kemi takuar vrapuesen e përçdoditshme – Blerta Bërvenikun, e përmes fotografive të Albert Krasniqit kemi kuptuar më shumë rreth botës së egër në “mushkëritë e Prishtinës”, sa për të ridëshmuar se toka është habitat i bashkëjetesës të të gjithë krijesave.

Natyrshëm kemi bërë thirrje për të vizituar Gollakun, dhe këtë jo pa qenë të bindur se një gjë e tillë ia vlen. Nga atje na vjen një rrëfim i jashtëzakonshëm i ndërlidhjes së jetës në fshat me teknologjinë – bujqit kanë nisur që bagëtime të tyre t'u vënë GPS, për t'ua ditur vendndodhjen.

Me këtë përmbajtje, në një kohë kur shtypi në letër ka nisur t'i takojë të së kaluarës, jemi krenarë të Ju ftojme që të shëtisni me ne nëpër Prishtinën e artit dhe të kulturës.



Ky edicion i revistës PrishtinArt është një shëtitje në kohë dhe hapësirë në kulturën e Prishtinës.

This year's edition of PrishtinArt magazine is a journey through time and space, diving Prishtina's rich culture.

also to ponder the present and future. A reflection along these lines is shared by Prishtina mayor, Përparim Rama.

In his interview, mayor expounds his vision for regenerating abandoned spaces and transforming them into cultural hubs. The former buildings of the Brick Factory (Tullëtorja) and Gërmia embody this vision, while Rezidenca 17 is an inspiring example of using public spaces to serve the artistic community. Sibel Halimi, Director of Culture at the Municipality of Prishtina, delves on individual freedom as a condition for artistic creativity. This edition of the magazine features people like Meli Qena, who made lifelong contributions to Prishtina's culture. It further covers, both past and upcoming, featuring outstanding cultural figures such as Ramë Lahaj, Petrit Halilaj, and many more. Geographically, we ventured into Prishtina's suburbs to chronicle the daily lives of residents. One article is devoted to the 'ritual' of chess playing at the famous fountain in Ulpianë, while another takes us on a walk with foreign tourists to see how Prishtina is aptly revealed through their eyes. Reportage photography showcases Prishtina's coffee culture nightlife, the charm of flowers, and urban art through graffiti.

In Gërmia, we met daily runner Blerta Bërveniku, while through Albert Krasniqi's photos we dive into the wildlife of 'Prishtina's lungs', reasserting that Earth is the habitat where a panoply of animals and birds coexist. Naturally, we called for a visit to Gollak, convinced that such a visit is worthwhile. From there ensues a standout story showing how daily village life has become intertwined with technology, with farmers using GPS to track their cattle.

With this rich content, in an era where printed press is fast becoming a thing of the past, we proudly invite you to journey with us through Prishtina's art and culture.

Rinjohja e qytetit



IBRAHIM BERISHA

Hyjnesha në Fron: Simboli e ndjek si dhunti Prishtinën nga viti 1956. Figurina Hyjnesha në Fron, sot paraqet shenjën e identitetit kulturor dhe historik të qytetit. Imazhi dominues i saj, sy e vesh të përngjashëm me të ufo-ve, është sa imponues, po kaq edhe mistik. U ruajt në dhe 6 mijë vjet, derisa në hapje të **themeleve** të një fabrike tjerrreje të pambukut, ku do të punësoheshin mbi 2 mijë gra, kryesisht koloniste, u zbulua rastësisht. Çfarë ishte kjo figurinë, dorë e cilit paraardhës e bëri, cilit

i takonte nëse jo për të fituar të drejtën historike mbi këtë qytet, apo, atëherë së paku për prestigjin kulturor? Ky sens emocional bëri që në vitin 1999, ajo të grabitej dhunshëm nga Muzeu i Kosovës, për t'u mbajtur e robëruar katër vjet në Muzeun Popullor dhe Etnologjik të Beogradit. Figurina hyri në pazare të mëdha ndërkombëtare dhe u kthye në Muzeun e Kosovës në maj të vitit 2002, mbas një presioni ndërkombëtar për t'u njëjtësuar më shumë me triumfin politik e diplomatik sesa kulturor.

Tjerrtorja, ku u gropos pasuria tjetër arkeologjike, filloi punën më 1952.

Hyjnesha është statujë gruaje që flet për një traditë, në të cilën roli i saj pavarësisht keqkuptimeve të sotshme, edhe në këtë rajon me civilizim aktiv antik, ishte i madh. Mesazhi i statujës së Hyjneshës në Fron, folur me retorikën publike - na përkujton rolin qendror të grave ndër popujt që jetuan në këtë trevë, ku ende edhe sot ato kanë humbur atë pozitë, duke mos përjashtuar

Knowing the City

↑ **Goddess on the Throne:** A Symbol that accompany Prishtina as a gift since 1956.

The statuette "Goddess on the Throne" now represents a hallmark of the city's cultural and historical identity. Its awe-inspiring image, with eyes and ears in an alien shape, exudes an imposing and mystical presence. It remained beneath soil for 6,000 years until it was accidentally found during setting out the foundations of a cotton textile factory, which was set to employ over 2,000 women, mostly colonists. What was this statuette, who was the hand who crafted it, to whom does it belong if not to gain the historical right over the city, at least to garner some cultural prestige? This emotional load led to a situation in 1999 when the statuette was forcibly seized from the Kosova Museum and then held for four years in the Ethnographic Museum of Belgrade. The statuette has underwent certain international negotiations and thanks to continuous pressure it was finally returned to the Kosova Museum in May 2002; however it was more a political and diplomatic triumph rather than a cultural one.

The textile factory, where it is buried an entire archeological treasure, started its functioning in 1952.

The Goddess is a female statuette which speaks to a tradition within an active civilization where her role, despite today's misunderstandings, was significant. The message emanating from "Goddess on the Throne", to speak in public rhetoric, reminds us of the central role of women in societies that used to live in these areas, contrasting with the current state where they no longer hold such positions, even in the capital of Kosova. It remains a question



FOTO: ARBEN LLAPASHTICA

as kryeqendrën e Kosovës. Çështje është nëse mund të funksionalizohet si "simbol inspirimi për ta krijuar një shoqëri moderne, në të cilën nuk mendohet se është gjë e panatyrshme që gratë të mbajnë pushtet, në të cilën ekziston barazia thelbësore dhe në të cilën gratë u bashkëngjiten burrave si partnerë të barabartë në qendër të jetës shoqërore dhe politike".

Legjenda: Legjendat janë të përsëritshme sikur humbja dhe ringritja e vendbanimit. Ulpiana antike–Prishtina sot mbijetoi tërmete të mëdha, dy zjarre masive, murtajen dhe luftërat të vogla e të mëdha. Hija e murtajes ka mbetur edhe sot në kujtime nga rrëfime brezash, me toponimin Vorret e Murtajes. Një nga simbolet humane dhe kulturore të shqiptarëve, është PjetërBogdani. Ku është përmendorja e PjetërBogdanit në Prishtinë? Një domethënie e qenësishme e identitetit prishtinas.

Mahalla e Muhaxherëve: Gjenocidi i Serbisë dhe Rusisë, në Sanxhakun e Nishit dhe vendbanimet ku jetonin shqiptarët, detyroi të mbijetuarit, të vendoseshin ngado, deri në Siri, por shumica për shkak të afërsisë me vendbanimet e tyre, u ndalën në Kosovë dhe rajonet përreth. Po në vitet 1877/78 në Prishtinë, u vendosen 500 familje muhaxhire nga këto vendbanime, duke krijuar Lagjen e Muhaxherëve, që edhe sot e kësaj dite, ruan fragmente identitare, me ndjenja kohezioni origjine. Muhaxhirët i dhanë një komponentë të re dinamike urbane, por edhe patriotike.

Solidariteti i prishtinasve me familjet që u vendosën në pjesën lindore të qytetit, që i madh. U ndihmuan me objekte dhe shërbime "hajrati", nga familjet e njohura të qytetit.

Trualli për xhaminë që u ndërtua



perpunuar Arben Llapashtica, 2015


whether it can be functionalized as "an inspiring symbol to create a modern society, where it does not feel unnatural for women to hold power, where there is a substantial equity, and where women join men as equal partners in the heart of social and political life".

Legend: Legends are recurrent as the loss or restoration of a dwelling site. Ancient Ulpiana, now modern Prishtina, has managed to survive through massive earthquakes, fires, plagues and numerous wars. The plague cast its shadow in memory of generations as it is best evidenced by the place-name "The graveyard of plague". PjetërBogdani, is one of the most reputable cultural symbols of Albanians. Where is his monument? This underscores the essential significance of Prishtina's identity.

"Mahalla e Muhaxherëve" (Refugees Quarter): Serbia and Russia carried out a genocide in what was once Sanjak of Nish, which was inhabited by and large by Albanians,

which in turn prompted the driven population to settle everywhere, even in Syria, but the bulk of them found refuge in Kosovadue to its proximity. In 1877/78, 500 refugee families settled in Prishtina, thus creating Mahalla e Muhaxherëve, which still maintains its identity and cohesive sentiments about their origin. These newcomers imbued intoPrishtina an urban and patriotic dynamism.

The residents of Prishtina displayed a lot of solidarity with their compatriots. Wealthier families provided unrelenting assistance and services ("hajrati"). One woman namedKadiriedonated her land to build a mosque for them – thus the new building was named asXhamia e Kadiries in her honor. The granted land from this lady dismantles a stereotype perpetuated by Serbian "science" and adopted from that of Albanians, namely that women in this empire did not enjoy the right to own land. In Prishtina, women owned houses, lands, properties and estates, as evidencedby cadastral documents



në këtë lagje që dhuratë e zonjës Kadirie. Xhamia mori emrin e dhurueses -Xhamia e Kadiries. Prona e falur e zonjës prishtinase, thyen edhe një stereotip, të ndërtuar nga "shkenca serbe", të adoptuar nga ajo e shqiptarëve, se në këtë Perandori, gratë nuk e kanë pasur të drejtën e pronës. Gratë edhe në Prishtinë kanë qenë pronare të shtëpive, tokave, lokaleve, çifligjeve që e dëshmojnë dokumentet kadastrale në Arkivin Qendror të Turqisë, në Ankara.

Gruaja humaniste prishtinase: Në një shtëpi të vogël, të vjetër, njëkatëshe, jetonte një grua, e vetme, por asnjëherë krejt e vetmuar. Humaniste, ndoshta një prej humanisteve më të mëdha që ka pasur Prishtina ndonjëherë. Jetoj gjithë shekullin XX. Fisnikja, MinifeTopërlaku, sado me mund dhe në varfëri, i mori, i rriti, i shkolloi, i bëri të zotëte vetesdymbëdhjetë fëmijë jetimë dhe të braktisur: Sylejmanin, Shyqyriun, Xhellain, Vlakën, Lumniën, Advinë, Nazminë etj.

Kolonizimi: Politika serbe e kolonizimit që nga viti 1912, synoi të krijojë

praktika të mbizotërimit të serbëve duke larguar me dhunë shqiptarët dhe, në mos krejt, për të krijuar fshatra të përziera etnike, në njërën anë, dhe në tjetrën vendbanime të pastra me kolonë serbë e malazias. Në vitin 1922, Prishtina rrethohet me popullsi kolone. Krijohen vendbanime të reja, apo

ndryshohet struktura e popullsisë në fshatrat e Prishtinës.

Kishte një strategji për të ndërtuar vendbanime homogjene serbe përreth gjithë qytetit, andaj u vendosën masivisht kolonë, duke përfutur edhe favore të mëdha: shtëpi, toka, male, kafshë, pajisje dhe vegla pune, financime familjare dhe individuale. Fshatrat me kolonë serbë e malazias përreth Prishtinës, pas serbizimit të emrave, ku u bë vendosja e tyre ishin: Prishtinë 150 familje, Fushë-Kosovë 154, Obiliq 86, Lipjan 10, Pomozotin 46, Milloshevë 68, DevetJugoviq 71, Lebanë 9, DobroSelë 28, Bardh i Madh 24, Miradi e Epërme 83, Hajvali 49, Zllatar 20, Vrellë 108, Radevë 6, Medvec 13, Vragoli 12, Sllatinë 34, Harilaq 24, Batusë 4, Lepi 4, Magurë 25, Qagllavicë 5, SuhaDoll 131, Kryshefc 18, Orlovic 84, Mazgit 12 etj. Në rrethin e Graçanicës, kolonët serbë e malazias, u vendosën në 24 lokalitete të mëdha dhe në 22 të vogla. Fjala është për kolonë, pa u numëruar administratorë dhe qeveritarë, përfshirë xhanarë (police) e deri te poreznikë(tatimpagues).

↑ in the Central Archive of Turkey.

A Philanthropist Woman from Prishtina: In an old, small, one-story house, lived alone a woman who was never lonely. She was a philanthropist, perhaps one of the most generous individuals ever in Prishtina. She lived throughout most of the past century. This noble woman, MinifeTopërlaku, even when she was destitute, adopted, raised and educated twelve abandoned orphan children: Sylejman, Shyqyri, Xheklal, Vlaka, Lumnië, Advie, Nazmie, and others.

Colonization: Since 1912, Serbian colonization policies aimed to establish Serbian dominance, or at least creating ethnically mixed villages and new settlements with predominantly colonist elements. By 1922, Prishtina was encircled by colonist population. With these new settlements, the ethnic make-up of adjacent villages was changed. The strategy aimed at creating homogenous Serbian villages around the city, which was carried out by settling privileged colonists who received benefits such as houses, lands, forests, animals, agricultural means, and financial aids. As these populations settled, the new villages were given Serbian names, such as Prishtinë with 150 families, Fushë-Kosovë 154, Obiliq 86, Lipjan 10, Pomozotin 46, Milloshevë 68, DevetJugoviq 71, Lebanë 9, Dobro Selë 28, BardhiMadh 24, Miradi e Epërme 83, Hajvali 49, Zllatar 20, Vrellë 108, Radevë 6, Medvec 13, Vragoli 12, Sllatinë 34, Harilaq 24, Batushë 4, Lepi 4, Magurë 25, Qagllavicë 5, Suha Doll 131, Kryshefc 18, Orlovic 84, Mazgit 12, and others. In the Graçanica district, Serbian and Montenegrin colonists were settled in 24 major localities and 22 smaller ones. Beside colonists, there were administrators and guverners, as well as gendarmes and "porezniki" (taxpayers).

IMAZHE TË HISTORISË

Jetë paralele përmes lenteve: Një mënyrë e re e të shikuarit të kaluarën

Sa shumë ka ndryshuar Prishtina ndër vite? Ne mund të urrejmë kur shohim që vendet tona të preferuara zëvendësohen nga diçka që s'ngjallë më interesim për ne – apo, më keq, kur shohim monumente të rëndësishme kulturore që shkatërrohen – por nuk mund ta mohojmë faktin që ndryshimet ndonjëherë janë fasionuese për t'i shikuar.

ALBERINA HAXHIJAJ

Eshtë një distancë që ndihet kur shohim fotografi të vjetra. Shekulli i kaluar, ai i njëzeti, është i panjohur për shumicën e njerëzve të këtij shekulli. Teknologjia, shoqëria dhe kultura kanë ndryshuar me të madhe, që kur fotografitë e para të Prishtinës u realizuan. Megjithatë një afërsi ngjallet kur ato vihen përkrah atyre të kohëve të fundit. Fotografi Arben Llapashtica po bën

një punë të jashtëzakonshme për të krijuar një lidhje në mes të së kaluarës dhe të tashmes, duke u mundësuar vrotuesve të krijojnë një afërsi, një lidhje emocionale me njerëzit dhe vendet e fotografuara vite më parë në kryeqytet.

Ishin pikërisht ndryshimet në Prishtinë që e kishin nxitur Llapashticën që ndër vite të hulumtonte, të mbledhte dhe të

HISTORICAL IMAGES:
PARALLEL LIVES THROUGH
THE CAMERA LENS

New Ways to Assess the Past

How much has Prishtina changed over the span of a nearly century? Witnessing the transformation of our beloved places can at times spark indignation—all the more so when significant cultural monuments are destroyed for good. Yet, there is no point in denying the fact that these changes can also be fascinating.

Viewing old photographs engenders a sense of distance. For many people, the 20th century feels like an unfamiliar era. Since the first photographs of Prishtina were taken, technology, society and culture have evolved so profoundly. Yet, a feeling of closeness emerges whenever these old images are compared with most recent ones. Arben Llapashtica, a tireless photographer, is currently doing a unique work to bridge both past and present by allowing the public to get an intimate and emotional bond with historical photographs of various people and places.

These very rapid changes taking place in Prishtina triggered Llapashtica for delving, mustering and digitizing old photographs of the city which he found in archives, books and other sources. He says that a driving motive in this undertaking was the fact that Prishtina's architectural



digjitalizonte fotografi të vjetra të kryeqytetit, të cilat i gjente nëpër arkiva, libra e monografi. Ai thotë se e shtynte fakti se pasuria arkitektonike e qytetit po zhdukej e si dëshmi mbeteshin veç këto shkrepte të zhvilluara. Në kërkim të së kaluarës, ai ndeshet me të tashmen, veçanërisht me ndryshimin e shpejtë urbanistik të kryeqytetit. Kështu vetëm e kaluara e dokumentuar nga të tjerët nuk i mjaftonte. E kishte të nevojshme që vetë të dokumentonte të tashmen e tij, që para syve po i ndryshonte shumë shpejt.

Bashkëdyzimi që ngjall pyetje

Ai vendosi të bënte bashkë dy kohë të ndryshme në një fotografi të vetme. Kërkonte të njëjtat vende.

"Dëshiroja t'i kopjoja fotografitë që i kisha, t'i fotografoja objektet e njëjta nga perspektiva e njëjtë. Të kisha gjysmën e një lokacioni të caktuar nga vitet e '50 e '60 dhe gjysmën tjetër ta fotografoja tani", thotë ai. Fokus i kishte objektet që i kishin mbijetuar kohës.

"Fotografitë janë kombinuar në mënyrë perfekte, sepse këndet dhe perspektiva e objekteve duhen përputhur saktë me foto të vjetra. Prishtina ka pësuar ndryshime të mëdha dhe në disa lokacione është degraduar hapësira, prandaj ka qenë e vështirë që disa fotografi të kombinohen", sqaron tutje Llapashtica.

Modest në punën e tij, ai tregon se kombinime të tilla mund të gjenden edhe për vende të tjera, veçanërisht kombinime të fotove të tanishme me ato gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai, po ashtu, i ishte përveshur punës që të tilla të realizonte edhe për Prishtinën, pasi ishte i bindur se emocionet, ndjenjat e mendimet që vijnë gjatë vrojtimit të tyre do të ishin frytdhënëse për shoqërinë.

"Këto fotografi ua mundësojnë vrojtuesve që të shohin të kaluarën në



FOTO: ARBEN LLAPASHTICA

heritage was gradually disappearing, and all that was left were just photographs. In his quest to dive into the past, he encounters the present state which indeed is that of a rapid urban development. But the past, even when abundantly chronicled, did not suffice at all. He felt more than ever the need to chronicle our present time which is incredibly changing.

A Combination that Sparks questions

First Llapashtica decided to merge images from two different times into single photographs, thus seeking out the same locations to frame his composites. "All I wanted was to take photographs of the same objects from the same perspective. My idea was to have half of the frame from the 1950s or 1960s and the other half to be made from today", he explains. His main focus became those landmarks that have

survived through the time.

"My photos are perfectly combined since in these kind of work it is necessary to get exact correspondences in terms of angles and perspectives. Prishtina has undergone significant changes, while in some places the space is degraded, which made my task to combine images more challenging."

Very modest in his work, he states that such combination projects exist in other countries as well, especially when current photos are put into comparison with those from World War II. Therefore, he set out this undertaking even for Prishtina as he believed that such a combination would be fruitful for the public as long as it unravels emotions, feelings and thoughts.

"Those photos allow people to see the past through a different way, to learn more about it, and even immersing in the way of life of that time", he says. But there was



një mënyrë tjetër, të mësojnë për të kaluarën dhe madje edhe të shohin mënyrën e jetesës në atë kohë”, thotë Llapashtica. Por përtej kësaj ishte edhe një pikë tjetër që ai e kishte me rëndësi: promovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Prishtinë. Sipas tij, ky bashkëdyzim i dy fotografive si një e vetme, e nxiste zhvillimin e diskutimit mbi atë së çfarë konsiderohet trashëgimi kulturore dhe sa po mbrohet ajo.

Editimi si plotësim

Llapashtica tregon se, kur shohim fotografi të vjetra ne e dimë që ata njerëz dhe ato vende kanë ekzistuar – evidenca është para syve tanë – por disi ato duken joreale. “Prandaj”, - vazhdon tutje, - “duke i lidhur me të tashmen, që për ne është e njohur, ato janë më afër realizmit”.

“Mendoj se qytetarëve të Prishtinës, kur i shohin këto fotografi, u zgjohet kureshtja dhe nxitet një debat për pasurinë arkitektonike që kishte

an additional reason that increased the importance of this project: it was the imperative to promote monuments of cultural heritage. As he further explains, the merging of two images into a single one would incite the much-needed debate about what is considered cultural heritage and how it is protected.

Editing as a Supplement

Llapashtica says that while watching

old photos we know that those people and places existed at that time – the evidence is just palpable – yet they can seem unreal. It is only when we bridge them with our time, which is familiar for us, that makes them more intimate.

“I think people of Prishtina will be curious when they see these photos, prompting a debate about the capital’s architectural heritage that existed in past decades”, he says, explaining



Prishtina më parë”, thotë ai, duke treguar se disa nga fotografitë e vjetra që i ka shfrytëzuar janë nga Arkivi i Kroacisë e që shumë njerëz ato i shohin për herë të parë.

“Janë perspektiva unike, disa të shkrepura nga aeroplani, prandaj i kam kombinuar me foto aktuale të realizuar me dron”, vazhdon tutje Llapashtica.

Sipas tij, editimet nuk largojnë asgjë, madje ato i plotësojnë të dy fotografitë që sikur ndalin kohën dhe i japin shikuesit më shumë mundësi për vrojtim. Ai falënderon mikun e tij, Milot Krasniqi, po ashtu me profesion fotograf, për realizmin e editimit, që sipas tij luan rol shumë të madh në gjithë këtë miniprojekt të tij.

Retrospektiva e kohës

Nga ky cikël me fotografi, që ai i referohet si Kombinimet, veçon tri fotografi. Kureshtje i kishte zgjuar Xhamia e Llokaqit te Teatri Kombëtar dhe kroi që kishte qenë aty. Si informatë i kishte lënë përshtypje fakti se fotografia e ëmbëltores ELIDA ishte bërë në vitet '90-të gjatë represionit serb kur regjimi i atëhershëm kishte mbyllur këtë vend shumë të frekuentuar gjatë asaj kohë. Tjetra që i ka mbetur në mendje është e vitit 1913, nga koleksionisti i famshëm Albert Khan.

“Ka shumë trishtim në atë foto”, thotë Llapashtica.

Bëhet fjalë për fotografinë ku shihet një grua me një fëmijë para xhamisë.... Aty shihen edhe ushtarët serbë në vjeshtë të vitit 1912, gjatë Luftës së Parë Ballkanike, vetëm në Prishtinë dhe rrethinë kishin vvarë 5 mijë burra.

“Në këtë kohë Prishtina nuk kishte më shumë se 17 mijë banorë gjithsej”, tregon tutje Llapashtica duke dashur kështu që përmes numrave të theksojë përmasën e njerëzve të vvarë.

Ai beson që fotografitë, pa marrë



parasysh se për çfarë qëllimi shkrepën, kanë aftësinë për të kapur një moment të caktuar, për të ndalur një aksion, për t'u bërë dëshmitar të historisë, për t'u mundësuar vrojtuesve që plotësisht të absorbojnë të bukurën, horrorin ose qesharaken e atij momenti. Këtë, sipas tij, e bënë edhe Kombinimi. Veç ai vjen me dyfish më shumë emocion, pasi përballë tij vë jetën e dy botëve të ndryshme të të njëjtit vend.

that some of the images gleaned from the Croatian Archive are shown for the first time. “There are some unique perspectives, some of them were taken from airplanes, and this is why I combined with drone photos”, Llapashtica explains. He emphasizes that nothing is skipped during editing process; indeed it's so crucial as it somehow halts time and allows viewers to observe photos more insightfully. Llapashtica does not miss the chance to credit his colleague Milot Krasniqi for editing, a process that plays a notable role in his project.

Time Retrospective

This entire cycle is titled “Combinations”, and Llapashtica is fond of three particular photos. He was intrigued by a photo of the Llokaqi Mosque, which was located where now is the National Theatre building, and

a water well there. While conversing with people his attention was also piqued by a photo of sweet shop “Elida” taken during 1990's when the Serbian apartheid regime closed down this frequented venue. Some very strong emotions he had when he stumbled upon a powerful photo taken from 1913 by the renowned photographer, Albert Khan. “There is such a melancholy there”, Llapashtica contemplates.

Its focus shows a woman with her child near a mosque, while in the background can be seen Serbian soldiers who during the autumn of 1912 only in Prishtina slaughtered 5,000 men.

“At this time Prishtina had no more than 17,000 inhabitants”, says Llapashtica who emphasizes the incredibly high casualties when compared with the overall number of population.

He believes that photos, regardless of their original intent, have the ability to eternalize a certain moment, to stop an action and serve as witnesses to history. When properly offered to viewers, they provide the opportunity to absorb beauty, horror, or even funny side of things. And to this purpose serves his “Combination”. It brings further emotions as it juxtaposes two worlds that revolve around the same place.

BISEDË ME SHKËLZEN MALIQIN
A CONVERSATION WITH SHKËLZEN MALIQI

Arti dhe rezistenca

Art and Resistance

Është sfidë mjaft serioze që ta kapërthesh nëpërmjet pyetjeve dhe komenteve një mendimtar, radiusi i të cilit nuk shtrihet në një fushë specifike të angazhimit intelektual, por është një miks mes refleksionit teorik, kritikës artistike dhe angazhimit vital politik.

“ It poses a serious challenge to embrace through questions and comments a thinker whose radius is not centered on a particular intellectual commitment but rather represents a mélange of theoretical contemplations, artistic critique, and political commitment.

INTERVISTOI: LABINOT KELMENDI

Arti i rezistencës, ky fjalëformim konceptual i Maliqit në vetë e ngërthen një kuptimin të dublikuar ngase: në njërën anë na shfaqet si kritikë dhe rezistencë ndaj okupimit të jashtëm kolonizator, ndërsa në anën tjetër na manifestohet edhe si rezistencë ndaj diskurseve konservatore të heterotopive akademike të brendshme. Si rrjedhim, Shkëlzen Maliqi është shenjuesi i përpjekjes së një gjenerate për të demistifikuar diskurset hegjemonike të etabluara lokale, por edhe për të krijuar një front të rezistencës ndaj gjendjes së apartheidit dhe të shovinizmit. Angazhimi për të mos u kurthuar në ndonjë tregim eskatologjik apo në ndonjë dramë mesianike, por për të krijuar dhe mirëmbajtur një pluralizëm/etikë (Connolly), është pika neuralgjike e refleksionit të Shkëlzenit. Ky lloj pluralizmi nuk ishte ndonjë farsë apo shqitje në ndonjë relativizëm, por një vështrim kritik dhe hapje ndaj zërave të ndryshëm që e banonin skenën publike. Ky bisedë e shkurtër me Shkëlzenin është e lidhur ngushtë me artin e rezistencës, por në të njëjtën kohë i prek edhe mikrohistoritë që e sendërtojnë Ny-

The art of resistance, a conceptual crossword of Maliqi, carries within itself a dual semantic. On one hand, it pops out as a critique and resistance against foreign colonialist occupation, while on the other, it stands as a resistance against conservative discourses of inner academic heterotopies. Thus, Shkëlzen Maliqi epitomizes a generation's efforts to demystify established local hegemonic discourses and engender a front of resistance against apartheid and chauvinism. The dedication to not adhering to an eschatological story or messianic drama, but to providing a plurality of ethics (Connolly), is a central point of Shkëlzen's thinking. This sort of reflection is neither a farce nor a slip towards relativism but rather offers a critical overview and welcomes various voices that inhabit the political landscape. This short dialogue with Shkëlzen Maliqi is closely related to the art of resistance, but it simultaneously tackles the micro-histories that underpin the Kosova's Riddle ('Nyja e Kosovës' in Albanian). This book encapsulates in the most accurate manner the gist of this conversation. Shkëlzen Maliqi is a thinker who, with his humbleness, serves as a reference and inspiration for creative acts and critical actions towards a pluralistic and open society, not only for his generation but also for present and future ones. Ultimately, this conversation is with a thinker—a well-deserved epithet for one of the few who has gravitated into the public sphere.

I am aware that for the most part your intellectual activity has taken place in Prishtina, what is the genius loci (spirit of place) of Prishtina for you? What signifies in your memory the Liberation Day of Prishtina?

As a capital, I do not find Prishtina very enjoyable, it is chaotic, with layers of urban patches from successive systems that endeavored to “set it right” without any comprehensive master plan that rests on a holistic approach. If you lack a vision of the whole, success in improvement is less likely. I do not sense at all for any genius loci, I'd rather opt for Prizren, my birthplace with



FOTO: ERMAL META

jën e Kosovës. Nyja e Kosovës, titulli i librit të Shkëlzenit, e enkapsulon në mënyrën më të mirë thelbin e kësaj bisede. Shkëlzen Maliqi është mendimtari që me modestinë e tij bëhet burim referimi dhe frymëzimi drejt akteve kreative dhe fushëveprimit kritik për një shoqëri plurale dhe të hapur, jo vetëm për gjeneratën që i ka takuar, por edhe për gjeneratat që kanë ardhur dhe po vijnë. Në fund, ky bashkëbisedim është me mendimtarin, epitet që Shkëlzeni, nga të paktët që kanë gravituar hapësirën publike, e meriton.

1. Duke qenë koshient që shumicën e veprimtarisë suaj intelektuale ju e keni bërë në Prishtinë, çfarë është *genius loci* (fryma e vendit) i Prishtinës për Shkëlzen Maliqin? Dhe çfarë shenjon në kujtesën tuaj Dita e çlirimit të Prishtinës?

Si kryeqytet Prishtina nuk më shijon, është kaotik, me shtresa arnimesh urbanistike nga pushtetet suksesive që përpiqeshin ta "ndreqnin" atë pa ndonjë masterplan rregullues që bazohet në qasje holistike. Nëse nuk e keni vizionin e tërësisë, nuk mund të keni sukses me arnime.

Për ndonjë *genius loci* timin nuk e di, do të thosha se më parë e mendoj Prizrenin, si vend të prejardhjes dhe me kujtime më të mira nga fëmijëria, por edhe ky do të ishte më shumë një sfondi frymëzimeve nostalgjike dhe jo shtytës aktiv që hap shtigje për të ardhmen. Megjithatë, për mua, që nga viti 1982, kur u pata kthyer në Kosovë, edhe këtë Prishtinë kaotike e kisha simbol të Kosovës së dhunuar dhe kërcënuar ekzistencialisht. Andaj ka qenë vend i duhur që më ka motivuar dhe shtyrë të reagojë dhe të bëhem ky që jam në jetën publike.

Sa i përket Ditës së çlirimit të Prishtinës, kur trupat britanike patën hyrë në Prishtinë, unë kam qenë me familjen në Tetovë. (Në atë kohë gjysma e Prishtinës u dëbua dhe gjeti strehim në Tetovë dhe Polog, shpesh çuditem pse nuk shënohet çdo pranverë kjo mikpritje e shkëlqyer që e kishim!). Sigurisht, më ka gëzuar lajmi i çlirimit. Por, ndjenjën e thellë, madje metafizike të çlirimit e kam përjetuar në korrik të vitit 1999, kur u ktheva në Prishtinë. Po e shijoja fladën e arrës në oborrin e shtëpisë, kur më cingëroi celulari. Më kërkonte një gazetare e Radio B92 nga Beogradi. E njihja, gjithnjë ka qenë korrekte me informata. Më pyeti: Si po ndiheni pas kthimit? I thashë: "Të shpëtuar. Tani jemi vetja, dhe duke u larguar nga Serbia me shpejtësi drite!" Vërtet e pata ndjenjën e shkëputjes, sikur jemi në një anije

kozmiqe që ikën nga planeti, të cilit nuk i përkitnim, sepse nuk ishim të lirë, dhe po largoheshim vetëtimthi nga koordinatat identitare që na kanë paracaktuar pavullnetshëm shtetin, krahinën, sistemin, regjimin, Beogradin si kryeqytet etj., e që më 12 qershor 1999 kishin mbetur rubrika boshe që duhej t'i plotësonim me vullnet: Prishtinë, Republika e Kosovës...

2. Ju keni qenë të angazhuar aktivisht në skenën politike, kulturore dhe intelektuale të viteve '90. Si mund ta përshkruani arealin kulturor të viteve '90, kushtimisht atë polislin paralel në kohën e apartheidit?

Nuk ka qenë sistem paralel, i shpikur rishtazi atëherë si përgjigje ndaj masave të Serbisë, por ishte vazhdimësi e institucioneve të kohës së autonomisë, me disa përshtatje në organizim dhe menaxhim. Kjo më së miri shihet në sistemin shkollor, ku rreth 400 mijë nxënës dhe studentë dhe 20 mijë pedagogë, pas ndërprerjes disamujore, ashtu siç ishin, me disa lëvizje në postet drejtuese, e vazhduan punën në kushte të riokupimit dhe apartheidit, duke i zhvendosur aktivitetet në hapësira alternative, nëpër shtëpi-shkolla. Ishte po ai sistem autonom i mëparshëm, por i riemëruar dhe me status të avancuar, ngase pas shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut (7 shtator 1990) në shtëpitë-shkolla lëshoheshin certifikata e diploma të Republikës së Kosovës që disa shtete, p.sh. Austria, i njohu si dokumente valide dhe mundësoi vazhdimin e shkollimit të kosovarëve në atë shtet. Ngjashëm kanë funksionuar edhe institucionet e kulturës, shembulli më i avancuar ka qenë Teatri Dodona, por format e përshtatjes të aktiviteteve kanë qenë të ndryshme, duke krijuar ad-hoc zëvendësime të mungesave. U pat zaptuar Galeria e Prishtinës, por u hapën shumë kafe-galeri. Duhet të kuptohet se vitet e '90 nuk kanë qenë thjesht vetëm kohë e lavdishme e rezistencës ndaj sistemit represiv serb, por edhe kohë e çlirimit të brendshëm nga mentaliteti dhe praktikat e ngulitura të njëmendësisë në atë sistem të administrimit të polislin paralel, si e quajttë, të trashëguara nga sistemi socialist. Mediet dhe kultura e viteve '90, qoftë ato që e kanë vazhduar punën nga sistemi i vjetër (Rilindja, Zëri etj.), qoftë nismat e reja (Koha javore, Kosova sot, Forumi i Demaçit, revista MM etj.), kanë pas rol të jashtëzakonshëm për çlirim të brendshëm, ku po ashtu u themeluan shumë organizata të shoqërisë civile. Për çlirim të brendshëm kultura, mediet dhe shoqëria civile e viteve

↑ its most enjoyable childhood memories, but this is more of a nostalgic inspiration than an active driving force that opens paths for the future. Nonetheless, since 1982 when I returned to Kosova, this top-sy-turvy Prishtina was a symbol of a violated and existentially jeopardized Kosova. Regarding Prishtina's Liberation Day, when British troops entered in Prishtina, I was back then in Tetovë with my family (at that time half of Prishtina's population was driven and had taken shelter in Tetovë and Pollog, and I often wonder why no one commemorates this striking hospitality!). Surely, I was happy when I heard the news of liberation. The deep feeling of liberation, even in a metaphysical level, came in June 1999 when I returned to Prishtinë. I was enjoying the freshness of a nut tree in my garden when my phone rang. It was a journalist from Radio B92 in Belgrade, whom I knew for her correct reporting. She asked, "How do you feel after your return?" I replied to her, "We feel saved. Now we are ourselves and departing from Serbia at light speed!" I truly felt a sense of detachment, as if we were on a cosmic ship leaving behind a planet we did not belong to, because we were not free, and thus we were instantly moving away from the identity coordinates that unwillingly defined our state, province, system, regime, Belgrade as a capital and so on, which in June 12 1999 were left like an empty box which was to be filled with our will: Prishtinë, Republic of Kosova...

You were actively engaged in the political, cultural, and intellectual scenes throughout the 1990s. How would you describe the cultural landscape of that time, or more accurately, the parallel polis that was established during the apartheid?

It was not a parallel system invented as a countermeasure to Serbia's actions, but rather a continuation of the institutions from the autonomy period, with some adoptions in terms of organization and management. This is most noticeable in the education system, where around 400,000 pupils and students, along with 20,000 teaching staff, after a few months of disruption, resumed with some moves in the leading posts, their work in a situation of occupation and apartheid by moving to alternative spaces, such as private homes adapted as schools. The system remained the same but was renamed and given a more advanced status; after the Kaçanik Constitution (September 7, 1990), in those

'90, të udhëhequra nga grupet dhe individët mendjehapur e kreativë, kanë pasur ndikim po aq të rëndësishëm sa partitë politike me LDK-në, Ibrahim Rugovën dhe Qeverinë në ekzil që mbledhte fonde nga diaspora, të cilat, si autoritete dominante, menaxhonin ngrehinën e madhe të polisit paralel ose të sistemin të rezistencës të viteve '90.

3. Në librin tuaj të fundit, që është përmbledhje e teksteve dhe refleksioneve tuaja estetike, ju keni ardhur te një fjalëformim konceptual të quajtur "Arti i rezistencës", që të ngjan me "Estetikën e rezistencës" të Peter Weiss-it. Çfarë nënkupton për Shkëlzen Maliqin "Arti i Rezistencës"?

Nuk ka ndonjë lidhje me konceptin e Weiss-it, pos që artit i rezistencës në të dy rastet shënon një frymë përbashkuese antifashiste: Weissi i mëshon nazizmit gjerman, kurse arti i viteve '90 i mëshon apartheidit si projekt të nazizmit gjenocidal serb. Për vetë fjalëformimin, unë e kam pasë shkruar një vështrim për ekspozitën e Iliriana Loxhës në kafe Koha në lagjen Pejton e Prishtinës, me titull Rezistenca e artit (Zëri, 12 mars 1994), dhe ajo pastaj u përhap gjithandej për projektet e ekspozitave në hapësirat alternative. Disa artistë në fillim hezitonin, thoshin se piktura degradohet duke u shfaqur nëpër kafene. Por, shumica nisën ta bëjnë këtë, Iliriana ishte ndër të parat.

“Për më shumë, disa artistë më kreativë të brezit nisën të shprehen konceptualisht, nëpër medie të reja, punonin instalime, video art etj., Artistët konservatorë thoshin se ata po e bastardonin "artin e mirëfilltë". Unë isha i mendimit se këto gjeste dhe vepra janë tharmi i rezistencës.

Kur edhe autoritetet, si akademikë Muslim Mulliqi, Rexhep Ferri, Agim Çavdarvsha dhe të tjerët, filluan të ekspozonin te restorani Hani i 2 Robertëve, në kafe Roma, galerinë Dodona etj., u legjitimua dhe u gjallërua e gjithë skena alternative e rezistencës kulturore. Unë pata vazhduar reflektimet për artin e kohës nën siglën Rezistenca e artit, duke veçuar artistët - Sokol Beqirin, Mehmet Behlulin, Erzen Shkolollin, Albert Hetën e disa të tjerë, që



homes adapted as schools were issued documents and diplomas bearing 'Republic of Kosovo', which in turn were recognized by some states, such as Austria, which regarded them as valid documents and enabled the continuation of education for Albanians in its territory. The same was evident in cultural institutions, with the most glaring example being the Dodona Theatre; the forms of adoptions were multifold, creating ad hoc replacements for what was absent. While the Gallery of Prishtina was occupied, many coffee galleries opened in its place. What needs to be recognized is that the 1990s were not just a glorious time of resistance against the repressive Serbian system but also a period of internal liberation from the mentality and practices established in the parallel system, as you labeled, which had been inherited from the socialist system. The media and culture of the 1990s, whether those who continued from the old system (Rilindja, Zëri, etc.) or new initiatives (Koha javore, Kosova sot, Forumi i Demaçit, MM magazine, etc.), played a vital role in this internal liberation. This time also saw the foundation of many civil society organizations. The culture, media, and civil society of that time, led by creative and open-minded individuals and groups, had a pivotal influence that matches with that of political parties such as LDK, Ibrahim Rugova, and the exiled government, which gathered funds in the diaspora. As dominant authorities, all of them managed the massive building of the parallel polis or resistance system throughout the 1990s.

In your last book, which is a summary of your aesthetic texts and reflections, you introduced a conceptual crossword called 'Art of Resistance', which reminds us of Peter Weiss's 'Aesthetic of Resistance'. What does 'Art of Resistance' mean?

There is no relation to Weiss's concept, except that in both cases the art of resistance shares an anti-fascist spirit:

Weiss opposes German Nazism, while the art of the 1990s opposes apartheid as a project of Serbian genocidal Nazism. When it comes to this particular crossword, I had authored a review for Iliriana Loxha's exhibition in Koha Coffee in the Pejton suburb of Prishtina, entitled Rezistenca e Artit (Zëri, March 12, 1994), and then it spread all over exhibitions projects in alternative spaces. Some artists expressed reluctance, maintaining that the painting is degraded once it is exposed in cafés. Yet most artists began to do this, and Iliriana was one of the first. Moreover, some creative artists of that generation began to conceptually express themselves in new mediums, working with installations, video art, etc. Those artists with conservative proclivities considered that they were debasing 'proper art'. I believed at that time that those acts and works were the very essence of resistance. When authoritative artists such as academicians Muslim Mulliqi, Rexhep Ferri, Agim Çavdarvsha and others started to exhibit in the restaurant Hani i 2 Robertëve, Roma coffee, Dodona Gallery etc., the alternative scene of cultural resistance was legitimized and revived. I continued my reflections on the art of that time under the term Rezistenca e Artit, emphasizing Sokol Beqiri, Mehmet Behluli, Erzen Shkololli, Albert Heta, and an array of others, who, through experimentation with new forms and mediums, provided a model of internal liberation of the culture—without underestimating classical mediums but by expanding the potentials of expression. My book tackles the relation between art and resistance; its title Art i rezistencës encapsulates both meanings: not only the indisputable participation in the 1990s resistance but also the internal rebellion against conservative academism.

Lastly, how do you see the current situation and prospects of the artistic and philosophical scene in Kosovo?

Both scenes are persisting with rela-

duke eksperimentuar me forma dhe medime të reja të shprehjes demonstroi një model të çlirimit të brendshëm të kulturës që nuk i rrezikon medimet klasike të shprehjes, por i zgjeron mundësitë e shprehjes. Libri im, të cilit iu referuat, e shpreh edhe një relacion tjetër mes artit dhe rezistencës, titulli i librit është *Arti në rezistencë*, ku përmbledhen të dyja kuptimet, nuk e kam parasysh vetëm pjesëmarrjen e padyshimtë të artit të viteve '90 në rezistencën e përgjithshme, por edhe rebelimin e brendshëm ndaj akademizmit konservator.

4. Për fund, si e sheh Shkëlzen Maliqi prospektin dhe aktualitetin e skenës artistike dhe asaj refleksive (filozofike/sociologjike/humanistike) të Kosovës?

Skena artistike dhe ajo refleksive po mbijetojnë me suksese relative në kushtet e ngjashme me ato që i tregova shkurtimisht në përgjigjen e pyetjes së parë për gjendjen e kryeqytetit. Po jetojmë në një kohë tranzicioni të rëndë që ka krijuar provizoriumin e një sistemi hibrid kulturor, si kombinim i modeleve të trashëguara të institucioneve shtetërore dhe kombëtare, dhe nismave të shumta të institucioneve dhe projekteve të pavarura, të profileve dhe të madhësive të ndryshme, shumica me potenciale modeste, që po mundohen ta gjejnë formulën e qëndrueshmërisë dhe të suksesit jashtë komoditetit që e kanë në start institucionet e para, me suport të garantuar nga buxhetet e shtetit ose të qyteteve.

Kjo gjendje hibride nga jashtë krijon përshtypjen e gjallërisë, e një krijimtari të begatshme dhe dinamike, por edhe me pasojë të disbalancës në përkrahje, që çon në një garë të pabarabartë mes kulturës institucionale të privilegjuar dhe kulturës së pavarur, e cila është më dinamike, madje shpesh më superiore me vlerat që krijon dhe i afirmon edhe jashtë vendit, por nuk

gjen përkrahje meritore nga burokracia kulturore që ndërmjetëson dhe i ndan fondet buxhetore për kulturën. Vetëm së fundi MKRS ka bërë një hap para për trajtimin e barabartë të dy sektorëve duke krijuar borde vlerësuese dhe fonde të veçanta për kulturën institucionale dhe kulturën e pavarur.


Kjo është risi, nuk di si do të funksionojë. Ose do të duhej të kishte edhe reflektim dhe përkrahje për barazimin e statusit institucional të projekteve të pavarura kulturore me rëndësi të sprovuar dhe të jashtëzakonshme, në kuptimin se, p.sh. Qendra Multimedia e Prishtinës, Dokufesti i Prizrenit dhe disa projekte të tjera, të afirmuara edhe ndërkombëtarisht, të marrin status të aseteve kombëtare për të përfutur edhe grante për investime kapitale infrastrukturore që u siguron qëndrueshmëri më afatgjate, edhe pse janë "projekte private". Komuna e Prishtinës dhe Republika e Kosovës do të duhej ta kishin për nder që p.sh. Jeton Neziraj dhe Blerta Rrustemi Neziraj t'u mundësojnë ndërtimin e një godine moderne për Multimedian, e cila do të mund të kishte edhe statusin e teatrit të qytetit, që Prishtina si metropol kulturor nuk e ka. Sistemi hibrid që e kemi e mundëson këtë, vetëm duhet të reflektohen qartë interesat e shoqërisë.

Në këtë drejtim mund të përkrahet edhe sektori refleksiv që përmendet. Është situatë e ngjashme me mundësi të ngjashme, edhe statusi i shoqatave nuk ka rregullativë të duhur. Pse Prishtina nuk e ka një institut ose tribunë për hulumtime dhe debate shoqërore? Qendra për praktika narrative e Manifestës, e cila pas një viti pune mbeti varur dhe pa financim, ndoshta ka mundur të orientohet në këtë drejtim, të shfrytëzohet dhe menaxhohet nga një bord që e krijojnë shoqatat e pavarura dhe ato do të fitonin një hapësirë të përshtatshme për projekte refleksive, një fushë që e kemi deficitare dhe të amullishme.

↑ tive successes under conditions similar to those I mentioned in my answer regarding the current state of Prishtina. We are experiencing a grave transition which has spawned a provisorium of a cultural hybrid system, combining inherited models from state and national institutions with many initiatives from independent institutions and projects—most of them with modest potential, striving to find a sustainability formula outside those institutions that have guaranteed public funding support. Seen from outside, this hybrid situation creates an impression of a vivacity, a colorful and dynamic cultural production. However, the truth is that there is discrepancy in the support they receive, leading to uneven competition between the privileged institutional culture and the often superior independent culture, which is making its way abroad but lacks sufficient support from the cultural bureaucracy that serves as an intermediary of managing public funds for culture. In recent years, the Ministry of Culture has taken steps toward fair treatment of these two sectors by establishing assessment boards and special funds for both institutional and independent culture. There should be support to equate the institutional status of certain independent cultural projects that have proven their importance.

Thus, Qendra Multimedia in Prishtina, Dokufest in Prizren, and some other projects should be given the status of national assets to benefit from grants for capital investments, ensuring in turn their long-term sustainability. Both the Municipality of Prishtina and the Government of Kosovo should allocate funds so Jeton Neziraj and Blerta Rrustemi-Neziraj can build a modern building for Multimedia, which could then achieve the status of a city theater (something Prishtina, as a cultural metropolis, still lacks!).

The hybrid system enables this, all that is needed is to have some reflection on the society's interests. By the same token, even the philosophical sector would benefit from support. The situation and opportunities are similar, and the status of organizations has no adequate regulation. Why does Prishtina have no institute for research and public debates? The Centre for Narrative Practice – Manifesta, which was left without finances after one year of functioning, maybe could fit for this purpose; it could be managed by a common board created by independent organizations, thus providing an appropriate space for reflective projects—a field that is still deficient and stagnant.



KULTURA GJATË VITEVE '90

Kur arti zhvillohej me ngulm e pa kompromis

CULTURE DURING THE 1990S

When Art Developed Persistently and Uncompromisingly

AGRON KRASNIQI

Periodha e viteve '90 në Prishtinë, sa i përket ngjarjeve kulturore mund të thuhet se i ka dy anë të medaljes. Nga njëra anë, vështirësitë me të cilat u ballafaquan njerëzit e kulturës, të cilët u përjashtuan nga institucionet kulturore, sikur edhe nga të gjitha institucionet e tjera, dhe në anën tjetër organizimi i pashembullt i njerëzve dashamirës të kulturës që dhanë gjithçka nga vetja në mënyrë që të ketë aktivitete e ngjarje kulturore.

Kjo periudhë është shumë pak e trajtuar dhe e analizuar për atë që ka prodhuar në skenën kulturore. Prandaj, duhet të bëhet shumë më tepër në mënyrë që të vihet në dukje kontributi i artistëve të asaj periudhe, ndër më të vështirat në historinë e Kosovës. Kur bisedon me ata që kanë qenë aktivë në atë kohë, ose me njerëz që i kanë përcjellë zhvillimet kulturore nga afër, befasohesh me përgjigje. Shumë thonë se ajo ka qenë ndër periudhat me prodhimin më të madh kulturor, në shumë zhanre. Nëse mbyllet një derë, hapet një tjetër, kjo shprehje që e dëgjojmë në popull, është shumë përshkruese për atë që ndodhi në vitet '90. Kur u mbyllën dyert e teatrove, galerive, sallave të koncerteve, shtëpitë e kulturës dhe të gjitha të tjerat me radhë, u gjetën hapësira të tjera, në të cilat edhe më me ngulm zhvillohej art, pa bërë kompromis me vlerat. Në një seri të podcasteve prej 6 episodesh, disa prej protagonistëve të kohës, flasin për përvojat e tyre gjatë asaj kohe.

When it comes to cultural events, the 1990s period in Prishtina is a story of two sides. On one hand, cultural carriers faced serious hindrances, being dismissed from institutions. On the other, there was an unparalleled organization among culture lovers who gave their utmost so that cultural events and activities continued unabated.

This period is slightly analyzed and explored for its effects on the cultural scene. Therefore, much more needs to be done to reveal the contributions of artists during this era, which was one of the toughest in Kosovo's history.

Conversations with those active at the time or familiar with the cultural developments reveal surprising insights through their answers. Many assert that this period saw the most prolific cultural production across various genres.

"When one door closes, another one opens", is a popular adage that so aptly describes those events that took place in the 1990s. As theatres, galleries, concert halls, and cultural centers shut down, new spaces emerged instead, allowing art to persistently flourish without compromising its values.

In a series of six podcast episodes, several main protagonists share their experiences.

Enver Petrovci: Kishim përkrahjen e jashtëzakonshme të publikut

Enver Petrovci është drejtori i parë i Teatrit Dodona. Po jetonte e punonte në Beograd, kur u ftua për ta nisur punën në institucionin që për gati një dekadë të okupimit do të ishte epiqendra e aktiviteteve kulturore, jo vetëm në kryeqytet. Mesatarja e programeve në Dodona, në fillimin e viteve '90 ka qenë 6 programe në ditë.

"Aty ka pas shfaqje për fëmijë, që përsëriteshin njëra pas tjetrës, shfaqje të mbrëmjes, por edhe shfaqje mysafire, festivale e aktivitete të tjera. Ka qenë një gjallëri e jashtëzakonshme në 'Dodona'... provat e shfaqjeve mbaheshin pasi përfundonte shfaqja e mbrëmjes, për shkak se nuk kishim hapësira tjera".

Sipas Petrovcit, po të mos ishte Dodona, gjatë asaj kohe, shumica e aktorëve që sot i kemi ndër më të mirët, nuk do të ishin aktivë, e një pjesë e tyre me siguri edhe e kishin lëshuar Kosovën, për shkak të mungesës së punës e perspektivës.

"Kemi punuar aq shumë, sa që as sot nuk ka shfaqje sa jepeshin atëherë. Mandej kemi pasur edhe përkrahjen e jashtëzakonshme të publikut, që vinte edhe përcillte shfaqjet dhe programet tona".

Zake Prelvukaj: Është punuar me pasion e sakrificë

Zake Prelvukaj, gjatë viteve '90, ka bërë një karrierë të jashtëzakonshme. Në fillim të viteve '90, ajo diplomoi, dy vjet më vonë angazhohet si ligjëruese në Akademi, ku punon me studentët, që ishin pothuajse edhe moshë e saj. Zakja ka qenë shumë aktive në jetën kulturore, me cikle punimesh, ekspozita personale e kolektive. Ajo njeh mirë zhvillimin dhe sfidat e artit pamor të asaj periudhe. Thotë se artisti di të mbijetojë.

"Kur na mbyllën galeritë, në të cilat hapeshin ekspozitat deri atëherë, u hapën disa dyer të tjera. Filluam që aktivitetin tonë ta zhvendosim në disa vende që njiheshin si kafe-galeri, mirëpo edhe nëpër restorante e lokale të ndryshme

Petrovci: We Had Unwavering Support from the Public

Enver Petrovci is the first director of the Dodona Theater. Back then, he used to live in Belgrade when he was invited to lead an institution that became a cultural hub throughout the decade. In the early 1990s, the Dodona



theater hosted an average of six daily programs.

"There were children's shows, which were repeated one after another, evening performances, guest shows, festivals, and other activities. It was an incredibly vibrant atmosphere back then....rehearsals took place after evening shows due to a lack of space".

Petrovci maintains that without Dodona, many current actors might have left the country due to a lack of perspective.

"We worked tirelessly at the time, and even today, our shows from that period remain unmatched. We also had unwavering support from the public, who attended our shows and programs".

Prelvukaj: We Worked with Passion and Sacrifice

During the 1990s, Zake Prelvukaj had an outstanding career. At the beginning of the decade, she graduated and two years later began lecturing at the Academy, working with students nearly of her own age. Prelvukaj was quite active in the cultural scene, contributing with artistic work cycles, and personal and collective exhibitions. She is well-conversant with the challenges faced by visual arts at the time, noting that an artist knows how to survive.

"When galleries that hosted exhibitions closed, new doors opened. We moved our activities to coffee-galleries, restaurants, and other popular venues".



që kanë qenë të njohura në atë kohë", thotë ajo.

Kujton se hapja e ekspozitës bëhej në mënyrë shumë jofor-
male, që e bënte edhe më atraktive krejt ngjarjen.

"Shtypeshin disa fletushka të vogla si ftesa, i shpërndanim,
por mesazhi bartej edhe nga personi në person".

Hani i dy Robertëve, Kafe-galeria KOHA, Dodona - në këto
vende bëheshin edhe performanca, instalacione të ndryshme
që i përgjigjeshin karakterit të të menduarit dhe të krijuarit
në atë kohë.

"Arti i krijuar gjatë viteve '90 e ka lënë një gjurmë të
veçantë në historinë e artit të Kosovës. Është punuar me
shumë pasion dhe sakrificë. Madje, edhe më shumë se sot".



Naser Gjinovci: Përjetimin e viteve '90 s'e ndërroj me asgjë

Naser Gjinovci, është një prej ikonave të muzikës rok në
Kosovë. Grupi Minatori, vokalist i të cilit është Naseri, ka
dhënë jashtëzakonisht shumë për muzikën. Në vitet '90,
edhe ata sikurse të gjitha grupet e tjera që ishin në kulmin e
popullaritetit, me mbylljen e sallave koncertale dhe studiove
muzikore për shqiptarët, ishin para një dileme të madhe: të
ndalonin apo të vazhdonin të kërkonin zgjidhje. Naseri me
shokë zgjodhën rrugën e dytë, madje thotë se "kjo është
periudha më e pëlleshme për grupin Minatori, sa i përket
prodhimeve muzikore, por edhe koncerteve të mbajtura".

"Kemi mbajtur koncerte nëpër sheshe të ndryshme, para
50 apo 100 mijë njerëzve, mirëpo përjetimin e viteve '90 nuk
e ndërroj me asgjë. Është periudha më e ndritshme, sepse
motivin e kemi pasur të madh të bëjmë muzikë, të incizojmë
këngë". Me kalimin e kohës u krijuan edhe lokalet, klubet e
"specializuara" për aktivitete kulturore, ku promovoheshin
libra, ekspozita, video e audio kaseta etj. Ndër të Casablanca.

"Për mua kjo ka qenë periudha më e këndshme".

Prevlukaj recalls the informal nature of exhibition openings,
which somehow added to their appeal.

"We printed flyers as invitations and spread them, but also
the invitation spread by word of mouth".

Hani i Dy Robertëve, KOHA coffee-gallery, and Dodona,
were all hubs for performances and various installations that
were congruent with the era's creative thinking.

"The art created in the 1990s left a distinct mark on
Kosova's art history. We worked with passion and sacrifice,
surpassing even today's attempts".

Gjinovci: I Wouldn't Trade My 1990s Experience for Anything

Naser Gjinovci, a rock music icon in Koso-
va, was the vocalist for Minatori, a band
that made an outstanding contribution to
music. In the 1990s, despite the closure of
concert halls and music studios, the band,
like many others who were at the nadir
of their fame, faced a dilemma: cease its
activity or find new solutions. Gjinovci
and his bandmates opted the latter.

"This period was the most fertile for
Minatori in terms of musical production
and concerts.

We performed in different venues, with
audiences ranging from 50 to 100,000
people. This is why I wouldn't trade my
1990s experience for anything. It was

the brightest period, as we had powerful motivation to make
music and record songs".

As time passed by, venues and 'specialized' clubs for cul-
tural activities emerged, serving to promote books, exhibi-
tions, video and audio cassettes, and more. Among them was
Casablanca.

"To me, this was the most awesome period".

Rudi: A 20-Square-Meter Room as a Concert Hall

Rafet Rudi, a conductor, composer, and professor at the
Academy of Arts, has been active for the past 50 years. He
worked to various cultural institutions and important cultural
initiatives. During the 1990's, like many others, he was com-
pelled to adapt without relinquishing his profession. To the
untrained eye, it may seem that classical music was neglected,
but Rudi dismantles this notion.

"In the autumn of 1991, when our buildings were taken



Rafet Rudi: Dhomë 20 metra katrorë si sallë koncertale

Rafet Rudi, dirigjent, kompozitor e profesor në Akademinë e Arteve është prej artistëve më aktivë në 50 vitet e fundit. Ka punuar në institucione të ndryshme kulturore, por edhe në nisma të rëndësishme të promovimit të kulturës. Gjatë viteve '90, si shumica u desh të gjendet në një formë apo një tjetër, mirëpo gjithmonë afër kulturës. Për vëzhguesit pasivë, mund të duket se gjatë asaj periudhe muzika klasike mbeti në margjina, mirëpo sipas Rudit nuk ishte ashtu.

"Në vjeshtën e vitit 1991, kur u larguam nga objektet tona ne vazhduam punën e Fakultetit në lokalet e Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës, një shtëpi jo e madhe.

Aty zhvillohej një aktivitet shumë i madh, jo vetëm i Fakultetit, por edhe i jetës së përgjithshme muzikore.

Aty vepronte Shoqata dhe ushtronin disa ansamble më të vogla korale, si dhe një oktet që unë e udhëhoja. Pra, shumë institucione që u larguam nga objektet tona, u zhvendosëm në dy kthina dhe në një paradhomë, por për atë kohë ishte diçka shumë e rëndësishme. Njërën dhomë, që ishte më e madhe ndoshta nja 20 metër katrorë, e quanim sallë koncertale dhe mbaheshin koncertet, por edhe organizonim konferenca shkencore e tribuna të ndryshme. U patën vendosur 52 karrige shumë të vogla, në mënyrë që të shfrytëzohej hapësira. Ne mendonim se aty do të ishim për disa muaj, as nuk na shkonte mendja që do të ishim në atë vend për gati 10 vjet".

over, we continued our University work in Composer Association of Kosova's building, a small home. It was a very active period, not just for the University but for the overall musical life. In this building, the Association operated and rehearsed some small choral ensembles and an octet led by me. Like many other institutions expelled from our buildings, we operated in two small rooms and a hallway. One of the rooms, which was slightly more spacious, about 20 square meters, was called a concert hall and served for concerts, scientific conferences, and other activities. 52 small chairs were placed there to make the most of the limited space. We first thought we would stay there for a few months, but never imagined that we would remain for nearly 10 years".

Prishtina, 25 vjet frymon lirshëm



JETA ZYMBERI

Në mes të gëzimit shumë të madh dhe një frike mund të gjendet emëruesi i përbashkët i emocioneve të qytetarëve të Prishtinës e gjithandej Kosovës, në ditën e çlirimit. Tash, një çerek shekulli pas, gjendemi në mes të evokimit të kujtimeve e përjetimeve në njërën anë dhe reflektimit për zhvillimin e qytetit në anën tjetër.

Janë 25 vjet që Prishtina frymon lirshëm. Njeh zhvillimin, po ashtu.

Dita e 11 qershorit të vitit 1999 nxori një zë të ri në rrugët e Prishtinës, zërin e lirisë. Ky zë u përhap si një melodi e bukur

në zemrat e mijëra qytetarëve që për vite të tëra kishin pritur këtë moment. Po tingëllonte si diçka e pabesueshme. Po shoqërohej me gëzim të madh, por edhe me frikë se çfarë mund të ndodhte tash.

Për dikë, zbritja me parashuta e ushtarëve të NATO-s në "Bregun e Diellit" ishte një ndjenjë rilindjeje. Mes lotësh përqafoheshin edhe ata që s'e njihnin njëri-tjetrin, e në krahë u hidheshin edhe ushtarëve britanikë të KFOR-it.

Forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u futën në periferi të qytetit, ndërsa zërat e lirisë u përhapën nëpër rrugë si një valë e paqes dhe e shpresës. Forcat ushtarake dhe policore serbe filluan të tërhiqeshin, duke e hapur rrugën për një ditë të re e të begatë për Prishtinën dhe për të gjithë Kosovën.

Një epokë e re po niste. Prishtina, si qyteti kryesor i

Prishtina, 25 Years since Its Freedom

The Liberation Day of Prishtina went through immense joy and some fear among residents. A quarter of a century later, we reflect on the memories, experiences, and development of Prishtina.

It has been 25 years since Prishtina began to breathe freely. It has undergone profound development ever since.

June 11, 1999, introduced a new voice through Prishtina's streets—the voice of freedom. It reverberated like a fine melody among thousands of people who had longingly awaited this moment for years. The air was filled with a sense of something incredible. While there was ubiquitous great joy, some fear was also noticeable about what might happen in the ensuing days.

For many, the sight of NATO's soldiers descending with parachutes in the Bregu i Diellit neighborhood was a revival. People embraced one another with tears, even hugging British troops of KFOR.

Kosovo Liberation's soldiers entered the city's periphery, while the voice of freedom spread over the streets as a glimpse of peace and hope. The occupying Serbian forces began their

Kosovës, u ngrit në këmbë me krenari për të përballuar sfidat e ardhshme dhe për të ndërtuar një të ardhme të lirë dhe të ndritur për brezat e ardhshëm.

Tashmë, teksa mbushëm 25 vjet në liri, kujtimi për atë ditë të shënuar mbetet një ngjarje e rëndësishme historike për popullin e Kosovës. Perspektivat një fotoreporterit dhe një qytetari që kishte qëndruar gjithë kohën në Prishtinë në kohën e luftës, të pasqyruara këtu, janë vetëm një gur në mozaikun e madh të përjetimeve që përfaqësojnë një trashëgimi të çlirimit dhe nderojnë përpjekjet dhe sakrificat e atyre që luftuan për liri e pavarësi.

Ajo që po përjetonim ishte pothuajse e pabesueshme

Emocionet e asaj dite nuk mund t'i harroj asnjëherë, sepse ishin emocione të ankthit dhe të frikës. Atë pasdite, erdhën forcat britanike këtu te lagja ime Hani i Dilit dhe unë dola të bëja fotografi, por ata na sugjeruan që duart t'i mbajmë lart, që të shihet çka kishim në dorë. Prandaj po them që ishte një emocion gëzimi, i përzier me frikën, që na përcolli edhe atë ditë. Ajo ditë kaloi me plot ankth dhe ishte pothuajse e pabesueshme për ne, ajo që po e përjetonim. Kurrë nuk do ta harroj atë ditë, sa të jem gjallë.

Histori të momentit kam përjetuar shumë, pasi isha fotoreporter në të gjitha ngjarjet në Kosovë edhe gjatë luftës, edhe gjatë fillimit të luftës, por sidomos në Prishtinë e në fshatrat përreth Prishtinës, ku pasqyroja përmes fotografisë sesi njerëzit zhvendoseshin, si trajtoheshin, dhunën e shkatërrimin e shtëpive. Është e vështirë t'i rikujtojë ato momente që i kam përjetuar, por dua të cek kolonën e Gollakut, ku gjatë rrugës kam parë edhe kufoma, madje edhe kufoma të djegura, dhe ishte pamja më e rëndë për mua. Më vjen



retreat, signaling a new day for both Prishtina and Kosova. A new era had begun. As the capital of the country, Prishtina proudly faced new challenges and paved the way for a bright future for future generations. Now, on the 25th anniversary of the country's liberation, many recount that notable day as a pivotal historical event. Here, we have gleaned perspectives from a photo reporter, and a citizen, which together make a small piece of the larger puzzle of stories that represent the heritage of liberation and honor the sacrifices of those who gave their utmost for freedom and independence.

"It Was an Anxiety-Filled Experience That Bordered Almost on the Surreal"

I will never forget the emotions of that day as they were a mix of anxiety and fear. In the afternoon, British forces entered my neighborhood, Hani i Dillit. As I went out to take photographs, they asked me to raise my hands so they

could verify what we were holding. This is why I say it was an emotion mixed with the fear of war that still lingered. It was an anxiety-filled experience that bordered almost on the surreal. Thus I will remember that day for as long as I live.

I endured so many experiences during the war period, serving as a photo reporter in almost all events that took place in Kosova, particularly in Prishtina and its adjacent region. Through my camera lens, I took images of people being driven from their homes, violence, and the destruction of homes. It is difficult for me to recall those grave moments, yet I would like to evoke one haunting memory of a caravan of refugees in the Gollak area, where I saw corps, even burned bodies. It was the most terrifying sight for me. It saddens me that we still do not know how many people were killed or how many homes were destroyed in Prishtina's region. Through my exhibitions, I did my best to inform the public about what happened. Today,

keq që ende nuk dihet saktë se sa shtëpi janë djegur në Prishtinë, apo sa njerëz janë vrarë. Përmes ekspozitave që i kam hapur ndër vite, jam munduar gjithmonë të njoftoj publikun me ato që kanë ndodhur.

Prishtina sot është e veçantë, asgjë nuk krahasohet me lirinë. Duhet ta gëzojmë atë, por natyrisht, duke mos e harruar të kaluarën.

*Ridvan Slivova,
Fotograf*

“Të gjithë qanim nga gëzimi, përqafoheshim mes vete”

Më 11 qershor, nga Bosnja u nis kontigjenti ushtarak rus, i cili në Prishtinë ka arritur në orën 1 e 30 të datës 12.6.1999. Nata e 11/12 qershorit ka qenë nata më e tmerrshme që e kemi përjetuar gjatë gjithë kohës së luftës. Tërë natën kemi qëndruar të strukur në shtëpitë tona, duke vëzhguar paramilitarët serbë të bashkuar me popullatën e tyre, që festonin rrugëve si të çmendur, duke shtënë me armë zjarri në të gjitha drejtimet. Golgota jonë ka zgjatur tërë natën derisa ka zbardhur drita. Për ne si qytetarë, Prishtina u çlirua më datë 12.6.1999 në orën 16:30. Ky ishte momenti kur forcat e NATO-s arritën në Prishtinë. Për ne dhe lagjen time Bregu i Diellit, aterimi i helikopterëve të NATO-s, në vendin ku tash është varri i presidentit Rugova, ka qenë një shpëtim dhe një çlirim i vërtetë me plot kuptimin e fjalës, deri në ato momente ne kemi qenë të rrezikuar. Ardhja e forcave të NATO-s ka qenë një rilindje për ne që ishim këtu, atë gëzim nuk mund ta përshkruante askush. Përnjëherë e gjithë hapësira e parkut (si ne e quanim këtë vend), u mbush me njerëz. Isha i befusuar sa shumë njerëz kishin qenë të mbyllur gjatë gjithë kohës në shtëpitë e tyre, shfaqja e përnjëhershme e tyre ishte sikur të mbinin nga toka. Njeriu gëzimin më të madh e përjeton me lot, andaj të gjithë qanim nga gëzimi, përqafoheshim në me njëri-tjetrin, si dhe i përqaфонim dhe i falënderonim edhe ushtarët britanikë të repartit GURKA, që zbriten me parashuta nga qielli e që ishin shpëtimarët tanë.

Edhe ne që kemi qëndruar në Kosovë jemi luftëtarë, sepse pa ne nuk do të kishte kuptim çlirimi.

Përjetë mirënjohës, Zotit në qiell dhe NATO-s në tokë!

*Veseli Makolli,
Qytetar i Prishtinës*

Prishtina is exceptional, as nothing compares to freedom. However, we should be cautious not to forget or ignore the past because, without historical foundations, there can be no complete history for today.

*Ridvan Slivova,
Photo reporter*

“Most of us were all in tears, embracing one another”

On June 11, a military contingent of Russian troops in Bosnia set out on a march, arriving in Prishtinë at 1:30 PM on June 12, 1999. That night was the most frightening one we endured throughout the war. We spent the entire night hidden in our homes, watching from afar as Serbian paramilitaries, joined by the Serbian minority, indulged into a nearly maddened state, firing arms in all directions. Our Golgotha lasted through the night until dawn. For us, Prishtina was liberated on June 12 at 4:30 PM. This was the very moment when NATO troops entered the city. For all of us in the Bregu i Diellit neighborhood, the landing of NATO helicopters in the place where now houses Ibrahim Rugova's tomb felt like salvation and true liberation—we were not safe until that moment. The arrival of NATO forces was a revival for all of us, a joy that no one could fully describe. Instantly, the entire park (as we called it) was filled with people. I was amazed at how many people stayed hidden in their homes during the war; it was as if they emerged from the underground. Tears are often a sign of joy, and most of us were all in tears, embracing one another and expressing gratitude to the British soldiers and the GURKHA units, perceived as our saviors as they parachuted from the sky. That moment was truly a revival. All of us who stayed back at home are, in a way, warriors, because, without us, the liberation would be meaningless. We are always grateful to God in the sky and to NATO on the ground!

*Veseli Makolli,
Resident of Prishtina*

Prishtina, 25 vjet pas çlirimit: Si e shoh unë

Prishtina, 25 Years after Its liberation: How I See It



Përparim RAMA
KRYETARI I KRYEQYTETIT

THE MAYOR OF THE CAPITAL

Dita e Çlirimit të Prishtinës shënon një epokë të re në historinë e Prishtinës dhe, në fakt, të gjithë Republikës së Kosovës. Pas një periudhe të gjatë vuajtje, më në fund qytetarët e Prishtinës shijuan lirinë e shumëpritur. Nga ajo ditë, pra 11 qershori 1999, Prishtina ka hapur një kapitull të ri në historinë e vet.

Tani është në duart tona çka bëjmë me këtë liri të fituar. Një filozofe e njohur britanike thotë "liria nuk është piknik". Kjo nënkupton që liria e fituar duhet ruajtur, duhet avancuar dhe kjo liri duhet të shndërrohet në perspektivë e zhvillim. Ne, jo vetëm gjeografikisht jemi në Evropë, por edhe në aspektin e vlerave, jemi të orientuar në mënyrë

të pakthyeshme drejt perëndimit dhe jemi me fat që kemi pasur mbështetjen e shteteve të zhvilluara perëndimore në këtë rrugëtim.

Prandaj, kjo liri e fituar më 11 qershor duhet të ruhet përmes ligjeve demokratike që burojnë nga vetë qytetarët. Duhet të respektojmë po të njëjtat ligje dhe të ndërtojmë vlera të qytetarisë aktive e të tolerancës, të ndërtojmë të ardhme të sigurt për fëmijët tanë duke respektuar sakrificën dhe mundin e të gjithëve që kanë

kontribuar për të arritur këtë liri.

Administratat parapake në këto 25 vjet në Prishtinë kanë bërë punë dhe mund të konsiderueshëm, por ka munguar një vizion afatgjatë i transformimit të Prishtinës në një qytet praktik, të pastër e të gjelbër. Në fakt kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore pse kam vendosur të kthehem nga Londra dhe të futem në garë zgjedhore: ta transformoj Prishtinën në një vend bashkëkohor, me fokus në mirëqenien e qytetarëve, në

The Liberation Day of Prishtina marks a new era in the history of Prishtina and the entire Republic of Kosova. After a long period of suffering, Prishtina's citizens enjoyed the much-yearned freedom. From that day on, namely from June 11, 1999, Prishtina opened a new chapter in its history.

Now, it is on us to determine what to do with this freedom. A renowned British philosopher says, "Freedom is not a picnic". This means that the freedom we achieved should be protected through advancement and transformed into perspective and development. We are not only geographically in Europe but also we share its values by being irreversibly West-oriented; we are fortunate to have had the support of western

countries on our journey.

Therefore, this freedom won on June 11 must be maintained through democratic laws originating from the citizens. We should abide by these laws and build values of active citizenship and tolerance, ensuring a safe future for our children by respecting the sacrifices and contributions of all those who strived for this freedom.

Previous administrations over these 25 years made considerable contributions, yet there was a lack of a long-term vision for transforming Prishtina into a practical, clean, and green city. This was the main reason I decided to return from London and run in the elections: to transform Prishtina into a contemporary place, focusing on the well-being of citizens,

një vend me një karakter të veçantë, me një rregullim unik, me vlera shoqërore.

Kryeqyteti ka shumë sfida dhe unë do t'i klasifikoj në dy dimensione: sfidat e përditshme dhe sfidat afatgjata apo strategjike. Dy sfidat kryesore të përditshme janë menaxhimi i mbeturinave dhe problemi i qenve endacakë. Menaxhimi i mbeturinave, tashmë mund të konsiderohet si problem i së kaluarës, pasi në muajin prill e kemi zgjidhur me sukses - kjo po vërehet qartë në çdo cep të kryeqytetit, po ashtu nga komentet dhe reagimet e qytetarëve. Problemi i qenve endacakë është më kompleks. Deri tani kemi ndërmarrë një numër të masave: janë kastruar, vaksinuar dhe evidentuar rreth 3500 qen endacakë në kryeqytet, kemi krijuar pika ushqimore të shumta për të ushqyer qentë dhe për të zvogëluar sulmet ndaj qytetarëve. Më tutje, kemi ndërtuar Qendrën për Trajtimin e Kafshëve dhe jemi në proces të ndërtimit të Qendrës për Strehim Emergjent dhe të Parkut të Kafshëve, ku do të mund të bartim qentë.

Paralelisht me këtë kemi iniciuar projektin e adoptimit të qenve endacakë duke dhënë 50 euro në muaj për çdo

a place with a distinctive character, unique arrangement, and with social values.

Prishtina faces numerous challenges, which I classify into two dimensions: daily challenges and long-term strategic challenges. Daily, we encounter the problem of waste management and stray dogs. Waste management can already be considered a past issue, as we implemented a successful solution in April, noticeable in every corner of the city and from resident's comments and reactions. The problem of stray dogs is more complex. To date, we have taken several measures: about 3,500 stray dogs have been neutered, vaccinated, and recorded; many

qen të adaptuar nga qytetarët. Kemi lancuar edhe një fushatë informuese dhe vetëdijesuese Shtëpi për çdo qen, si vazhde e përpjekjeve tona për të



Sa i përket sfidave strategjike, ndër më të rëndësishmet, janë trafiku i mbingarkuar dhe kaosi urban. Për të rregulluar trafikun, kemi aplikuar një qasje multidimensionale që përfshin: ndërtimin e rrugës Jim Xhema (Rruga A); lidhjen e Rrugës B me rrugën Jim Xhema; ndërtimin e unazës së brendshme dhe lidhjes së rrethrrrotullimeve të Arbërisë dhe të Lakrishtës; të gjitha këto janë në ndërtim e sipër.

rritur numrin e qenve të adoptuar. Shumë shpejt do të fillojmë bartjen e një numri më të madh të qenve në Qendrën për Strehim Emergjent dhe kjo do të shënojë një përmirësim të dukshëm në kryeqytet. Mirëpo, po e përsëris që pa angazhim edhe të nivelit qendror, nuk do të zgjidhet problemi, sepse tejkalon kufijtë e kryeqytetit. Ftoj Qeverinë të

feeding spots have been established citywide, thus reducing attacks on people. We have also established the Center for Animal Treatment and are building the Center for Emergent Shelter and Animal Park to house



As far as strategic challenges are concerned, one of the most severe is the overburdened traffic and urban chaos. To address traffic issues, we have employed a multidimensional approach, including the construction of Jim Xhema Road (Rruga A); connecting Rruga B with Jim Xhema Street, building an inner ring, and linking roundabouts of Arbëria and Lakrishtë suburbs, all currently under construction.

these dogs. Simultaneously, we have initiated the project for adopting stray dogs, offering 50 euros monthly for

angazhohet dhe t'u ndihmojë të gjitha komunave, pa dallim, në zgjidhjen e këtij problemi njëherë e përgjithmonë.

Sa i përket sfidave strategjike, ndër

më të rëndësishmet, janë trafiku i mbingarkuar dhe kaosi urban. Për të rregulluar trafikun, kemi aplikuar një qasje multidimensionale që

each adopted dog. We launched an awareness campaign Houses for every dog ("Shtëpi për çdo qen" in Albanian), to increase dog adoption. Soon, we will start transferring many dogs to the Center for Emergent Shelter, marking a notable improvement in Prishtina. However, all this requires support from the central government; otherwise, the problem will remain unsolved as it extends beyond Prishtina's borders. I urge the government to commit and

assist all municipalities in finding a lasting solution. We are transforming the inner ring into a one-way system with an underpass on Agim Ramadani

përfshin: ndërtimin e rrugës Jim Xhema (Rruga A); lidhjen e Rrugës B me rrugën Jim Xhema; ndërtimin e unazës së brendshme dhe lidhjes së rrethrotullimeve të Arbërisë dhe të Lakrishtës; të gjitha këto janë në ndërtim e sipër. Transformimi i unazës së brendshme në sistem njëkahësh me nënkalim në rrugën Agim Ramadani. Më pas jemi në finalizim të projekteve të platformave që lidhin Arbërinë me qendër dhe Kalabrinë me Dardaninë, të cilat do t'u japin mundësinë qytetarëve të ecin këmbë në pjesën më të madhe të qytetit. Një masë tjetër është ndërtimi i shkollave në lokacione si Veternik, Mat, Kolovicë e lokacione të tjera

përreth qendrës. Pse do të ndikojë kjo në reduktim të trafikut? Sepse shumë prindër janë të obliguar nga këto lagje të sjellin dhe të marrin fëmijët e tyre në lagje të tjera të Prishtinës, duke ngarkuar kështu trafikun; dhe në fund, ndërtimi i bulevardit Xhorxh Bush dhe sheshit të Qytetit të Vjetër do të largojnë një numër të madh të veturave nga qendra duke krijuar kështu më shumë hapësira për këmbësorë e më shumë gjelbërim.

Projekti madhor i unazës së kryeqytetit tashmë ka përfunduar dhe jemi në proces të negocimit për financim me investitorë potencialë.

Prandaj, me përfundimin e këtyre

rrugëve, ndërtimin e platformave lidhëse, sistemin njëkahësh, ndërtimin e shkollave dhe të shesheve, edhe problemi i trafikut do të zgjidhet.

Në anën tjetër, problemin me kaosin urban jemi duke e zgjidhur në mënyrë sistematike përmes zhvillimit të dokumenteve strategjike. Janë përfunduar ose janë në përfundim e sipër: Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), Planet për Rigjenerimin e Kalabrisë, të Kodrës së trimave, Prishtinës së vjetër, Kolovicës, Gollakut. Të gjitha këto, do të krijojnë standarde dhe kushte të reja të zhvillimit, të cilat do ta zhdukën kaosin urban dhe do të krijojnë rend dhe rregull në kryeqytet.



FOTO: ANDI QARRI

Street. We are nearing the completion of projects connecting Arbëria with the center and Kalabria with Dardania, enabling residents to walk throughout most part of the city. Another project involves building schools in Veternik, Mat, Kolovicë, and other locations near the central part. Why will these measures reduce traffic? Many parents must send their children to other suburbs, further burdening traffic. Thus, construction George Bush Boulevard

and Old City Square will remove a significant number of cars from the center, creating more pedestrian spaces and greenery.

The major ring project has already been completed, and we are now negotiating financing with potential investors.

Therefore, when these roads, connecting platforms, one-way systems, new schools, and squares are completed, traffic will no longer be a

problem.

On the other hand, the issue of urban chaos is dealt systematically through strategic planning documents. We have completed or nearly completed the development plan of the municipality, Plans for Regenerating Kalabria, Kodra e Trimave, Old Prishtina, Kolovica, and Gollak. These will establish new standards and conditions for development, eliminating urban chaos and creating order in Prishtina.



FOTO: ARBEN HOTI





Hijeshia e artit urban

Grafitet janë shprehje artistike që i japin ngjyra një qyteti. Shpesh ato përcillen me porosi që kanë për qëllim të vetëdijësojnë shoqërinë për çështje të caktuara. Muret e gjata të Rugës B ka kohë që janë kthyer në një atraksion urban, duke i dhënë hijeshi pjesës së re të kryeqytetit. Përtej kreativitetit dhe të qenit mbresëlënëse, këto grafite janë një kritikë me qëllim që Prishtinën ta bëjnë akoma më të lirë e më të hapur.

The Beauty of Urban Art

Graffiti are an artistic expression that adds colors to the city. They often carry messages aimed at raising social awareness for certain causes. The long walls on Rruga B have become an urban attraction, giving beauty to the newest part of Prishtina. Beyond their creativity and impressive outlooks, these graffiti serve as critiques, aiming to make Prishtina more free and open.



HAPËSIRAT E BRAKTISURA NË FOKUS

Rama: Do t'ia rikthejmë këto pasuri Prishtinës

Sot, kanë marrë epitetin “hapësira të braktisura”, por dikur, këto objekte ishin shenja të qarta të zhvillimit dhe modernizmit të kryeqytetit. Rrethanat e kohës i kthyen këto objekte në të pashfrytëzueshme për një periudhë të gjatë, ndërsa në mendjen e qytetarëve mbeten si kujtime që përfaqësonin një epokë të kaluar. Këto zona kanë potencial për t'u kthyer në qendra të reja të artit, kulturës dhe inovacionit, duke e ndërruar mënyrën se si Prishtina shikon dhe përdor hapësirat urbane. Me vizion të qartë për të ardhmen e qytetit, kryetari Përparim Rama po zhvillon një strategji të re për shfrytëzimin e hapësirave të braktisura. Ai synon të transformojë këto zona në qendra aktive për të krijuar ambiente të reja që stimulojnë zhvillimin kulturor, social e ekonomik në Prishtinë.

INTERVISTOI: JETA ZYMBERI



FOTO: LABINOT KRASNIQI

A FOCUS ON
ABANDONED SPACES

Rama: We Will Return These Assets to Prishtina

Today they are dubbed as ‘abandoned spaces’ but once they were tangible signs of Prishtina’s development and modernization.

Due to historical circumstances, these places have long remained unusable, while for many they evoke memories of a past era.

These areas have the potential to be converted into new hubs of art, culture, and innovation, changing the way how Prishtina uses its urban spaces. With his vision for Prishtina’s future, Mayor Përparim Rama is devising a new strategy for utilizing abandoned spaces. He strives to transform these areas into active centers that would foster cultural, social, and economic development.

“

Kjo strategji jo vetëm që do ta rikthejë vlerën e këtyre hapësirave, por gjithashtu do ta fuqizojë identitetin urban. Përmes kësaj interviste, kryetari Rama na zbulon më tepër rreth synimeve për t`i rikthyer përjetimet e Prishtinës së Vjetër, në një dimension të ri.

This strategy will not only revitalize these spaces, but also strengthen urban identity. In this interview, Mayor Rama reveals much about his attempts to bring Old Prishtina’s experiences into a new dimension.

Cili është vizioni juaj për hapësirat e braktisura në Prishtinë?

Janë një numër i madh i objekteve me vlera historike e kulturore në Prishtinë të cilat kanë qenë të harruara. Disa prej këtyre objekteve ose zonave janë: Tullëtorja, ish-objekti i Gërmisë, ish- objekti i Kino Rinisë, zona e Prishtinës së Vjetër, Shkolla e Parë e Prishtinës, e disa shtëpi që janë të mbrojtura me ligj.

Për të gjitha këto kemi një vizion të qartë dhe për shumicën prej tyre tanimë kemi filluar punën e transformimit dhe të kthimit në shërbim të qytetarëve.

Tullëtorja është në proces të rikthimit në funksionalizim, si do t'i shërbejë kjo hapësirë qytetarëve të Prishtinës?

Tullëtorja është një hapësirë e braktisur, e cila nuk është rigjeneruar dhe vënë në funksion të qytetarëve të Prishtinës dhe të krejt Kosovës. Është një hapësirë me potencial të madh, larg prej shesheve kryesore të qytetit vetëm rreth 5 minuta. Posa kam marrë mandatin kemi filluar ta vëmë në shfrytëzim duke organizuar evente, siç ka qenë event i ndërkombëtar Manifesta Bienale. Suksesi i Manifesta Bienale në atë lokacion konfirmoi vizionin tonë se ai vend duhet të shndërrohet në një vend të shfrytëzueshëm nga komuniteti artistik dhe nga komuniteti i teknologjisë informative.

What is your vision for abandoned spaces in Prishtina?

There are quite a lot buildings with cultural and historical significance that have lapsed into oblivion. Some of these buildings or areas are as follows: the Brick Factory (in Albanian Tullëtorja), Gërmia's Mall building, Kino Rinia, the area of Old Prishtina, the First School of Prishtina, and some other legally protected houses. We have a clear vision for all of these, and for most we already started the transformation process to return them to our citizens.

While the Brick Factory is in the process of becoming functional, how will this place cater to the needs of Prishtina's residents?

The former Brick Factory is an abandoned place that has not yet been revived or functionalized for citizens of Prishtina and Kosova. It's a space with great potential, just five minutes away from Prishtina's main squares. Once I became mayor, we commenced to reuse it by organizing events such as the international Manifesta Biennale. The success of this event confirmed our vision that this place needs to be transformed into a usable space for the artistic and information technology

Për këtë arsye, kemi shpallur thirrje ndërkombëtare për projekt-ide dhe kemi përzgjedhur projektin e Rafi Segal-it, si fitues. Ky projekt udhëhequr nga profesionistë dhe profesorë të universitetit prestigjioz amerikan MIT (Massachusetts Institute of Technology) do të transformojë tërësisht Tullëtoren në një Qendër për Art dhe Teknologji (Art Tek' Center). Gjatë procesit të transformimit do të ruhet identiteti i trashëgimisë të arkitekturës industriale, do të krijohen hapësira pune frymëzuese për komunitetin artistik dhe të teknologjisë që të zhvillojnë idetë e tyre.

Për më tepër, ky projekt do të ketë edhe një amfiteatër, i cili do të përdoret për evente të ndryshme. Ky amfiteatër do të ndërtohet duke iu përshtatur pozicionit natyral të terrenit dhe do të lidhë kështu Kodrën e Trimave me Tophanen. Kjo do të krijojë një ambient jashtëzakonisht të bukur për mbajtjen e eventeve publike.

Gjithashtu, objekti i ish-ndërmarrjes "Gërmia" po rikthehet në jetë në formë të sallës koncertale dhe muzeu arti, si pritet të ndikojë ky transformim në infrastrukturën kulturore të Prishtinës?

Po, ish-Gërmia, një hapësirë tjetër e pashfrytëzuar dhe e lënë anash nga administratat e kaluara, më në fund do të transformohet në një objekt të shfrytëzueshëm për të gjithë. Transformimi i këtij

communities. This is why we issued an international call for project ideas, and Rafi Segal's project won. This project, led by professionals and professors from the prestigious American institution MIT (Massachusetts Institute of Technology), will transform altogether the Brick Factory into an Art Tech Center. During this transformation, the identity of the industrial architecture will be retained, and new inspiring working spaces will be created for the artistic and technology community.

Furthermore, this project is set to include an amphitheater, which will be used for various occasions. It will be build in harmony with the natural terrain, connecting the Kodra e Trimave with Tophane neighborhoods. It will be a remarkably beautiful environment for hosting public events.



Hotel Sirius, në zemër të Prishtinës!

Hoteli ynë u ofron të gjithë mysafirëve një përvojë luksoze dhe komode. Me enterieri elegante, dhoma dhe suita të përshtatshme, pajisjet e nivelit më të lartë, restorant në katin më të lartë me një pamje mahnitëse të qytetit dhe hapësira për konferenca pune, ne përpiqemi t'i ofrojmë çdo mysafiri një përvojë të paharrueshme.

Që nga momenti që hyni në hollin tonë, do të përshëndeteni nga stafi ynë miqësor, i cili është i përkushtuar për të siguruar që qëndrimi juaj të jetë sa më i këndshëm. Pavarësisht nëse jeni duke udhëtuar për punë apo pushime, ne kemi gjithçka që ju nevojitet për ta bërë qëndrimin tuaj të rehatshëm dhe komod.

Hotel Sirius, located in the heart of Pristina!

Our stunning hotel offers guests a luxurious and comfortable experience. With our elegant decor, spacious rooms, top-notch amenities, and a roof-top restaurant with a stunning view, we strive to provide each guest with an unforgettable experience.

From the moment you step into our lobby, you will be greeted by our friendly staff who are dedicated to ensuring your stay is as pleasant as possible. Whether you are traveling for business or pleasure, we have everything you need to make your stay comfortable and convenient.



objekti është disenjuar nga Kengo Kuma, një prej arkitektëve më të njohur në botë, i cili ka bërë një punë të mrekullueshme me planifikimin e hapësirave të brendshme, shtimin e pjesëve të nevojshme, çdoherë duke ruajtur vlerat e trashëgimisë që ka objekti.

Janë paraparë dy hapësira kryesore: salla koncertale dhe galeria e artit, të cilat do të jenë në shfrytëzim të gjithë komunitetit muzikor dhe artistik. Do të jenë hapësira mbresëlënëse të disenjuara me kujdes dhe të dedikuara për koncerte dhe ekspozita arti. Po ashtu, do të ketë edhe hapësira të tjera përcjellëse.

Fatkeqësisht, për afër një vit, fondet e destinuar nga Bashkimi Evropian për transformimin e këij objekti janë ngrirë për shkak të masave të aplikuara ndaj Qeverisë Republikës së Kosovës. Pavarësisht nga fakti se ne jemi nivel lokal i qeverisjes, dhe nuk kemi të bëjmë asgjë me zhvillimet politike të relacionit Qeveri - BE, prapëseprandaj fondet janë ngrirë. Jemi duke folur për një buxhet prej rreth 20 milionë euro që do të bënte këtë projekt realitet. Mirëpo as këto sfida nuk na kanë ndaluar që të hapim këtë ndërtesë në Prishtinë e Kosovën. Është hapja e ekspozitës Reporting House për njerëzit të 25-vjetorit të çlirimit të Prishtinës dhe ju ftoj të gjithëve që ta vizitoni.

Cilat janë planet për të mbrojtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore dhe historike të Prishtinës?

Dy prej projekteve të transformimit të objekteve me vlera kulturore e historike të Prishtinës veçse i përmenda, Tullëtorja dhe ish-Gërmia. Projekt tjetër është ndërtimi i Sheshit të Prishtinës së Vjetër. Kjo do të realizohet duke shndërruar rrugën Ibrahim Lutfiu në Sheshin e Prishtinës së Vjetër. Qëllimi primar është të mbrohet trashëgimia kulturore dhe historike e Prishtinës dhe që qytetarët tanë, diaspora e vizitorët e huaj ta gëzojnë atë zonë si duhet duke shëtitur e eksploruar këto pasuri të Prishtinës të papenguar nga veturat e shumta dhe nga zhurma.

Rruga Model është, po ashtu, një rrugicë e Prishtinës, e cila është shtruar me kalldrëm, si dhe është

Meanwhile, the building of the former Gërmia is being revived as a Concert Hall and Art Museum. Will this transformation impact Prishtina's cultural infrastructure?

Yes, the Gërmia building, another unusable space, will finally be transformed into a functional venue for everyone. The transformation of this building has been designed by Kengo Kuma, one of the world's most renowned architects, who did outstanding work in planning the inner spaces and

adding necessary parts while retaining the building's heritage values. Two main spaces are planned: a concert hall and an art gallery, which will be used by the music and artistic communities. These will be impressive spaces carefully designed for concerts and art exhibitions, with additional spaces as well.

Unfortunately, since a year ago, the funds provided by the European Union for this transformation have been frozen due to measures taken against the Government of Kosovo. Despite being just a local governing body and not involved in the political relations between government and the EU, these funds are frozen. This budget, amounting to around

20 million euros, would make this project a reality. However, these challenges do not prevent us from opening this building. It currently hosts the Reporting House exhibition in honor of the 25th anniversary of Prishtina's liberation, and I invite everyone to visit it.

What are your plans to protect and promote Prishtina's cultural and historical heritage?

I mentioned two main projects for transforming Prishtina's historical and cultural objects. Another project involves constructing the Old Prishtina Square by transforming Ibrahim Lutfiu Street into a pedestrian area. Its primary purpose is to protect Prishtina's cultural and historical

“Rruga Model është, po ashtu, një rrugicë e Prishtinës, e cila është shtruar me kalldrëm, si dhe është investuar në të gjitha shtëpitë dhe dyqanet e rrugës për t'i dhënë një pamje të rivitalizuar, por duke ruajtur vlerat e vjetra.

Rruga Model is also a street of Prishtina paved with cobblestones, with investments made in all surrounding houses and shops to revive the area while retaining its original values.



investuar në të gjitha shtëpitë dhe dyqanet e rrugës për t'i dhënë një pamje të rivitalizuar, por duke ruajtur vlerat e vjetra.

Më tutje, dyqanet e vjetra artizanale në rrugën Agim Ramadani, në zonën e njohur si Te plepat, gjithashtu, do të rindërtohen prej materialeve të drurit për të ringjallur ndjenjën që dikur e kishte ajo rrugë. Edhe ish-objekti i Kino Rinisë në rrugën Migjeni është vënë në listën e hapësirave të mbrojtura, ku një pjesë e kinos do të rigjenerohet duke ruajtur vlerat kulturore që ka ai objekt. Më pas është Shkolla e Parë e Prishtinës, po ashtu në rrugën Agim Ramadani, e cila pritet të restaurohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pasi është nën kompetencë të nivelit qendror. Janë edhe një numër i shtëpive të vjetra të mbrojtura me ligj, të cilat do të restaurohen, nën menaxhimin e Ministrisë dhe po presim që të fillojë restaurimi i tyre sa më parë.

Të gjitha këto do të na bëjnë të kemi një përjetim të Prishtinës së Vjetër duke rikthyer dhe ruajtur vlerat historike dhe kulturore të kryeqytetit tonë, pra të krijojmë një Prishtinë të përjetimeve.

heritage, allowing our citizens, diaspora and foreign visitors to enjoy this area without being hindered by cars and noise.

Ruga Model is also a street of Prishtina paved with cobblestones, with investments made in all surrounding houses and shops to revive the area while retaining its original values. The old craftsmen's shops on Agim Ramadani Street, in the area known locally as Te plepat, will be rebuilt with wooden materials in a way to revive the feelings this road used to evoke.

The building of Kino Rinia on Migjeni Street has been placed on the list of protected spaces, where a part of the old cinema will be regenerated while retaining its cultural values. Similarly, the First School of Prishtina on Agim Ramadani Street will be restored by the Ministry of Culture, as it falls under their authority. Several old, legally protected houses are awaiting restoration, and we hope this process begin as soon as possible.

Tullëtorja - destinacion i ri për art e teknologji

E ndërtuar në vitin 1974 dhe e konsideruar si hapësira më e rëndësishme postindustriale e Prishtinës, ish-Fabrika e tullave ishte pjesë themelore e organizimit të infrastrukturës në Kosovë. E pozicionuar në një hapësirë jo të vogël, kjo fabrikë procesoi qeramikë dhe materiale të tjera të pastra për të prodhuar tullat që ndërtuan një mori objektesh në kryeqytet. Ish-Fabrika e tullave ka një pamje të veçantë që merr vëmendje lehtësisht. Ajo karakterizohet nga fasada me ngjyrë të kuqe të errët dhe me shumë dritare të mëdha e katrore.

Pas ndërprerjes së punës si fabrikë, objekti i ishte lënë në menaxhim Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Pastaj, Komuna e Prishtinës e mori

godinën, me qëllim që t'ia kthejë publikut si një hapësirë të re për qytetin. Ishte Bienalja Manifesta 14, e cila nga një hapësirë të papërdorur e riktheu në funksion pas shumë vjetësh, duke e shndërruar në një Qendër për Mësim Eko-Urban.

Tashmë Tullëtorja do të jetë në duart e profesorit Rafi Segal, i cili bashkë me ekipin e tij janë fitues të konkursit ndërkombëtar për transformimin e saj në një pikë kulturore dhe qendër për kreativitet dhe inovacion.

Ekipi punues për këtë projekt është shprehur se do të sjellin një standard të ri në Kosovë, duke bërë që ish-Fabrika e tullave të shndërrohet në një vend të trashëgimisë industriale.

Në njoftimin e Departamentit për Arkitekturë të këtij universiteti thuhet

The Brick Factory - A New Urban Destination for Art and Technology

JETA ZYMBERI

Built in 1974 and reckoned as Prishtina's most important post-industrial space, the former Brick Factory was a vital part of infrastructure development in Kosova. Situated in a spacious area, the factory processed clay and other raw materials for brick production, which were used in many buildings in Prishtina. The former Brick Factory has a distinctive outlook, easily spotted from afar. It features a bright red façade and many large, square windows.

When the factory ceased its activity, the building passed under the administration of the Kosova Privatization Agency. Afterwards, the Municipality of Prishtina acquired the building with the aim of returning it to public as a new space for the city. Thanks to Manifesta 14 Biennale, this unused space was converted into a functional one, rendering it into an Eco Urban Learning Centre.

From now on, the former Brick Factory will be handled by Professor Rafi Segal and his team, who won an international competition to transform it into a cultural hub and center for creativity and innovation.

The team has stated its intent to introduce a new standard in Kosova, paving the way for the former Brick



FOTO: ANDI QARRI

se sipas Segal-it, “arkitektura, arti, peizazhi, hapësira publike dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë integruar plotësisht në këtë projekt për të transformuar ish-Fabrikën e Tullave në një destinacion të ri urban të përqendruar rreth artit dhe teknologjisë”.

Ky objekt, pritet t’i japë frymë të re zhvillimore kryeqytetit.

E rikthimi i saj në funksion të artit s’ka se si të mos i gëzojë edhe artistët. Kushtrim Koliqi, regjisor dhe drejtor ekzekutiv në organizatën Integra thotë se kjo është një ide e jashtëzakonshme, sepse “me të vërtetë Prishtina ka nevojë për hapësira të tilla ku arti, kultura dhe inovacioni janë bashkë, dhe ku të rinjtë, dhe jo vetëm të rinjtë, mund të kenë përmbajtje, aktivitete, prodhime, të cilat do ta gjallërojnë edhe më shumë Prishtinën”.

“Madje, ky transformim do të jetë edhe një trashëgimi e jashtëzakonshme e Manifestës, ndoshta trashëgimia kryesore e saj dhe nëse kjo ndodh, dhe besoj shumë që do të ndodhë, atëherë Manifesta si projekt do të ketë edhe më shumë kuptim pse ka ndodhur në Prishtinë. Besoj se Tullëtorja do të jetë si pikë identitare e re Prishtinës. Nëse Prishtina i ka 4-5 pika që e identifikojnë këtë qytet, unë besoj fort që Tullëtorja do të jetë njëra prej tyre”, thotë Koliqi.

Tashmë Tullëtorja do të jetë në duart e profesorit Rafi Segal, i cili bashkë me ekipin e tij janë fitues të konkursit ndërkombëtar për transformimin e saj në një pikë kulturore dhe qendër për kreativitet dhe inovacion.

“

From now on, the former Brick Factory will be handled by Professor Rafi Segal and his team, who won an international competition to transform it into a cultural hub and center for creativity and innovation.

Factory to become a site of industrial heritage.

In an announcement issued by the MIT Department of Architecture, Segal’s words were echoed: “Architecture, art, landscape, public space, and sustainable development are fully integrated in this project to transform the former brick factory into a new urban destination centered on the arts and technology”.

This building is set to bring new development to Prishtina. The return of the Brick Factory to the service of art has been met with joy by artists. Kushtrim Koliqi, director and executive director of Integra, deems this as an outstanding idea, because “Prishtina truly needs such spaces where art, culture, and innovation come together, and young people and others can hold events, activities, and productions that will help Prishtina thrive”.

“Moreover, this transformation will be a remarkable legacy of Manifesta, probably its main legacy. If this happens, and I am positive it will, then Manifesta as a project will become more meaningful for having chosen Prishtina. I believe the Brick Factory will become a new identity spot for Prishtina. If Prishtina has four or five spots recognizable as identifiers of the city, I strongly believe the Brick Factory will be one of them”.



Ish-Gërmia - shtëpia e re e artit dhe artistëve

Gërmia veçse ka nisur t'u bëjë konak ngjarjeve kulturore. E destinuar si qendër e artit bashkëkohor, këto ditë hapësira në katin përdhes, hapi dyert për ekspozitën Reporting House, që pasqyron punën e gazetarëve e fotoreporterëve, duke sjellë para publikut rreth 150 storie të rrjeteve televizive botërore që janë transmetuar me xhirime për Kosovën ndërmjet viteve 1992 dhe 1999

JETA ZYMBERI



FOTO: ANDI QARRI

Endërtuar në mes të viteve 1970-72, ish-shtëpia e mallrave Gërmia, ndodhet në qendër të kryeqytetit, në sheshin Nënë Tereza. Kjo ndërtesë, që është në mesin e ndërtesave ikonike të Prishtinës, përfaqëson arkitekturën moderniste të viteve '70.

Gërmia karakterizohej nga struktura e jashtme, e cila ishte e veshur prej alumini dhe gjithashtu ishte ndërtesa

Gërmia- The New Home for Art and Artists


Gërmia already hosts cultural events. Conceived as a center for contemporary art, the ground floor recently opened its doors for Reporting House exhibition, conveying the work of journalists and photo journalists with around 150 stories dedicated to Kosovo from international television networks aired between 1992 and 1999

Built on early 1970s, the former Gërmia Mall lies in the very heart of Prishtina on Nënë Tereza Square. As one of Prishtina's most iconic buildings, it embodies the modernist architecture of the 1970s.

Gërmia was known for its peculiarly distinctive exterior, inlaid with aluminum, and was the first building in Prishtina equipped with escalators. About half of its overall space of 8,500 square meters housed various shops. The building had its own restaurant, commodity market and other shops.

The post-war period brought a new destiny for this once-public company. The state-run company was transformed into an administration building. Now, Gërmia is set for another transformation, namely into a concert hall, a project deemed crucial by artists.

While work is underway, Gërmia already hosts cultural events. Conceived as a



e parë në Prishtinë që kishte shkallë lëvizëse. Rreth gjysma e sipërfaqes totale prej 8500 m2 përdorej për dyqane të ndryshme. Ndërtesa kishte restorantin e saj, dyqan komoditeti dhe dyqane të tjera.

Paslufta në Kosovë solli një fat ri për ish-ndërmarrjen shoqërore. Prona e administruar nga shteti u kthye në destinim për administratë.

Tash, Gërmia po pret për një transformim të ri - shndërrimin në sallë koncertale, projekt ky që artistët e konsiderojnë të domosdoshëm.

Përderisa procesi i punës po vazhdon, Gërmia veçse ka nisur t'u bëjë konak ngjarjeve kulturore. E destinuar si qendër e artit bashkëkohor, këto ditë hapësira në katin përdhes, hapi dyert për ekspozitën Reporting House, që pasqyron punën e gazetarëve e fotoreporterëve, duke sjellë para publikut rreth 150 storie të rrjeteve televizive botërore që janë transmetuar me xhirime për Kosovën ndërmjet viteve 1992 dhe 1999.

Besa Luzha, profesorëshë në Akademinë e Arteve dhe aktiviste thotë se lajmi që ish-Gërmia po pritet të kthehet në shërbim të artistëve dhe qytetarëve të Prishtinës, për rishfrytëzimin e këtij objekti në të mirë të skenës kulturore i gëzon artdashësit.

"Skena kulturore posaçërisht në Prishtinë ka pak objekte të përshtatshme. Prishtina është kryeqytet, prandaj duhet ta ketë 'shtëpinë e saj të kulturës' ku artistët e zhanreve të shumta mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre", thotë Luzha.

Ajo thotë se scena muzikore artistike është aq e pasur me aktivitete, por se ato mund të realizohen në mënyrë efektive vetëm në kushtet e duhura.

"Improvizimet që jemi duke i bërë tani, nuk duhet të japin

center for contemporary art, the ground floor recently opened its doors for Reporting House exhibition, conveying the work of journalists and photo journalists with around 150 stories dedicated to Kosovo from international television networks aired between 1992 and 1999.

Besa Luzha, an activist and professor at the Academy of Arts, considers the transformation of Gërmia into a center of arts as a positive development for art lovers.

"The cultural scene, especially in Prishtinë, has very few adequate venues. Prishtina, as the capital, needs its own 'cultural home' to cater to the needs of artists from various genres", Luzha says.

She believes that while the artistic and musical scene abounds with activities, it requires appropriate infrastructure to thrive effectively.

"Currents improvisations should not be interpreted as satisfaction within the community, but rather as a call for swift investment to functionalize as soon as possible these spaces for public benefit and cultural services".



mesazh se komuniteti është i kënaqur, por të shpejtohet me investimet që këto hapësira të funksionalizohen sa më shpejt, për të mirën publike, për shërbimet kulturore që duhet t'i marrin me prioritet qytetarët e Prishtinës, por edhe të Kosovës e më gjerë”.

Sopranoja Adelina Paloja, që ka pasur shansin të performojë në shumë vende të ndryshme, thotë se e ndiente përherë mungesën e një hapësire të tillë në Prishtinë, e cila nuk është thjesht një ndërtesë, por një qendër e gjallë e krijimtarisë ku arti merr jetë.

“Andaj rikthimi i objektit të ish-Gërmisë në një hapësirë dedikuar

muzikës dhe artit më gëzon duke iu ofruar artistëve, më në fund, një skenë profesionale moderne dhe të mirëprojektuar për të performuar”, thotë Paloja.

Sipas saj, kthimi i kësaj hapësire në shërbim të artit, jo vetëm që ndërgjegjëson dhe është inkurajim edhe për brezat e ardhshëm, por në mënyrë direkte do të ndihmonte në promovimin e Prishtinës si një destinacion kulturor dhe do të kontribuonte pashmangshëm në imazhin kulturor, krijimin e një komuniteti më të lidhur dhe të informuar për kulturën, njëherësh do ta ndihmonte edhe ekonominë e vendit.

Adelina Paloja, a soprano who has performed internationally, has long felt the need for an appropriate space in Prishtina, which could serve as a living center of art. “This is why I am happy that the Gërmia building is dedicated to music and art, providing the artists with a modern, professional venue”, Paloja says. She adds that converting Gërmia into an artistic center not only encourages future generations but also promotes Prishtina as a cultural destination, contributing to its cultural image and economic development as well.

Reporting House

Duke shënuar një çerek shekulli nga përfundimi i luftës në Kosovë, ekspozita Reporting House i ofron publikut vendor dhe vizitorëve të huaj një pasqyrim të hollësishëm të luftës tonë evropiane që përmbylli shekullin e 20-të.

E prodhuar nga BIRN Kosova, Kallxo.com, Prishtina Biennale dhe Paper Gallery, ekspozita prezanton punën e gazetarëve, fotografëve dhe artefakte të punonjësve të

mediave, punë këto që vendosen krahas veprave të artit bashkëkohor që reflektojnë mbi ndikimin e luftës në dekadat që pasuan.

Ekspozita e Reporting House u mundëson vizitorëve të udhëtojnë në konfliktin që po vlonte gjatë viteve 1990, nga i cili lindi lëvizja guerile e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që më vonë shpërtheu në luftë në vitet 1998-1999 dhe kulmoi me 11 javë të sulmeve ajrore të NATO-s që çuan në çlirimin

Marking a quarter of a century since the end of the Kosovo war, the Reporting House exhibition offers today's Kosovars and visitors to the country detailed insight into the European war that closed the 20th century. Presented by BIRN Kosovo, Kallxo.com, Prishtina Biennale and Paper Gallery, the exhibition showcases journalism, photography and media artefacts of the time, positioned alongside contemporary artwork exploring

e Kosovës dhe në pavarësinë e saj në vitin 2008. Ekspozita shpalos draftin e parë të kësaj historie të shkruar nga gazetarët dhe demonstroi rolin qendror që e ka luajtur media krahas interpretimeve artistike të mëvonshme të kësaj historie. Publiku ftohet që ta kuptojë më tej historinë e jashtëzakonshme të Kosovës, ndërsa ekspozita është e hapur për bashkëpunim për zhvillimin e saj të mëtejshëm.

Ekspozita prezanton vepra të artistëve që vinë prej vendeve të ndryshme dhe emra të njohur nga bota e artit si Anri Sala e Adrian Paci, Goncalo Mabunda, Lala Meredith Vula, Zhana Kadyrova, Lana Cmajcanin, Olafur Eliasson, Laura Imami dhe Besa Llugiqi e deri te artistët e rinj si Vullnet Jakupi dhe Vita Kasapolli.

Si pjesë e kësaj ekspozite prezantohen rreth 150 storje televizive të rrjeteve televizive botërore që janë transmetuar me xhirime për Kosovën ndërmjet viteve 1992 dhe 1999 nga BBC, Das Erste, Nippon TV, NHK, RTE, EO 2 Vandaag, Tele 5 dhe Frontline Television News. Këto reportazhe promovojnë punën e gazetarëve, fotografëve, operatorëve të kamerave dhe përkthyesve e producentëve lokalë që punuan në to.

Kontribuuesit në këtë ekspozitë janë Jeremy Bowen, Ben Brown, Ilaz Bylykbashi, Thomas Dworzak, Alan Chin, Donika Shahini, Paul Lowe, Max Stahl, Ridvan Slivova, David Loyn, Jehona Lushaku, Besnik Mehmeti, Nik Millard, Andrew Testa, Pal S. Refsdal, Flaka Surroi, Hazir Reka, Marija Ristić, Fred Scott, Eliza Hoxha, Vaughan Smith, Nora Weller, Sean Whelan, Goran Tomasević, Sami Mustafa, Alban Bujari, Linda Gusia, Eki Rrahmani, Gazmend Avdiu, Srebrenica Memorial Center, Anibar, Koha Ditore, RTK dhe Oral History Kosovo.

Reporting House hapet në Shtëpinë e Mallrave të Prishtinës "Gërmia", që për herë të parë shndërrohet në hapësirë kulturore. Këtu dhe në dy hapësira tjera, në Hamamin e Prishtinës dhe Paper Gallery, Shtëpia e Gazetarëve synon të krijojë ambient për përsiatje, dialog dhe katarzë, duke e nderuar kujtimin për ata që kanë pësuar nga lufta në Kosovë dhe avokon për një të ardhme pa luftë.

Ekspozita është realizuar nga Jeta Xharra dhe kuruar nga Gazmend Ejupi. Pjesa më e madhe e materialit televiziv arkivor dhe artefakteve janë dhuruar nga Vaughan Smith nga Frontline News Television që punoi në Kosovë në 1998-1999.

Ekspozita do të jetë e hapur deri në mes të shtatorit.



and reflecting on the impact of the war in the decades since. The REPORTING HOUSE exhibition enables visitors to navigate a conflict that simmered through the 1990s, gave birth to the guerilla Kosovo Liberation Army, boiled over into war in 1998-1999 and culminated in 11 weeks of NATO airstrikes leading to the liberation of Kosovo and, in 2008, its independence. The exhibition displays the first draft of this history, written by journalists, and demonstrates the central role played by the media alongside subsequent artistic interpretations of that history. The public is invited to further its understanding of Kosovo's extraordinary story, while the exhibition is open to collaboration for its further development. The exhibition will present works by artists of diverse backgrounds and regions, from established names such as Anri Sala, Adrian Paci, Goncalo Mabunda, Lala Meredith Vula, Zhana Kadyrova, Lana Cmajcanin, Laura Imami and Besa Llugiqi to emerging artists like Vullnet Jakupi and Vita Kasapolli. The exhibition will feature 150 television stories from Kosovo between 1992 and 1999 by the BBC, Das Erste, NHK, RTE, EO 2 Vandaag, Tele 5 and Frontline News Television, promoting the work of the journalists, photographers, camera operators and local fixers who made them. Contributors include Jeremy Bowen, Ben Brown, Ilaz Bylykbashi, Thomas Dworzak, Alan Chin, Eliza Hoxha, Paul Lowe, Max Stahl, Ridvan Slivova, David Loyn, Jehona Lushaku, Besnik Mehmeti, Nik Millard, Andrew Testa, Pal S. Refsdal, Hazir Reka, Marija Ristić, Fred Scott, Donika Shahini, Vaughan Smith, Nora Weller, Sean Whelan, Goran Tomasević, Sami Mustafa, Alban Bujari, Linda Gusia, Eki Rrahmani, Srebrenica Memorial Center, Anibar and Oral History Kosovo. With three venues: Gërmia Department Store, The Great Hammam and Paper Gallery, Reporting House creates a space for contemplation, dialogue, and catharsis, honouring the memory of those affected by the war in Kosovo while advocating for warless ways forward. The exhibition is produced by Jeta Xharra and curated by Gazmend Ejupi.

The majority of the television archive material and artefacts has been provided by Vaughan Smith of Frontline News Television.

The exhibition will be open until the middle of September.

Rezidenca 17: Hapësirë që mbështet procesin krijues të artistëve e studiuesve

Residence 17: A Space that Supports Creativity among artists and researchers

SIHANA KLISURICA



FOTO: ERMAL META

Rezidenca 17 zë vend në objektin që dikur i përkiste shkrimtarit të njohur shqiptar Hivzi Sulejmani (1910 - 1975), një figurë e shquar në letërsinë shqiptare. Sulejmani ka bërë një jetë aktive, ai përveç me shkrime, është marrë edhe me politikë dhe për një kohë ka mbajtur detyrën e gjyqtarit. Duke u tërhequr nga jeta publike në moshën 53-vjeçare, ai i kaloi vitet e tij të fundit në rezidencën e tij në Taslixhe, ku shkroi tregimin e tij të fundit dhe ia la trashëgimi komunitetit shtëpinë e tij para se të vdiste. Në fund të vitit 2021, Shtatëmbëdhjetë nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Komunën e Prishtinës, duke siguruar kështu menaxhimin për një mandat 5-vjeçar të shtëpisë së Hivzi Sulejmanit në lagjen Taslixhe. Brenda kopshtit të madh, tani gjendet biblioteka e fëmijëve, që mban emrin e tij, dhe Rezidenca 17.

Duke shërbyer si një program dinamik rezidencial gjatë gjithë vitit, Rezidenca 17 i fton artistët, teoricienët, shkrimtarët, shkencëtarët dhe studiuesit përmes thirrjeve të hapura. Programi përfshin rezidenca tematike lokale, shkëmbime ndërkombëtare dhe qasje në studio të pajisura mirë që plotësojnë nevoja të ndryshme krijuese.

Me hyrjen në hapësirë, dy dhoma pune të përbashkëta, Dhoma të bashkëpunimit, akomodojnë individë që

Residence 17 is located in the home that once belonged to the renowned Albanian writer Hivzi Sulejmani (1910-1975), an outstanding figure of Albanian literature. He led an active life for in addition to writing he engaged in politics and held the position of a judge for a while. After retiring from public life at the age of 53, he spend his remaining years at his residence in Taslixhe, where he wrote his last story and bequeathed his house to the community in his will. At the end of 2021, Foundation "Seventeen" signed a Memorandum of Understanding with the Municipality of Prishtina, thus granting a five-year mandate to manage his house in Taslixhe. Within the vast garden, there is now a children's library named after him and Residence 17.

Serving as a residential dynamic program throughout the year, Residence 17 invites artists, theoreticians, writers, scientists and scholars through open calls. Its program conveys local thematic residencies, international exchanges, and access to well-equipped studios that cater to various creative needs. Upon entering the space, two common working rooms, known as "Collaborative Rooms", accommodate individuals who use the studios or



përdorin studiot ose marrin pjesë në programin e rezidencës. Këto dhoma bashkëpunimi, shpesh të rezervuara për kërkime, shkrime ose projekte bashkëpunuese, gjithashtu janë të përshtatshme për punëtori dhe trajnime si pjesë e programit të Rezidenca 17. Sunroom (Dhoma e diellit) ngjitur, e mbushur me bimë dhe dritë natyrale, ofron një mjedis ideal për të shijuar vaktet, pijet ose për të bërë telefonata të shkurtra, pa i shqetësuar ata që punojnë në dhomat e bashkëpunimit.

Ndërsa kati i parë inkurajon punën dhe ndërveprimin, përdhosi strehon tri studio të pajisura mirë. Dhoma Ndërdisciplinore mundëson instalime në shkallë të vogël ose punë në grup, kurse Dhoma AV është e përshtatshme për projekte që përfshijnë videon dhe audion, e pajisur me kompjuter, kamerë dhe sistem të zërit. Ngjitur me të është Dhoma e Printimit e pajisur me printer 3D, skaner dhe printer

tradicional. Të gjitha këto hapësira krijuese janë të disajnuara në atë formë që të jenë në shërbim të të gjithë komunitetit, pa dallim, me idenë e mbështetjes për krijimin e veprave të tyre artistike, hulumtuese dhe kreative.

Rezidenca 17 bashkëmenaxhohet me Komunën e Prishtinës, dhe qasja në secilën prej hapësirave është shumë e lehtë dhe e thjeshtë. Shtatëmbëdhjetë, në baza javore, në rrjetet, kanalet e saj zyrtare ndan formën e regjistrimit për të gjithë ata që janë të interesuar. Krejt çka nevojitet për shfrytëzim të studiove është regjistrimi i thjeshtë, pa pasur nevojë të aplikojnë apo paguajnë hapësirën.

Shtatëmbëdhjetë, përmes programit që shpalo në Rezidenca 17 mëton të krijojë një hapësirë gjithëpërfshirëse dhe të mbështesë sa më shumë individë apo grupe në proceset e tyre krijuese dhe zhvillimore.

participate in the residency program. These rooms, often reserved for research, writing and collaborative projects, are also suitable for workshops and training sessions as part of the program of Residence 17. While the first floor of the building encourages work and interaction, the ground floor contains three well-equipped studios. "Interdisciplinary Room" affords small-extent installations or group work, "AV Room" is suitable for projects that include video and audio, being equipped with computer, camera and voice system. Contiguous with it is "Printing Room" equipped with 3D printer, scanner and traditional printer.



All these creative spaces are designed in that way as to be in the service of the entire community with the idea to support creation of artistic, investigative and creative works. Residence 17 is co-managed with Municipality of Prishtina and the access to any of the spaces is very easy and simple. In weekly basis, "Seventeen" through its social media and channels shares registration form for all those interested. All that is required for using the studios is a simple registration without the need to apply or pay for the space. "Seventeen", through its program that is unraveled in Residence 17, aims to create an all-embracing space and support as many individuals or groups in their creative and development process.

Meli Qena: E dua këtë teatër

Rrëfimi i saj është një udhëtim nëpër kohë, i cili nis me fëmijërinë, e na mban për dore e na çon deri në botën magjike të Teatrit të kukullave dhe angazhimit të saj të pakompromis që nga viti 1987.

JETA ZYMBERI

Meli Qena: I Love This Theatre

Her story is a voyage through time that starts out in her childhood, takes us by the hand, and leads us into the magical world of the Dolls Theatre, where she has been unwaveringly committed since 1987.



FOTO: ERMAL META

Në zemër të Prishtinës sonë, në lagjen e vjetër, aty ku rrugët e ngushta ndërthuren, ndodhet një thesar i çmuar: Teatri i kukullave Dodona. Është shtëpia e dashur për fëmijët, vendi ku ata zhyten në magjinë e kukullave, zhvillojnë imagjinatën e bëhen pjesë e shfaqjeve.

“

In the heart of Prishtina, amid an old suburb where tight streets crisscross, lies a priceless treasure: the Dolls Theatre Dodona. It is a beloved house for children, a place they fully immerse themselves in the magical charm of dolls, develop their imagination, and suddenly become part of the plays. Dolls



Teatrit i kukullave Dodona u ngrit më 16 maj 1987 dhe hapi dyert me premierën e shfaqjes Pylli është i të gjithëve. Ndërsa kalonin vitet, ky teatër u bë një oazë e kulturës për fëmijët e kryeqytetit.

E prapa shumë shfaqjeve e personazheve që marrin jetë në dërrasat e këtij teatri, qëndron një margaritar, është doajenia Melihate Qena. Me një profesionalizëm të jashtëzakonshëm, Meli, ashtu siç e njeh i madh e i vogël, me punën e saj si regjisore e aktore, sjell në jetë personazhe, të cilave u fal shumë dashuri. Kjo ishte arsyeja pse 1 Qershori, Dita e Fëmijëve, na gjeti pikërisht në hapësirën e Teatrit të kukullave, ku shkuam për të gjurmuar përvojën dhe kontributin e saj unik në këtë teatër.

Teatri zhvillon imagjinatën

Rritur në një familje të madhe, ku shpirti artistik ishte përherë i pranishëm, fëmijëria e aktore Meli Qena ishte e thjeshtë, gjithçka që zhvillohej, ishte kryesisht në imagjinatën e saj.

“Ne kemi qenë nëntë fëmijë”, tregon Meli, teksa pohon se as dëshirat e as ëndrrat nuk i janë plotësuar.

“Krejt fëmijëria jonë ka kaluar duke luajtur në rrugë me disa cukla, sepse nuk kemi pas teknikë atëherë. Në atë kohë, krejt çka ka ndodhur, ka ndodhur

në imagjinatën tënde. Sot, t’i jep të gjitha të gatshme interneti, por këto janë si fast food, krejt të gatshme, veç me i përpi. Ne në atë kohë, më shumë kemi jetuar të rrethuar me libra, me tregime të ndryshme të më të vjetërve. Kështu që kemi pasur mjaft kohë për të zhvilluar imagjinatën, ajo çka ka ndodhur, ka ndodhur në imagjinatë, jo në realitet. Tek unë ende vazhdon ajo periudhë, që më shumë të jetoj në ëndrra sesa në realitet”, thotë Meli.

Rrëfimi i saj është një udhëtim nëpër kohë, i cili nis me fëmijërinë, e na mban për dore dhe na çon deri në botën magjike të teatrit dhe angazhimit të saj të pakompromis që nga viti 1987, pas përfundimit të shkollës fillore dhe të mesme në Mitrovicë, një qytet, për të cilin ajo edhe sot ndien një detyrim të pakthyesëm.

Përfshirja e Melit në Teatrin e kukullave është një histori më vete.

Meli shtoi një dimension të ri në jetën e kukullave, duke i injektuar ato jo vetëm me shpirt, por edhe si një shtysë për të komunikuar mesazhe të thella dhe për të ndikuar pozitivisht në jetët e fëmijëve. Këtë intervistë, po e zhvillonim pikërisht në dhomën e kukullave, aty ku me qindra të tilla qëndrojnë të varura rreth e qark dhomës.

“Të gjitha këto kukulla, janë nga shfaqjet e mia, dhe secila kukull ka

Theatre Dodona was founded on May 16, 1987, and opened its doors with the premiere of the show *The Forest Belongs to All* (in Albanian “Pylli është i të gjithëve”). While the years passed by, the theatre has become a cultural oasis for Prishtina’s children.

Behind many of the characters brought to life on this theatre stage is a larger than life doyen, Melihate Qena, known affectionately as Meli. With her outstanding professionalism both as a director and actor, she brought into life numerous characters that were given a lot of passion. This is the main reason why on June 1, on the occasion of Children’s Day, we went in the Doll’s Theatre to gain a glimpse of her unique experience in this theatre.

Theatre Boosts the Imagination

Raised in a big traditional family, where the artistic spirit was always present, Meli Qena’s childhood was humble, with most of her experiences occurring in her imagination.

“We were a family of nine children”, Meli recounts, noting that neither her wishes nor her dreams came to life. “All our childhood was spent playing with old rugs in the streets, as we didn’t have any toys back then. Everything happened just in our imagination. Today, we find everything ready on the internet, but this is more like ‘fast food’, everything is ready-made, just to be consumed. Back then, we lived surrounded by books and stories told by the elders. We had plenty of time to develop our imagination, so everything that happened took place in our minds, not in reality. For me, it’s still the same for I live more in dreams than in reality”, Meli tells.

Her story is a voyage through time that starts out in her childhood, takes us by the hand, and leads us into the magical world of the Dolls Theatre, where she has been unwaveringly committed since 1987. She completed her primary and secondary education in Mitrovicë, a city for which she feels endless gratitude.

Meli’s involvement in the Dolls Theatre is a story in itself. She imbued a new



diçka timen, që e kam punuar me duart e mia, ose e kam përmirësuar. Kam punuar me dashuri të madhe, e dua këtë teatër”, thotë Meli teksa zëri i saj unik të bindë pas secilës fjalë që nxjerrë.

Meli i blinte vetë biletat për të mos dështuar shfaqja

Në kontrast me gjithë dashurinë e pasionin e saj për këtë teatër, Meli na përshkruan gjithashtu “luftën” për të mbajtur gjallë një institucion kulturor në një ambient ku mbizotëronte mungesa e mbështetjes nga institucionet përkatëse.

Tek ne në Kosovë, gjithçka nis me eufori të madhe, shembull, hajde po e formojmë Teatrin e kukullave, por pasi të formohet u mbetet në dorë atyre njerëzve që janë kyç aty të punojnë dhe ta vazhdojnë punën”.

Përveç mungesës së rrogave, në këtë teatër kishte edhe mungesë të shikuesve, madje Meli tregon se me mund të madh e kanë arritur këtë shikueshmëri, duke i lutur fëmijët të shkojnë në shfaqje, pasi s’e kishin as idenë se çfarë është Teatri i kukullave.

“Shpesh i kam blerë katër-pesë bileta vetë, veç për ta luajtur shfaqjen. Mandej kam pasur mosmarrëveshje edhe me ansamblin që pse po luajmë për pesë vetë. Por jam munduar t’u tregoj që po e trasojnë një rrugë, madje po e trasojnë pa mjete, me mundin e vet, me djersën e vet, me punën e vet. Disa kanë qëndruar, por shumica kanë

↑
“Por në të vërtetë, pos sfidave, ndërkëmbëzave e pengesave, s’besoj që ka pasur diçka tjetër në këtë teatër. Meqë e kam pasur shtëpinë mbrapa parkut, rrugës derisa kam shkuar në shtëpi, shpesh kam qarë.

“Actually, besides challenges and hindrances, I guess there was nothing else in this theatre. My home is near the park, so it often happened that I was crying while I went home.

dimension to the dolls’ lives, instilling them with spirit and using them to emanate deep messages and positively impact the lives of children.

This conversation took place in the dolls’ room, which was replete with dozens of them.

“All of these dolls are from my shows, and each one of them conveys something of myself, something I made or improved with my own hands. I worked with all-encompassing love for I love this theatre”, Meli says, and her distinctive voice adds further persuasion to every words she utters.

Buying the Tickets Herself So the Show Could Go On

In sharp contrast to her passion and love for this theater, Meli evokes the struggle to keep a cultural institution alive in an environment where support from relevant institutions is lacking. In Kosovo, everything begins with great euphoria, like establishing the Dolls’ Theatre, but once it is formed, the main burden remains only with those people who have been engaged to work there”.

Besides the lack of wages for the employees, this theater faced the challenge of attracting an audience. Meli explains the difficulties in reaching out to the public, begging children to see the plays as most of them had no notion of the Dolls’ Theatre.

“It often happened that I bought four to five tickets just to stage the play. I had disagreements

shkuar, sepse nuk mund t'i obligosh njerëzit", tregon Meli.

Ndërsa, pasqyra që ofron për raportin me fëmijët, të cilët i sheh si auditorët më të ndershëm dhe si burim i paçmueshëm i mësimave dhe i frymëzimit, ilustron në thelb një prej qëllimeve më fisnike të artit: të ndriçojë, të edukojë dhe të bëjë jetën më të pasur. "Për mua s'ka kënaqësi më të madhe se t'i gëzosh fëmijët me një shfaqje, gjithmonë rri pranë tyre, shikoj si po reagojnë, i pyes, mësoj prej tyre. Madje vazhdimisht rri edhe në sallë dhe aktorët e mi më thonë: a nuk po mërzhitesh që gjithmonë po vjen t'i shikosh shfaqjet? Por, unë ju them, nuk po i shikoj shfaqjet, po i shikoj fëmijët, e te fëmijët ke gjithmonë çka sheh".

"Besoj që fundin kam me pasë në teatër"

Dashuria që ajo ka ndaj këtij teatri nuk është farsë. Këtë e dëshmon fakti që përkundër pensionimit, ajo vazhdon të punojë për fëmijët.

"Besoj që fundin kam me pasë në teatër", thotë Meli, teksa tutje shprehet do të ishte shumë mirë në qoftë se e përcjell një fat i tillë.

Meli ngre edhe një apel, krijimin e Teatrit të kukullave në secilin qytet të Kosovës dhe vlerësimin e artistëve, duke argumentuar se vendi dhe roli i tyre tashmë është më i rëndësishëm se kurrë, në këtë kohë kur jeta dhe kultura janë nën ndikimin e teknologjisë dhe ndryshimeve të shpejta.

"Unë nuk kam ambicie me u shty me teknologjinë, por teatri ka



përparësitë e veta. Në këtë teatër luajnë aktorë të gjallë, unë asnjëherë nuk përdori mikrofona, sepse kam dëshirë që fëmijët ta dëgjojnë frymëmarrjen e aktorit, të shohin se dikush i gjallë po djersitet për ta, po punon për ta, dhe kjo nuk kompensohet me asgjë".

Krejt në fund, Meli foli edhe për rolin dhe përgjegjësinë e artistit në shoqërinë moderne, por sipas saj, artistët sot nuk po ndikojnë asgjë.

"Te ne po ndikon vetëm politika. Si duket politikanët po janë më artistë se artistët, meqë e kanë marrë rolin tonë, madje edhe po mbledhin publik më shumë, atëherë unë nuk di çka i ka mbetur artistit! Në shoqëri të tjera, çmohet e respektohet artisti, te ne e kanë lënë artistin në dorë të fatit, si njëfarë barre në shoqëri", thotë Meli, e cila vlerëson se do të duhet të kishte më shumë konsideratë për artistët, sepse në të kundërtën, do të kthehet si bumerang.

"Kultura kushton, por jokultura kushton shumë më shtrenjtë", përfundon Melihate Qena.

with the ensemble, who protested why we should perform for an audience of only five watchers. I attempted to tell them that they were paving the way with their own energy and work. Some of them stayed, but the majority left for good as you can't force them", Meli explains.

Her relation with the children, whom she considers a sincere audience and a priceless source of lessons and inspiration, illustrates one of the noble goals of art: to enlighten, educate, and make life more colorful.

"There is no greater pleasure for myself than making children happy with a show. I always stand close to them to see their reactions, I ask them, I learn from them. I always stay in the hall, and my actors ask if I get tired of always coming to watch the plays. My answer is that I do not come for the shows, I just see them to see the children, and there are always plenty of things you see in them".

"I believe my end will be in the theatre"

Her love towards this theatre is not feigned. Even in retirement, she continues to work for the children.

"I believe my end will be in the theatre", Meli says, asserting that it would be a fitting destiny for her. Meli demands that every city should have a Dolls' Theatre and that actors should be appreciated, arguing that their role is more important than ever, especially in times when life and culture are heavily influenced by both technology and rapid changes.

"I do not intend to wrestle with technology, but theatre has its own advantages. In theater, there are live actors. For example, I never use microphones as I want kids to hear the breath of the actor, to see someone sweating and working for them. This cannot be compensated with anything".

Finally, Meli speaks about the artist's role and reasonability in modern society, concluding regretfully that artists have no say in anything.

"Only politics is important. It seems like politicians are more artists than the artists themselves. As they have assumed our roles, mustering a larger audience, I do not know what is left for the artist! Elsewhere, the artist is appreciated and respected, while here, the artist is left at no one's mercy, some sort of burden for everyone", Meli says, contending that there should be more consideration for artists. "Culture is expensive, but the absence of culture is far more expensive", Meli concludes.

T'knoft' zemra në RLIOF për vlerat e trashëguara

Tash e katër vite me radhë, fundkorriku është festë në kryeqytet. Në sheshin Skënderbeu ngrihet skena madhështore ku reflektohen ngjyrat e larmishme të artit operistik.

"May your heart sing" for Inherited Values

For four years now, the end of July has been a festive week in Prishtina. A majestic scene raises in Skënderbeu Square, mirroring a vista of diverse colors of operatic art.

ELVIRA BERISHA



Kjo periudhë e verës tashmë është mishëruar me Festivalin Ndërkombëtar të Operas – Rame Lahaj. Festivali i vetëm operistik në vend e rajon është një ndër ngjarjet kryesore të kalendarit kulturor të kryeqytetit. Përjashtim nuk bën as ky vit, kur Rame Lahaj International Opera Festival (RLIOF) po organizon edicionin e katërt.

Edhe ky edicion i sjell Prishtinës ngjyrat magjike të artit operistik nëpërmjet zërave që do të jehojnë gjithandej nëpër hapësira të ndryshme arti, si; Amfiteatri i Bibliotekës Universitare, objekti i Filarmonisë së Kosovës etj. Edicioni i katërt i RLIOF do të shtrihet mes datave 21 korrik e 2 gusht. Pesë mbrëmje muzikore, një ekspozitë e veçantë e masterklasë frymëzuese për artistët e rinj, janë pjesë e pakos artistike të këtij edicioni. Emra të mirënjohur të botës operistike kanë shënuar datat në kalendar për t'u ndalur në kryeqytetin e shtetit më të ri në Evropë. Talenti i tyre do të gërshetohet në skenë, në mbrëmjet magjike muzikore të RLIOF që fillojnë me mbrëmjen e Nexhmije Pagarushës – mbrëmje kjo e shndërruar në traditë ku nderohet trashëgimia muzikore shqiptare dhe këngët më të njohura shqipe dëgjohen në formën e artit operistik duke i sjellë

The summer period finds its embodiment in the Ramë Lahaj International Opera Festival (RLIOF). This operatic event, being the only one in the country and abroad, is among the main events on Prishtina's cultural calendar. This year is no different as RLIOF is about to hold its fourth edition.

This year's edition brings to Prishtina the magical hues of operatic art, carried by talented voices that will resonate all over artistic spaces like the Library Amphitheater and Kosova's Philharmonic building. Scheduled between July 21 and August 2, the artistic package of the fourth edition of RLIOF unfolds with five musical evenings, a special exhibition, and an inspiring master class for young artists. Renowned names from the operatic world have already marked the dates in their schedules to make a stop in the capital of Europe's youngest country. Their talent will be displayed in the stage during magical evenings of RLIOF, commencing with Nexhmije Pagarusha's evening – an event that has turned into a tradition, honoring Albanian musical heritage with operatic renditions of the most standout Albanian songs, bringing them closer to the world's musicians. This year's edition has also



afër muzikantëve botërorë. Opera Night, Ensemble Evening e New Generation, po ashtu, janë pjesë e edicionit të katërt. E sikurse tradicionalisht, kryeqyteti edhe sivjet është nikoqir i natës gala Rame Lahaj & Friends, që sjell në skenën madhështore në zemër të qytetit tenorin Rame Lahaj dhe miqtë me të cilët ai ndan skenat prestigjioze botërore. Magjia qëndron në faktin që miqtë e tenorit nga Kosova me nam botëror, ndalen në Prishtinë, përjetojnë mikpritjen e kryeqytetit, shkëmbejnë përvoja me muzikantët e rinj, njihen nga afër me potencialin artistik profesional të orkestrës së Filarmonisë së Kosovës dhe marrin me vete përshtypjet më të mira.

Komuna e Prishtinës si nikoqire e RLIOF i ka dhënë mbështetje të madhe festivalit ndër vite. Në të njëjtën kohë, edhe festivali i ka dhënë shumë Prishtinës.

“Është ndjesi shumë e veçantë kur ngjitem në skenë në sheshin Skënderbeu dhe këndoj para miqve të mi, publikut dhe mbështetësve

që po kontribuojnë që ëndrra ime të vazhdojë të jetojë. Besoj që festivali ynë ka dhënë kontribut të madh për të vendosur Prishtinën në hartën botërore operistike. Kjo fillimisht duke u bërë një ndër festivalet e vetme të operës në rajon dhe e dyta duke u bërë urë lidhëse mes yjeve operistike dhe publikut kosovar e talentëve të rinj muzikantë. Jemi mirënjohës që kemi gjetur përkrahje që të vazhdojmë dhe ta përsosim çdo vit e më shumë këtë festë të artit operistik në kryeqytet”, thotë tenori Rame Lahaj.

Edicioni i katërt i festivalit është konceptuar rreth motos T`knoft` zemra dhe do të bashkojë zëra nga e gjithë bota për ta nderuar trashëgiminë muzikore të bartur ndër breza.

Frymëzuar nga kujtimet e tenorit Rame Lahaj, i rritur me këngët e njohura të muzikës shqipe, të cilat i këndonte nën urimin e nënës T`knoft` zemra, këtë vit RLIOF bën ndërlidhjen e trashëgimisë muzikore dhe rrëfimeve personale të artistëve me gjuhën universale të operës.

the Opera Night, Ensemble Evening and New Generation events. In line with established tradition, Prishtina hosts the gala night Ramë Lahaj & Friends, which brings to the striking scene in the heart of Prishtina, tenor Ramë Lahaj and his friends from the world's most prestigious stages. What makes the whole event truly magical is that tenor's friends make a stop in Prishtina to experience the capital's hospitality, exchange experiences with young musicians, and getting to know the artistic and professional potential of Philharmonic's orchestra, thus creating most memorable moments. The Municipality of Prishtina, as the host of RLIOF, has given unrelenting support to the festival over the years. By the same token, even this festival has greatly enriched Prishtina.

“It's a very special feeling when I enter the stage in Skënderbeu Square and perform in front of my friends, audience, and all the supporters who are contributing to keep my dream alive. I believe that our festival has done a lot to place Prishtina on the operatic world's map. First, it has



“ Festivali shfrytëzon fuqinë e zërave operistikë si jehonë për vlerat e familjes, dashurinë për artin e mirëfilltë muzikor dhe rolin e figurës së nënës në formësimin e identitetit artistik.

Nëpërmjet performancave që burojnë nga thellësia e zemrës, kujtimeve dhe eksperiencave diverse, do t'i rijetojmë në formën e artit operistik, këngët e nënës që vazhdojnë të rezonojnë në

zemrat tona duke u dhënë formë personaliteteve artistike dhe duke shërbyer si inspirim i pashtershëm për shpirtin tonë.

Me moton T'knofit zemra, RLIOF synon të frymëzojë dashurinë për të kaluarën, ta pasurojë të tashmen dhe t'i inspirojë gjeneratat e reja të këndojnë me zemër e të marrin rrugë drejt skenave prestigjioze të operës.

become one of the few operatic festivals in the region, and secondly, by serving as bridge connecting operatic stars with the Albanian public and young musical talents. We are grateful for the support we have received to continue and perfect this operatic feast in Prishtina each year”, says tenor Lahaj.

The fourth edition of the festival is conceived around the motto T'knofit zemra (Albanian for “May Your Heart Sing”) and is about to bring together voices from around the world to pay homage to the musical legacy passed down through generations.

Drawing inspiration from the memories of tenor Lahaj, who grew up with well-known songs of Albanian music, which he sang with her mother blessing T'knofit zemra (May Your Heart Sing), this year RLIOF intertwines musical heritage and personal stories of artists with the universal language of opera.

The Festival makes use of the power of operatic voices to reverberate family values, love for true musical

art, and the role of mothers in sculpting artistic identity.

Through deeply felt performances, memories, and diverse experiences, the festival artistically revives the songs of mothers in an operatic format, songs that still have a hold in our hearts, shaping many artistic personalities and serving as an



inexhaustible inspiration for our spirits.

With its motto T'knofit zemra, RLIOF aims to inspire love for the past, enrich the present, and motivate new generations to sing full of emotion and undertake their journeys towards prestigious opera stages.

BEHIE MURTEZI-SAQIPI

Prishtina ka publik me shije të hollë për balet

Është rritur në dërrasa të teatrit. I takon gjeneratës së parë të balerinëve të pasluftës në Kosovë, atëherë kur jeta kulturore në vend po rimerrte veten. Behie Murtezi-Saqipi, një vajzë nga Skenderaj, ka lënë prapa 2 dekada eksperiencë në vallëzim. Sukseset janë të shumta e lodhja nuk ndihet. Ajo i kujton me nostalgji edhe momentet e para të baletit, të cilin e ringriti tashmë i ndjeri Ahmet Brahimaj.

AGRON KRASNIQI



Por diçka që nuk e kishte sa ishte vetë fëmijë vendosi që t'ua ofrojë të tjerëve. Duke ditur se sa me rëndësi është që baleti të nisë qysh në moshë të hershme, Behia hapi shkollë baleti. Qindra vajza e djem të moshave të ndryshme kanë kaluar për 15 vjet në shkollën Behias Dance. E ajo thotë se “të punosh me fëmijët është një kënaqësi e madhe”. “Energjia e tyre e mirë patjetër që ndikon edhe tek unë”, deklaroi Behia.

“

Fully conscious of the importance of starting as early as possible, she opened a ballet school. For over 15 years, hundreds of girls and boys of different ages have trained at Behia's Dance School. “Working with children is a great pleasure”, she says. “Their energy certainly impacts me”.

Prishtina's Public Has a Fine Taste for Ballet

Growing up on the theatre floorboards, Behie Murtezi-Saqipi was part of the first generation of ballerinas to emerge after the war, a time when cultural life commenced to show its first signs of revival.

Born in Skenderaj, Behie had two decades of experience in dance. Her success are numerous, and she appears tireless. She nostalgically recounts her early days in ballet, assigning its revival mainly to the late Ahmet Brahimaj. Because she missed this experience in her own childhood, Behie decided to offer this opportunity to others.

Me baletin që në rifillimet e pasluftës

Behia i takon gjeneratës së parë të balerinëve të pasluftës në Kosovë. Në vitin 2001 ajo së bashku me solistë të tjerë nisën mësimet për balet në shkollën e muzikës Prenk Jakova në Prishtinë. Që kur diplomoi, në vitin 2005, ajo është soliste e Trupës së Baletit Kombëtar të Kosovës. Teksa i kujton fillimet në balet, thotë se ishte e vështirë dhe jo pak e lodhshme.

“Duhej një punë e madhe për të ecur përpara. Ne nuk kishim shumë njohuri rreth baletit, sepse ishim një gjeneratë e sapodalë nga lufta, por e di që atë kohë ne kemi ditur vetëm të punojmë fort dhe të ëndërrojmë për sukseset që do t'i kemi në të ardhmen”, thotë ajo.

Behia i kujton me nostalgji shfaqjet e para me Trupën e Baletit, fillimisht Tranzicion2, pastaj shfaqjen S'po dëgjohet gongu, nga koreografi shqiptar Gjergj Prevazi.

“Aty ne kemi pasur mundësi edhe të njihemi me vallëzimin kontemporan dhe të realizojmë shfaqje shumë të dashura për publikun”, kujton ajo.

Për 21 vjet sa është pjesë e Baletit Kombëtar të Kosovës, Behia është krenare me punën dhe sukseset e këtij institucioni ndër vite. E momente të veçanta krenarie ajo thotë se ka shumë. Por e veçon një:

“Ka qenë shfaqja Sherazad nga koreografja italiane Alessandra Panzavolta dhe premiera e kësaj shfaqjeje

The Post-War Period

Behie belongs to the first generations of ballerinas in Kosova. In 2001, she and other soloists started studying ballet at the 'Prenk Jakova' School of Music. Since her graduation in 2005, she has been a soloist with the National Ballet of Kosova. Evoking her early days, she concurs that it was difficult and exhausting.

“A large amount of work was required for us so we could move forward. We had little knowledge of ballet, being a generation that endured the war, but I know we were committed to working hard and dreaming of success”, she says.

Behie is particularly fond of early performances with the Ballet troupe, such as 'Tranzicion2' and then 'S'po dëgjohet gongu' (Albanian for "The Gong Is Not Heard"), choreographed by Gjergj Prevazi.

“These performances allowed us to get acquainted with contemporary dance and bring forth shows that were well-received by the public”, she recalls.

In her 21 years' experience with the National Ballet of Kosova, Behie is proud with the institution's achievements. She recounts many numerous moments of pride, yet she

është dhënë në Napoli të Italisë. Unë kam pasur rolin kryesor dhe krejt ajo përvojë në Napoli për mua ka qenë shumë e rëndësishme që ta përjetoj një trajtim dinjitoz, ashtu siç e meriton një balerine profesioniste”, thotë ajo.

15 vjet me Behias Dance

Në vitin 2009, Behia bashkë me bashkëshortin e saj, po ashtu balerin, Driton Saqipin, vendosën që të hapnin një shkollë baleti për fëmijët. Behias Dance aktualisht numëron rreth 130 nxënës, që ndjekin mësimet e baletit klasik dhe atij modern te kjo dyshe.

“Patëm vendosur që të krijojmë një hapësirë për të gjithë ata fëmijë që e duan baletin, ku do të kenë mundësi që të njihen me artin dhe vallëzimin. Duke e ndier mungesën te vetja, që nuk kisha nisur në moshë të vogël të luaja balet, meqë nuk kanë ekzistuar kushtet dhe mundësitë, kam dashur që të hap dyert për fëmijët që t'i realizojnë ëndrrat e tyre”, thotë mësuese Behia.

Edhe pse janë bërë 15 vjet që Behia mëson vajzat dhe djemtë e moshave të ndryshme që luajnë balet, ajo nuk ndien fare lodhje.

“E dua shumë punën me fëmijët dhe kjo më ka ndihmuar që unë nga fillimi e deri sot të kaloj shumë mirë dhe ta shijoj shumë pjesën kur ushtroj bashkë me ta”, thotë Behia.

Behia thotë se sukseset e shkollës po rriten secilën herë.

shares one of them. “It was the show 'Scheherazade' by Italian choreographer Alessandra Panzavolta with its premier taking place in Naples. I performed the lead role and that experience in Naples was very important to me. I was treated with the dignity a professional ballerina deserves”, she says.

15 Years of Behie's School Dance

In 2009, Behia and her husband Driton Saqipi, who is also a ballet performer, decided to open a ballet school for children. Currently, Behie's Dance has about 130 students learning classical and modern ballet.

“We wanted to provide a space for children who who were fond of ballet, giving them the chance to experience both art and dance. Considering that I missed this opportunity in my own childhood due to a lack of conditions, I wanted to open doors for these children to fulfill their dreams”, Behie explains.



“Suksesi ynë më i madh ka qenë në vitin 2023 ku e kemi realizuar shfaqjen La Sylphide dhe fëmijët kanë arritur që ta interpretojnë veprën, ashtu siç është edhe origjinali. Interesimi i publikut për ta parë këtë shfaqje ka qenë i jashtëzakonshëm, dhe kjo më ka lumturuar shumë”, thotë ajo.

Në fund, si pjesë e gjeneratës së parë, Behia ia njeh Baletit në Kosovë uljet dhe ngritjet. Thotë se momentalisht baleti po kalon një situatë jo të lehtë, meqë ende nuk ka një shtëpi të vet.

“Ende nuk e kemi një teatër ku ne do të performonim. Është shumë problem që ne të vazhdojmë me këtë situatë, por uroj shumë që kjo të ndryshojë shumë shpejt dhe të merren masa nga njerëz kompetentë në mënyrë që kushtet të përmirësohen”, thotë ajo.

Përkundër kësaj, Behia thotë se “Prishtina e ka një audiencë të mrekullueshme, me shumë shije të hollë”.

“Kujtoj që pas shfaqjeve kam marrë edhe lëvdata dhe kritika shumë të rëndësishme nga publiku. Andaj, ky publik i mrekullueshëm meriton një teatër dinjitoz”, përfundon ajo.

Despite her 15 years spent in active teaching of girls and boys, she remains tireless.

“I love working with children, and this helps me enjoy every rehearsal with them”, she says.

According to Behie, the school’s successes have grown over time. “Our main success was in 2023 when we performed ‘La Sylphide’. The children succeeded in interpreting the work as it is in the original. There was a good interest great public interest, which made me very happy”, she says.

As part of the first generation, Behie knows well the ups and downs of the National Ballet of Kosova. She notes that ballet is experiencing a difficult situation due to the lack of a proper building.

“We still lack a modern building for rehearsals. It is very difficult to continue this way, but I remain hopeful that things will soon change and necessary measures will be taken in order to improve the situation”, she says.

However, Behie states that “Prishtina has an admirable audience with a fine artistic taste”.

“I recall receiving a lot of praises and important critiques from the public. This is why the public deserves a proper theater building”, she concludes.

PROFIL: ERËMIRA ÇITAKU

Artistja që bashkon muzikën me poezinë dhe imazhin

An Artist Merging Music with Poetry and Image

"Ngjyrat e muzikës le të na përqafojnë me lumturinë e dashurisë", ky varg është në hyrje të uebfaqes së artistes dhe flautistes Erëmira Çitaku. Duket se në të njëjtën kohë ky varg edhe e përfaqëson karrierën mjaft vibrante të saj. Duke qenë ndër doktorët e parë në instrument në Kosovë, karrierën e saj nuk e kishte shtrirë vetëm në rrafshin akademik, pra në kuptimin e performancës klasike, por e kishte mbushur këtë aspekt edhe me një karakter më rebel që e gjejmë në khaz. Kjo liri e khaz-it që e gjejmë të përbrendësuar në frymën e artistike të Erëmirës e ka bërë atë që të kombinojë një triptik mjaft interesant: gjuhën nëpërmjet poezisë, imazhin nëpërmjet videos dhe muzikës. Veprat artistike të Erëmirës e kanë të inhibuar këtë triptik dhe kjo në të njëjtën kohë është shenjuesi autentik që e dallon artin e saj.

Një shprehje e veçantë e estetikës të flautistes dhe artistes Erëmira Çitaku janë veprat e saj që e ngërthejnë triptikun e lartcekur. Vepra Shoshë, që është një Maldoror muzikor avantgardist në të njëjtën kohë është një shprehje që si shtrirje muzikore, poetike dhe imazherike, por edhe për nga pjesëmarrja e instrumentistëve të ndryshëm në projekt e ka bërë një çarje në status-quo-në e deriatëhershme në skenën e



"Let the colors of music embrace us with love happiness", reads a line at the beginning of Erëmira Çitaku's website. It seems that this line perfectly represents the vibrant career of this artist and flautist. As one of the first graduates specializing in the flute, she has extended her career far beyond academic domain, instilling in her performances a rebellious touch that often is reminiscent of jazz. This freedom that is so ingrained in her artistic spirit has led Erëmira to create an interesting triptych of language through poetry, image through video, and music. Erëmira's artistic works are defined by this

Flautisja dhe Prishtina, që mirëmbajnë simbiozën kreative të njëra-tjetrës

Flautist and Prishtina in a Sustained Creative Symbiosis

innovative mixture, an authentic feature making her art awesomely unique.

An exceptional example is her work "Shoshë" (Albanian word for 'sieve'), an avant-garde musical piece reminiscent of 'Maldoror'. This multi-layered, variegated project, featuring poetic and imagery accretions as well as various instrumentalists, was a turning-point in shattering the status quo of contemporary art. Beside its avant-gardist tropes, it conveys a mélange of jazz, alternative music, American minimalism, and subtle poetry pieces reminiscent of Ingeborg Bachmann with the cold undertones of Prishtina's brutalism. Thus, "Shoshë" is one of the contemporary art projects that intertwines a sundry of mediums to voice inner concerns and anxieties affected by external factors. Among Erëmira's projects is included a collaboration with her husband, philosopher Labinot Kelmendi. Together, they coauthored projects such as "Hyper Love" (inspired by Jean Baudrillard) and "House of Being". In the latter, she inverts Martin Heidegger's maxim "language is the house of being" to "music is the house of being". She has also recorded her album "Trekëndëshi"



artit bashkëkohor. Fryma e estetikës së Çitakut në këtë vepër me tropet avantgardiste të saj janë një kombinim monstroz mes xhaz-it, muzikës alternative, minimalizmit amerikan dhe poezisë alla Ingeborg Bachmann-it me tone të ftohtësisë të arkitekturës brutaliste të Prishtinës. Shoshë mund të themi se është njëri ndër projektet në artin bashkëkohor të pasluftës që nëpërmjet ndërthurjes së medimeve të ndryshme e shpreh brengën e brendshme por në të njëjtën kohë e shenjon ankthin e përjetuar nga faktorët e jashtëm. Projektet e tjera të artistes Çitaku janë të shumta është një cikël i bashkëpunimit me bashkëshortin, filozofin Labinot Kelmendi, ku ajo në bashkëbisedim me të i bën projektet si Hyper Love - e inspiruar nga filozofi Jean Baudrillard-i por edhe House of Being, ku ajo e invertton sintagmën e filozofit Martin Heidegger që gjuha është shtëpia e qenies në atë se muzika është shtëpia e qenies. Ajo, gjithashtu, ka të incizuar në studio albumin e saj Trekëndëshi, që është një kombinim mes muzikës elektronike të viteve '90, në kombinim me melosin tonë dhe ekstrakte të muzikës klasike. Pika neuralgjike e artit të Erëmirës janë vijëzime feministe që shërbejnë si shprehje për të dekonstruktuar resentimane çfarëdo qofshin ato.

Për fund, Erëmira Çitaku mbetet njëra ndër artistet novatore të Prishtinës. Tingujt e muzikës së saj

janë pjesë integrale e aurealit artistik të Prishtinës. Erëmira dhe Prishtina janë në shkëmbim me njëra-tjetrën, se e mirëmbajnë simbiozën kreative të njëra-tjetrës. Si sugjerim që nganjëherë e implikon një imponim, dëgjojeni muzikën e Erëmirës ngase aty është i sendimentuar përjetimi aureal i Prishtinës si pjesë integrale e kozmosit.

Biografi e shkurtër

Të ndalemi te disa momente biografike. Erëmira Çitaku e ka të përfunduar Fakultetin e Muzikës, drejtimi flaut pranë Universitetit të Prishtinës, e studimet e mëtejme fillimisht i kishte vazhduar në Francë për të doktoruar në Bullgari. Ajo ka qenë përfutuese e bursës së plotë Ecole Normale de Musique de Paris Alfred Cortot në Francë, gjithashtu bursës për hulumtim në muzikë Conservatoire de Musique de Genève në Zvicër. Është shpërblyer me vendin e tretë në garën ndërkombëtare për flaut, Concours de flûte Roger Bourdin, në Paris, ndërsa edhe çmimin special për interpretimin e muzikës franceze në garën ndërkombëtare për flaut Music and World, në Sofje. Në New York ka qenë pjesëmarrëse në rezidencën për muzikën e re. Si soliste, por edhe si pjesë e formacioneve të ndryshme muzikore ka qenë pjesëmarrëse në shumë koncerte, festivale ndërkombëtare dhe vendore, njëherësh e organizon që dhjetë edicione festivalin ndërkombëtar për flaut Flute Sounds/Tingujt e Flautit.

(Albanian for 'triangle') which displays a blend of 1990s electronic music with Albanian folk and Classical pieces as well. The most sensitive parts of Erëmira's art are its feminist ingredients that provide means to deconstruct resentments. Finally, Erëmira Çitaku stands as one of Prishtina's most innovative artists, with her music sounds being an intrinsic part of Prishtina's artistic aural. Hence, Erëmira and Prishtina share a constant exchange, sustaining a creative symbiosis. While avoiding any imposition, a good suggestion would be to listen Erëmira's music, as it conveys an aural experience of Prishtina as an integral part of cosmos.

A Short Biography

Let us dissect some biographic episodes. Erëmira Çitaku holds a degree in flute from the Faculty of Music at the University of Prishtina. She pursued postgraduate studies in France and earned her PhD in Bulgaria. Çitaku received a full scholarship to the 'École Normale de Musique de Paris Alfred Cortot' in France and another for music research at the 'Conservatoire de Musique de Genève' in Switzerland. She won third place in the international flute competition 'Concours de flûte Roger Bourdin' in Paris, while she also received a special prize for interpreting French music at the international flute competition 'Music and World' in Sofia.

Erëmira has participated in a residency for new music in New York. As a soloist of various musical formations, she participated in many concerts and festivals, both international and local. She has also organized ten editions of the international flute festival 'Flute Sounds'.

Ambasadorët kulturorë

Tashmë është dëshmuar potenciali i madh kulturor që Kosova e ka, me një numër të jashtëzakonshëm artistësh që veprojnë brenda e jashtë vendit. Ata përdorin artin e tyre për të promovuar vlerat e Kosovës. Në vazhdim, ndiqeni një shëtitje nëpër disa nga arritjet më të rëndësishme që i patën artistët kosovarë në skenën ndërkombëtare. E kush më mirë se arti mund të prezantojë gjithë thesarin kulturor të një vendi.



FOTO: FCB/BALETI KOMBËTAR I KOSOVËS

Baleti Kombëtar i Kosovës me katër prezantime jashtë vendit

• Baleti Kombëtar i Kosovës ka dhënë shfaqjen Tango Nights në New York. E pati premierën më 31 maj në teatrin Theater at St. Jean. Koreografja amerikane Chiara Ajkun punoi me trupën për këtë performancë, që dha reprizën më 1 dhe 2 qershor. Nga New Yorku trupa u ndal në Paris, ku në teatrin Du Gymnase Marie Bell interpretoi shfaqjen Time, të koreografit Taulant Shehu. U bë kjo në kuadër të festimeve të 25-vjetorit të çlirimit. Pas suksesit në New York e Paris, trupa do të performojë në Lisbonë, Portugali më 27 korrik në teatrin Cine Teatro D. João V. in Amadora. Në shtator, Baleti Kombëtar i Kosovës do të marrë pjesë në Cheonan World Dance Festival në Korenë e Jugut, duke vazhduar traditën e prezantimeve ndërkombëtare.

Cultural Ambassadors

Kosova has already proven itself with its vast cultural potential through numerous outstanding artists who perform both domestically and internationally. Through their art, these artists promote Kosova's values. Below is an overview of the most notable achievements of Albanian artists from Kosova on the international stage. Who better to represent cultural treasures of a country than its art?

The National Ballet of Kosova with Four International Shows

• The National Ballet of Kosova has staged its performance Tango Nights in New York, being premiered on May 31 at the Theater at St. Jean. American choreographer Chiara Ajkun worked with the troupe for this performance, which had additional shows on June 1 and 2. Following their New York debut, the ballet performers had their next stop at Paris, where they presented Time by choreographer Taulant Shehu at the Theatre Du Gymnase. This was given as part of the celebrations for the 25 anniversary of Kosova's liberation. After successful performances in New York and Paris, the troupe is set to perform in Lisbon, Portugal, on July 27 at the Cine Teatro D. João V in Amadora. In September, The National Ballet of Kosova will partake in the Cheonan World Dance Festival in South Korea, continuing its tradition of international performances.



FOTO: ARMEND NIMANI

Dita natë, nata vjet - rebelimi artistik që mori vëmendje ndërkombëtare

• Haveit, në janar hapi ekspozitën personale Dita natë, nata vjet, e që erdhi si përshkrim i kujtimeve personale. Aty artistikisht u shpalosen ëndrrat, frikërat dhe paragjykimet. Ekspozita në Galerinë Kombëtare të Kosovës që shfrytëzon artin për t'u rebeluar mori edhe vëmendjen e mediave ndërkombëtar. Bujë bëri veçanërisht në mediumin britanik The Guardian me fotografitë e realizuara nga Armend Nimani.

Day into Night, Night into Year – The Artistic Rebellion that Received International Attention

In January, Haveit opened a personal exhibition Day into Night, Night into Year (in Albanian “Dita natë, nata vjet”), featuring a depiction of personal memories. It unraveled dreams, fears, and prejudices. Held at the National Gallery of Kosovo, this art exhibition, that makes use of art as a form of rebellion, amassed international media attention. It particularly attracted attention from The Guardian, showing photographs by Armend Nimani.

Arti i Artan Hajrullahut shpaloset në Japoni

• Artisti nga Gjilani prezantoi veprat e tij në trienalen Yokohama në Japoni. Kjo ishte paraqitja e tij e parë jashtë kontinentit. Në Muzeun e Artit të Yokohamas shkoi në qershor me A House Without Walls, si kombinim i elementeve tradicionale dhe moderne.

Lost for Words nga Driton Selmani shfaqet në Belgjikë

• Vepra e artistit kosovar është pjesë e mozaikut në trienalen për art bashkëkohor Beaufort. Skulptura reflekton mbi hapësirën publike dhe është pjesë e 18 veprave të reja të realizuara për edicionin e tetë që mbahet prej 27 mars deri më 3 nëntor.

Dialog në errësirë ekspozohet në Gjermani

• Driton Hajredini, artisti me prejardhje nga Kosova, me trologjinë e tij Dialog në errësirë – që përfshin veprat Mëkati 1, Mëkati 2 dhe Absolucion - ekspozoi në Wuppertal, Gjermani, një ekspozitë që sjell rrëfimet e refugjatëve dhe azilantëve, përfshirë dhe atë të vetë artistit. Pikturat e tij bartin histori të bashkëkombësve të tij dhe pasqyrojnë përjetimet e tij gjatë viteve '90 dhe pasojat e luftës në Kosovë. Pavarësisht çlirimit të Kosovës më 1999, Hajredini përjetoi zhgënjim të ri për shkak të izolimit dhe diskriminimit ndaj kosovarëve në Evropë, temë kjo, po ashtu, e theksuar në veprat e tij.

Ekspozita Eksperience e Shuk Oranit në Hamburg

• Artisti kosovar Shuk Orani hapi ekspozitën e tij Eksperience në Hamburg më 15 mars. Aty u prezantuan vepra nga disa cikle të krijimtarisë së tij ndër vite. Aty u ekspozuan tridhjetë piktura me ngjyra vaji në pëlthurë, duke ofruar një zhytje të plotë në botën e tij artistike. Orani ka ekspozuar më parë në vende të ndryshme, përfshirë Louvre dhe Pekin. Në qytetin e Hamburgut, ku edhe jeton, ka ekspozuar disa herë.

Dyshja nga Kosova me vepra në Holandë

• Ekspozita Heem në Fries Museum në Leeuwarden të Holandës, u hap më 28 prill dhe përfshin punimet e artistëve nga Kosova, Erzen Shkololli dhe Petrit Halilaj. Shkololli prezanton veprën e tij Pejë, Kosovo, 1998, e krijuar gjatë luftës në Kosovë, ndërsa Halilaj sjell një



FOTO: MKRS

instalacion që përfshin artefakte nga Runiku. Ekspozita do të zgjasë deri më 27 prill 2025 dhe trajton ndjenjën e shtëpisë dhe largimin nga ajo.

Kosova me Mirënjohje të Veçantë në Bienalen e Venecias

• Pavijoni i Kosovës mori një mirënjohje të veçantë në Bienalen Ndërkombëtare të Artit në Venecie për instalacionin Heshtjet kumbuese të metalit dhe të lëkurës të artistes Doruntina Kastrati me kuratore Erëmira Krasniqin. Kjo vepër adreson çështjen e punës së feminizuar brenda kontekstit të ekonomive të parregulluara. "I referohet industrisë së punës së feminizuar dhe trupave të tyre të dërrmuar nga puna... skulpturat elegante të Kastratit ftojnë vizitorët të bashkëveprojnë, një peizazh tingullor shkon përmes dyshemesë duke rezonuar në eshtrat tona duke bërë jehonë në fushën aktivizmit feminist", ka qenë arsyeimi i jurisë, lexuar prej anëtares Maria Ines Rodriguez.



Artan Hajrullahu's Art Exhibited in Japan

- Born in Gjilan, the talented artist showcased his work at the Yokohama Triennale in Japan. This was his first exhibition outside Europe. In June, he presented his piece A House Without Walls at the Yokohama Museum of Art, which intertwines traditional and modern elements.

Driton Selmani's Work Lost for Words Exhibited in Belgium

- The work of Kosovan artist is part of the mosaic in the Beaufort Triennial for contemporary art in Belgium. His sculpture, reflecting on public space, is one of the 18 new works featured in the third edition, which started on March 27 and ends on November 3.

A Dialogue in Darkness Exhibited on Germany

- Kosova-born artist, Driton Hajredini exhibited his trilogy

Dialogue in Darkness – which includes the works Mëkati 1, Mëkati 2, and Absolucioni – in Wuppertal, Germany. These pieces bring to light the stories of refugee and asylum seekers, including his own. His artwork carry the experiences of his compatriots and his personal story from the 1990s and the consequences of the war in Kosova. Despite Kosova's liberation in 1999, Hajredini was disappointed with the isolation and discrimination of Kosovars in Europe, a theme that is accentuated in his works.

The Exhibition Experience of Shuk Orani in Hamburg

- On March 15, Kosovan artist Shuk Orani opened his exhibition Experience in Hamburg. It showcased works from different cycles of his oeuvre, containing 30 oil paintings on canvas. It offered a full immersion into his artistic world. Orani has exhibited in various countries, including the Louvre and Beijing. In Hamburg, his current residence, he has held previous exhibitions.

The Duo from Kosova Exhibits in Holland

- The exhibition Heem at the Fries Museum in Leeuwarden, Holland, opened on April 28, conveying works by two Kosovan artists, Erzen Shkololli and Petrit Halilaj. Shkololli exhibits his work Pejë, Kosovo, 1998, created during the war in Kosova, while Halilaj brings an installation that includes artifacts from Runik. The exhibition, reflecting on the themes of home and departure, will run until April 27, 2025.

Kosova Receive Special Mention at the Venice Biennale

- Kosova's Pavilion received special recognition at the International Art Biennale in Venice for the installation The Echoing Silences of Metal and Skin by artist Doruntina Kastrati and curator Erëmira Krasniqi. The work delves on the issue of feminized labor within the context of deregulated economies. "Small yet potent, Doruntina Kastrati's installation refers to feminized industrial labor and the wearing down of working women's bodies... Kastrati's elegant sculptures invite viewers to interact with them. A vibrating soundscape travels up through the floor, resonating both in our bones and echoing a larger arena of feminist activism", was the jury's motivation read by María Inés Rodríguez.

Petrit Halilaj me Abetare në New Yorku

• Petrit Halilaj realizoi ëndrrën e tij duke ekspozuar në Muzeun Metropolitan të Artit në New York me veprën Abetare. Kjo vepër, e cila përmban instalacione skulpturore të bazuara në vizatime të nxënësve të shkollës së fshatit të tij të rrënuar, përfaqëson historitë dhe përjetimet e fëmijëve të Kosovës. Për Halilajn, këto vizatime janë simbol i imagjinatës dhe jetës së fëmijëve, të cilët kanë kaluar kohë të vështira, duke e bërë veprën një dedikim emocionues për të gjithë fëmijët e botës. Arritja e tij në skenën ndërkombëtare është testament për ndikimin dhe rëndësinë e artit të tij. Ekspozita është e hapur deri më 27 tetor.


Artisti kosovar këtë vit ishte në krye të ballinave dedikuar artit edhe për pulën e tij të vizatuar në aeroplan që përshkoi mijëra kilometra në qiell. Bashkë me pulën fluturuese pason edhe mesazhi: Nga Runiku me dashni!. Pikturuar në një Boing 737 të AeroMéxico, kompanisë meksikane të fluturimeve, arti i Petrit Halilaj erdhi si ftesë për të reflektuar mbi lirinë dhe të ardhmen pa barriera. Pula e Petritit ishte pjesë e ekspozitës Runik, e para e artistit në Amerikën latine. Ekspozita e hapur më 23 nëntor të vitit të kaluar, në muzeun e artit bashkëkohor Tamayo në Mexico City, ishte e qasshme për vizitorët deri më 7 prill.



Petrit Halilaj with Abetare in New York

• Petrit Halilaj fulfilled his dream by exposing his work Abetare at the Metropolitan Museum of Art in New York. This piece, consisting of sculpture installations based on drawings from school pupils in his ruined village, conveys the stories and experiences of Kosova's children. For Halilaj, these drawings are symbol of the imagination and life of Kosova's children who endured tough times, making his work an emotional dedication to children worldwide. His achievement on the international stage serve as a testament to the influence and importance of his art. The exhibition is open until October 27.

This year, the Kosovan artist has made headlines in the art world for his chicken drawing on an airplane, which traversed thousands of kilometers. Alongside the flying chicken was the message: "From Runik with Love!" Painted on a Boing 737 of Aeroméxico, Halilaj's art invented reflection on freedom and a future without barriers. This was part of his exhibition Runik, his first in Latin America, which opened on November 23 of last year at the Contemporary Art Museum Tamayo in Mexico City and was available for visitors until April 7.



Në një instalacion që ngacmon këndvështrimin fshehurazi, aty gjen karikatura të papërpunuara erotike dhe një logo të NATO-s, citate këngësh pop dhe akronime ushtarake; një imazh i pëllumbit të paqes (i pozicionuar në një rën nga këmbët e merimangës) dhe një punim që i ngjan Batmanit (Foto: Hiroko Masuike/The New York Times)

FOTO: FCB/JAKUP FERRI



Tapiceritë e Jakup Ferrit krijojnë përditshmërinë edhe në Angli

• Në edicionin e tretë të Harewood Biennial në Leeds, Angli, Jakup Ferri do të prezantojë universin e tij të përditshmërisë përmes tapicerive të qëndisura. Ferri aty prezantohet me rreth 70 vepra, përfshirë edhe ato të paraqitura në Bienalen e Venecias. Ngjarja zhvillohet prej 28 qershorit deri më 20 tetor në temën Create/Elevate.

Jakup Ferri's Interwoven Themes Recreate Daily Life in England

In the third edition of the Harewood Biennial in Leeds, Jakup Ferri is set to show his universe of daily life through interwoven themes. Ferri will show about 70 pieces, including those exhibited at the Venice Biennale. The event, themed Create/Elevate, is scheduled from June 28 up to October 20.

La Femme nga Flaka Goranci jehoi edhe në Vjenë

• Vjena ishte destinacioni i radhës i koncertit La Femme, siç titullohet edhe albumi me të cilin mexosopranoja Flaka Goranci shpalos pasion, dashuri e paqe. Aty bëhen bashkë gra krijuese nga vende të ndryshme të botës. Koncerti i mbajtur në shkurt, u dha në Palais Ehrbar, nën dirigjimin e ukrainases Aleksandra Korobka. Paraqitjen e parë ky projekt e pati në Tiranë, në tetor të vitit 2023. Projekt i saj, i lansuar dy vjet më parë, krahas vlerësimeve të larta nga kritika ndërkombëtare u nominua dhe në tri kategori nga Opus Klassik në Berlin, çmim i dhënë për arritje të larta në fushën e muzikës klasike

Opera Goca e Kaçanikut në Kosovë

• Opera Goca e Kaçanikut e Rauf Dhomit, e cila kishte premierën në Tiranë më 1979, u shfaq për herë të parë në Kosovë në shkurt të këtij viti. Me libret të Ajmone Dhomit dhe Jusuf Buxhovit dhe nën regjinë e Nikolin Gurakuqit, opera është cilësuar historike për identitetin kombëtar që përçon përmes këndimit dhe lojës muzikore. Shfaqja tërhoqi 583 shikues dhe solli emocione të forta falë interpretimit të Filarmonisë së Kosovës dhe lojës së trupës së Baletit Kombëtar të Kosovës. Roli kryesor, Pafika, u interpretua nga sopranoja Adelina Paloja.

La Femme nga Flaka Goranci jehoi edhe në Vjenë

• Vjena ishte destinacioni i radhës i koncertit La Femme, siç titullohet edhe albumi me të cilin mexosopranoja Flaka Goranci shpalos pasion, dashuri e paqe. Aty bëhen bashkë gra krijuese nga vende të ndryshme të botës. Koncerti i mbajtur në shkurt, u dha në Palais Ehrbar, nën dirigjimin e ukrainases Aleksandra Korobka. Paraqitjen e parë ky projekt e pati në Tiranë, në tetor të vitit 2023. Projekt i saj, i lansuar dy vjet më parë, krahas vlerësimeve të larta nga kritika ndërkombëtare u nominua dhe në tri kategori nga Opus Klassik në Berlin, çmim i dhënë për arritje të larta në fushën e muzikës klasike.

Opera Goca e Kaçanikut in Kosova

The Opera Goca e Kaçanikut (“The Girl from Kaçanik”), which premiered in Tirana in 1979, was showcased for the first time in Kosova this February. With a libretto by Ajmone Dhomi and Jusuf Buxhovi and directed by Nikolin Gurakuqi, this opera is regarded pivotal for national identity, reverberating through its vocal and musical interpretation. The performance attracted an audience of 583 and evoked strong emotions, thanks to the interpretation by the Kosova Philharmonic and the performances of the National Ballet of Kosova. The main role, Pafika, was played by soprano Adelina Paloja.



FOTO: ARBEN LLAPASHTICA

Turneu i Korit të Filarmonisë së Kosovës në Itali

• Kori i Filarmonisë së Kosovës ka mbajtur një turne me tri koncerte në Itali, duke performuar në Romë dhe Teramo. Repertori përfshinte vepra botërore dhe një udhëtim nëpër shekujt e muzikës shqiptare, duke përfshirë thesaret muzikore që nga shekulli XIV deri më sot.

The Italian Tour of the Kosova Philharmonic

The chorus of the Kosova Philharmonic held three concert tours in Italy, performing in Rome and Teramo. Their repertoire included international pieces and a journey through the centuries of Albanian music, featuring musical treasures from the 14th century to the present day.

Kompozitorja kosovare që fascinon Gjermaninë

• Kompozitorja kosovare, Dafina Zeqiri, fitoi Çmimin e qytetit të Stuttgartit për kompozimin e saj Infuse: Playtime. Kjo vepër për ansambël instrumentesh është vlerësuar për “intimitetin dhe brishtësinë e tingujve”. Zeqiri thekson se vepra e saj reflekton periudhën e izolimit gjatë pandemisë dhe eksploron intensitetin tingullor përmes një loje instrumentale.

Elbenita Kajtazi i bashkohet Operës Shtetërore të Vjenës

• Sopranoja nga Kosova, Elbenita Kajtazi, do të interpretojë rolin e Mimisë në operën La Bohème të Puccinit në Operën Shtetërore të Vjenës këtë tetor. Kajtazi e konsideron këtë si një moment historik në karrierën e saj. Ajo tashmë është ngjitur në skenat më të rëndësishme të botës operistike.

Oda Haliti mban ritmin në Berlin Beats 2024

• Berlin Beats, njëra prej ngjarjeve kryesore në skenë e muzikës elektronike ftoi DJ nga Kosova, Oda Haliti, për të hapur edicionin e sivjetmë. Më 7 qershor, Haliti performoi para mijëra adhuruesve të muzikës si konfirmim i statusit të saj në skenën ndërkombëtare të muzikës elektronike.

Kosovan Composer Who Fascinated Germany

• Kosovan composer Dafina Zeqiri won the Stuttgart City Award for her composition Infuse: Playtime. This piece for instrumental ensembles was praised for its “intimacy and fragility of the sounds”. Zeqiri emphasized that her work reflects the isolation period during the pandemic and delves on sound intensity through instrumental play.

Elbenita Kajtazi Joins the Vienna State Opera

• Kosovan soprano Elbenita Kajtazi will interpret the role of Mimi in Puccini’s opera La Bohème at the Vienna State Opera this October. She is now established on some of the most renowned stages in the operatic world.

Oda Haliti Shines at Berlin Beats 2024

• Berlin Beats, one of the main events in the electronic musical scene, invited Kosovan DJ Oda Haliti to open this year’s edition. On June 7, Haliti performed in front of thousands of fans, confirming her outstanding status in the international electronic music scene.



FOTO: FCB / HAMBURGER BAHNHOF - NATIONALGALERIE DER GEGENWART



Hana - projekti filmik që synon audiencën botërore

• Projekti filmik Hana, nën regji të Ujkan Hysajt është mbështetur për zhvillim të mëtejshëm në forumin e When East Meets West, i cili organizohet nga fondi audiovizual Friuli Venezia Giulia, në bashkëpunim me Alpe Adria Cinema dhe Trieste Film Festival. Mbështetja nga programi First Cut + ishte një mundësi që filmi Hana të shikohet prej selektorëve të festivaleve, distributorëve dhe ekspertëve të industrisë.

Afterwar për pasojat e luftës në Kosovë me premierë në Berlinale

• Afterwar, një film nga Birgitte Stærmose, dokumenton pasojat e luftës në Kosovë përmes jetëve të katër personazheve. Filmi dha

Hana – A movie Project that Aims World Audiences

The movie project Hana, directed by Ujkan Hysaj, received support for further development at the When East Meets West forum, organized by the audiovisual fund Friuli Venezia Giulia in cooperation with Alpe Adria Cinema and Trieste Film Festival. The support from First Cut+ provided an opportunity for Hana to reach an audience of festival selectors, distributors, and industry experts.

premierën në kuadër të programit Panorama. Afterwar është një bashkëprodhim midis Kosovës, Suedisë, Danimarkës dhe Finlandës dhe një bashkëdyzim në mes të filmit dokumentar dhe atij fiktiv.

Krahët e punëtorëve triumfon në Rotterdam

• Dokumentari Krahët e punëtorëve i Ilir Hasanajt, që trajton historitë e punëtorëve kosovarë të lënduar në punë, fitoi në Tiger Short Competition në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Rotterdam. “Si një dëshmi e punës së njerëzve të klasës punëtore, e bërë me një ton empatik dhe të butë, ky film portretizon ngjarje tragjike në jetën e individëve, plagët dhe dinjiteti i të cilëve përforcohet bukur nga një stil kinematografik i ndershëm dhe modest”, shkruhet në arsyetimin e jurisë.

Filmi Okarina në Festivalin e Filmit në Bergamo

• Filmi Okarina i regjisorit Alban Zogjani, që trajton temat e

Afterwar Depicts the Consequences of War Premiered at Berlinale

Afterwar, a movie by Birgitte Stærmose, chronicles the war consequences in Kosovo through lives of four characters. It premiered in the program Panorama at Berlinale. Afterwar is a co-production between Kosovo, Sweden, Denmark, and Finland, blending documentary and fiction.

Worker's Wings Triumph at Rotterdam

The documentary Krahët e punëtorëve (“Workers’ Wings”) by Ilir

përkatësisë, migrimit dhe vendimmarrjes morale, u shfaq në Festivalin e Filmit Bergamo Film Meeting në Itali. Filmi 92-minutësh, me skenar të Albana Mujës, tregon historinë e një çifti nga Kosova që përballen me sfida të rënda. Edicioni i 42-të i festivalit, u zhvillua nga 9 deri më 17 mars.

Dokumentari Stuntwomen në platformën True Story

• Dokumentari Stuntwomen i regjisoresh kosovare Elena Avdija, që hedh dritë mbi performueset akrobatike dhe sfidat e tyre fizike dhe emocionale, po transmetohet në platformën True Story që nga 8 marsi. The Guardian e ka përshkruar dokumentarin si një vepër me plot nuanca.

Alban Ukaj pjesë e serisë për luftën në Bosnjë-Hercegovinë

• Aktori i njohur kosovar, Alban Ukaj,

Hasanaj, which reflects on the stories of wounded Kosovan workers, won in the Tiger Short Competition category at the International Film Festival in Rotterdam. “A testimony to the labor of working class people, made with an empathetic and gentle tone, this film portrays tragic events in the lives of individuals whose scars and dignity are beautifully amplified by an honest and humble cinematic style”, read the jury’s motivation.

Okarina Shown at the Bergamo Film Festival

• The movie Okarina by Alban Zogjani, which explores themes of belonging, migration, and moral decision-making, was showcased at the

do të luajë në serialin skandinav A Life's Worth, i cili përshkruan luftën në Bosnjë-Hercegovinë në vitet '90. Prodhimi është një bashkëpunim midis Yellow Bird, Arte France, dhe Viaplay Content Distribution dhe pritet të jetë një portretizim intim i sfidave të luftës. Revista Variety e ka cilësuar projektin si të fuqishëm. Pjesë e tij janë edhe aktorët e njohur Edvin Ryding dhe Maxwell Cunningham. Seriali do të trajtojë misionin e ushtarëve suedezë të Kombeve të Bashkuara për të sjellë paqe në një vend të ndarë nga lufta.

Rrugës e rikthen Kosovën në Festivalin e Cannes

- Filmi kosovar Rrugës, me regji nga Samir Karahoda, ishte në garë për Palmën e Artë në kategorinë e filmave të shkurtër në Festivalin e Filmit në Cannes. Rrugës është shkruar nga Samir Karahoda dhe djali i tij Mironi. Filmi ka në fokus tregime personale dhe elemente autobiografike, që pasqyrojnë

shqetësimet e dyshes për të ardhmen e vendit. Rrugës, siç ka treguar regjisor tani nis rrugëtimin e tij nëpër festivale të tjera me nam. Karahoda shkroi histori më 2021, kur për herë të parë me Pa vend dërgoi një film vendor në garë zyrtare në Festivalin e Filmit në Cannes.

Projekti për Adelina Ismailin, fitues i trefishtë në Spanjë

- Dokumentari Adelina, me skenar dhe regji të Aurela Berilës, fitoi tri çmime në festivalin Docs Barcelona, duke përfshirë Best Project Award, Best Pitch Award dhe San Sebastian Foro Lau Haizetara Award.

Ky sukses është një konfirmim i valës së re të kinematografisë së Kosovës dhe tregon potencialin e jashtëzakonshëm të regjisoresh Berila. Dokumentari përfshin jetën dhe karrierën e pop-këngëtares Adelina Ismaili dhe pritet të tërheqë vëmendjen e publikut ndërkombëtar.

Dokumentari për Bekim Fehmiun shfaqet në Beograd

- Dokumentari për aktorin Bekim Fehmiu, i regjisorit Velmir Tertini dhe skenaristit Fahri Musliu, u shfaq në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar Beldocs në Beograd. Filmi prezanton jetën e aktorit të njohur nga Kosova. Premiera në Kosovë u mbajt në Prizren dhe më pas në Prishtinë, ndërsa në Beograd, filmi përfaqësoi Shqipërinë në programin e projeksioneve të veçanta të festivalit.

Si e verdhë e sëmurë shpërblehet në Beograd

- Filmi i shkurtër Si e verdhë e sëmurë i regjisoresh Norika Sefa fitoi çmimin për filmin më të mirë të shkurtër në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar Beldocs në Beograd. Filmi, që kishte premierën në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit

Bergamo Film Meeting in Italy. This 92-minute movie, with a screenplay by Albana Muja, tells the story of a couple from Kosova facing serious challenges. The 42nd edition of the festival was held from March 9 to 17.

Stuntwomen Documentary on True Story Platform

- The documentary Stuntwomen by Kosovan director Elena Avdijsa, which sheds light on acrobatic performers and their physical and emotional challenges, has been available on the True Story platform since March 8. The Guardian described the documentary as a nuanced work.

Alban Ukaj Part of Series about the War in Bosnia

- Kosovan artist Alban Ukaj will be part of the Scandinavian series A Life's Worth, which delves on the war of Bosnia during the 1990s. The production is a collaboration between Yellow Bird, Arte France, and Viaplay Content Distribution; it offers an intimate depiction of war challenges. Variety Magazine has described it as powerful project. The series will feature Edvin Ryding and Maxwell Cunningham. The series will delve into the efforts of Swedish United Nations soldiers to bring peace to a war-torn country.

Rrugës Returns Kosova to the Cannes Festival

- The Kosovan movie Rrugës ("On the Way") by Samir Karahoda competed for the Palme d'Or in the short film category at the Cannes Film Festival. Its screenplay, written by Samir Karahoda and his son, Mironi, revolves around personal stories and autobiographical elements that voice their concerns for the future of their country.

Rrugës, as the director has announced, is set to continue its journey to other important film festivals. Karahoda was first recognized in 2021 when his movie Pa vend was nominated for an official



në Rotterdam, trajton të kaluarën përmes videokasetave familjare. Festivali në Beograd shfaq 103 filma dhe vlerësohet për mbështetjen e krijimtarisë artistike pa censurë, megjithëse filmi nga Kosova u përmend me fusnotë për shkak të politikave institucionale.

Poezitë e Shpëtim Selmanit përkthehen në gjermanisht

• Shpëtim Selmani, debutoi me përmbledhje poezish në gjermanisht. Manifesti i mbijetesës (Manifest des Überlebens), i përkthyer nga Zuzana Finger, u promovua në kuadër të festivalit Balkantage München në Gjermani, që u mbajt nga 1 mars deri më 21 prill. Selmani ishte pjesë e Ditës së Letërsisë më 9 mars duke dërguar zërin e tij poetik te lexuesit gjermanofolës.

competition at the Cannes Film Festival.

Project for Adelina Ismaili, a Triple Winner in Spain

• The documentary Adelina, with screenplay and direction by Aurela Berila, won three awards at the Docs Barcelona Festival: Best Project Award, Best Pitch Award, and the San Sebastian Foro Lau Haizetara Award. This success confirms the new wave in Kosovo's cinematography, showcasing Berila's incredible potential. The documentary delves into the life and career of pop singer Adelina Ismaili and is expected to garner worldwide attention.

Documentary on Bekim Fehmiu Showcased in Belgrade

• The Documentary on actor Bekim Fehmiu, directed by Valmir Tertini and written by Fahri Musliu,

was showcased in the Beldocs International Documentary Film Festival. The film unravels the life of the well-known actor who once captivated audiences in the former Yugoslavia and beyond. It premiered in Prizren and then Prishtina, while in Belgrade, it represented Albania in the special projects program at the festival.

Like a Sick Yellow Awarded in Belgrade

• The short film Like a Sick Yellow (in Albanian "Si e verdhë e sëmurë") by director Norika Sefa won the award for the Best Short Film in the Beldocs International Documentary Film Festival. The film, which premiered at the International Film Festival in Rotterdam, explores the past of family video cassettes.

The Belgrade festival showcased 103 movies and is praised for supporting uncensored artistic production, even though the film from Kosovo was mentioned with a footnote due to political reasons.

Shpëtim Selmani's Poems Translated into German

• Shpëtim Selmani has made his debut to German readers with a collection of his poems. Manifest des Überlebens (originally in Albanian "Manifesti i mbijetesës"), translated by Zuzana Finger, was promoted at the festival Balkantage München in Germany, held from March 1 to April 21. Selmani took part in the Literature Day on March 9, making his entry into the German-speaking literary audiences.



Shkëlqimi i Dua Lipës

• Dua Lipa, ylli me prejardhje kosovare, ka pasur një udhëtim jashtëzakonisht të suksesshëm në këtë pjesë të parë të vitit. Albumi i saj *Radical Optimism* po kryeson toplistat. Zuri vendin e parë si albumi më i dëgjuar në 11 vende, përfshirë edhe Britaninë e Madhe ku shënoi sukses edhe si albumi më i shitur nga një artiste britanike që nga vitit 2021. *Radical Optimism*, po ashtu zuri vendin e parë në toplistën e Billboard për albumin me të shitur dhe vendin e dytë në toplistën e 200 albumeve më të mira. Albumi i tretë i Lipës u vlerësua edhe si album që duhet dëgjuar me patjetër nga shumë medie prestigjioze, përfshirë *New York Times* dhe *Variety*. Albumi përfshin hite si *Training Season* dhe *Houdini* që, po ashtu, shënuan suksese në vete. Lipa nisi turneun e saj për këtë album në Gjermani dhe do të vazhdojë me paraqitje të tjera nëpër Evropë, ShBA, Britani dhe Azi. Do të paraqitet me këngët e saj të reja, por edhe me hitet e mëparshme duke u siguruar ndjekësve të saj një eksperiencë të paharrueshme.

Por nuk është vetëm albumi suksesi i Lipës për këtë vit. Ajo ishte pjesë e listës së 100 personave më me ndikim në botë, e bërë nga *Times*. Në intervistën e saj për këtë medium ajo bisedoi më shumë për suksesin e saj dhe përkushtimin që të promovojë Kosovën dhe Shqipërinë. Këtë vit nuk la pas as minikarrierën e saj në aktrim pasi ishte pjesë e filmi *Argylle*.

Lipa hapi edhe edicionin e 66-të të Grammy Awards me një performancë të zjarrtë të disa prej hiteve të saj, përfshirë këngën *Dance the Night*, nga kolona zanore e filmit *Barbie*. Pavarësisht se ishte nominuar në dy kategori, ajo nuk fitoi asnjë çmim. Mirëpo triumfoi në Brit Awards pas një pauze dyvjeçare, duke fituar trofeun për këngën më të mirë të zhanrit pop me *Dance the Night*. Ajo gjithashtu performoi hitin e saj të ri *Training Season* dhe ishte nominuar edhe në dy kategori të tjera: për këngën më të mirë të vitit dhe artisten më të mirë. Paraqitje pati edhe në edicionin e 59-të të AMC Awards, ku krahas Chris Stapleton këndoi hitin *Think I'm in Love With You* dhe ishte nikoqire, por edhe mysafire e spektaklit të njohur *Saturday Night Live* më 4 maj.

The Brilliance of Dua Lipa

Kosova-born star Dua Lipa had enjoyed an immensely successful journey in the first half of this year. Her album *Radical Optimism* has topped charts, securing the number one spot as the most listened-to album in 11 countries, including Great Britain, where it became the best-selling album by a British artist since 2021. Similarly, *Radical Optimism* ranked first on the Billboard top list for the most sold album and second on the Billboard 200 list of best albums. Lipa's third album has received praises, with prestigious media outlets like *The New York Times* and *Variety* recommending it as a must-listen. The album includes hits like *Training Season* and *Houdini*, which have been successful on their own. Lipa began her tour in Germany and is will continue with performances across Europe, the USA, Britain, and Asia, showing her newest songs alongside her previous hits, ensuring an unforgettable experience for her fans.

However, the album is not her only achievement this year. Lipa was listed among *Time's* 100 influential persons in the world. In her interview with *Time*, she spoke about her success and commitment to promoting Kosova and Albania. Lipa also maintained her mini-career in acting, featuring in the movie *Argylle*.

She opened the 66th edition of the Grammy Awards with a fiery performance of some of her hits, including *Dance the Night* from the *Barbie* movie soundtrack.

Despite being nominated in two categories, she did not win any awards at the Grammys. However, Lipa triumphed at the Brit Awards after a two-year pause, winning the award for the best pop song with *Dance the Night*. She also performed her latest hit *Training Season* and was nominated in two other categories: best song of the year and best artist. Additionally, she had a performance at the 59th edition of the AMC Awards, where she sang the hit *Think I'm in Love with You* alongside Chris Stapleton. Lipa was also the host and a guest on the famous show *Saturday Night Live* on May 4.



FOTO: FCB/DUA LIPA

UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR VEROR I PRISHTINËS

Kryeqyteti në qendër të vëmendjes botërore për dije e shkencë

FOTO: BLERIM GJINOVCI



SARANDA KRASNIQI

Prishtinës, në korrikun e nxehët me diellin përvëlues, çdo vit i jep freski Universiteti Ndërkombëtar Veror. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", institucioni më i rëndësishëm i arsimit të lartë ndër shqiptarë, këtë vit hap dyert e edicionit të 24-t, për të vazhduar traditën që kryeqytetin e kthen në vëmendjen ndërkombëtare të shkencës dhe dijes.

Përgatitjet për edicionin e ri tashmë janë në finesat përfundimtare. Prishtina do të jetë nikoqire për dy javë rresht për profesorë dhe studentë nga vende të ndryshme të botës. Duke filluar nga data 8 deri më 19 korrik 2024 në kampusin e Universitetit të Prishtinës do të organizohen aktivitete të shumta akademike dhe kulturore për t'u ofruar një përvojë unike e mbresëlënëse të gjithë pjesëmarrësve.

Me mbi 100 aplikime për kurse nga profesorë nga vende të ndryshme të botës si: ShBA, Angli, Gjermani, Francë, Poloni, Shqipëri, Indi, Kanada, Australi, Hungari, Itali etj., këtë edicion janë përzgjedhur 28 kurse, nga fusha, si: ekonomia, juridiku, sociologjia, gjuhësia, arti, inxhinieria kompjuterike, inteligjenca artificiale, matematika, mjekësia etj., në të cilat studentë ndërkombëtarë dhe vendorë do të marrin njohuri të çmuara akademike, por edhe kulturore.

Përtej ligjëratave, që do të mbahen çdo ditë nga ora 9:00 deri në 12:00, studentëve do t'u ofrohen edhe aktivitete të tjera si workshope, filma, koncerte, vizita nëpër institucione shtetërore e kulturore, duke e pasuruar kështu përvojë e tyre dyjavore në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, para tyre do të shpaloset Prishtina, me të gjitha dimensionet e saj. Si çdo edicion edhe këtë herë

PRISHTINA
INTERNATIONAL
SUMMER UNIVERSITY

The capital city at the center of world attention for knowledge and science

Each year in Pristina, during the hot, scorching month of July, the International Summer University brings a refreshing change.

The University of Pristina 'Hasan Prishtina', the most important institution of higher education among Albanians, opens its doors this year for the 24th edition, continuing the tradition of bringing the capital to the forefront of international attention in science and knowledge.

Preparations for the new edition are now in their final stages. For two consecutive weeks, Prishtina will host professors and students from various countries around the world.

From July 8th to 19th, 2024, numerous academic and cultural activities will be organized on the campus of the University of Pristina, offering a unique and impressive experience to all participants.

With over 100 course applications from professors worldwide, including the USA, England, Germany, France, Poland, Albania, India, Canada, Australia, Hungary, and Italy, the Selection Committee this edition has selected 28 courses in fields such as economics, law, sociology, linguistics, art, computer

do të organizohet Nata tradicionale me performancën mbresëlënëse të Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Shota, ku pjesëmarrësit do të njihen me këtë thesar të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Nata Ndërkombëtare është një tjetër aktivitet, i cili edhe këtë vit do të zërë vend në aktivitetet kulturore në kuadër të Universitetit Veror të Prishtinës, ku nën tingujt e muzikës ndërkombëtare pjesëmarrësit do të shijojnë ushqime nga vende të ndryshme, prej nga edhe vijjnë profesorët dhe studentët e këtij edicioni.

Gjatë vikendit, për studentë dhe profesorë të PISU-së, si çdo vit tjetër do të organizohen vizita historike dhe kulturore nëpër qytete të ndryshme të Kosovës, vizita përmes së cilave do të njihen më afër me historinë, kulturën dhe bukuritë natyrore të Kosovës.

Koncerte, net filmike, ekspozita, vizita kulturore do ta pasurojnë programin e këtij edicioni, ku ndërthurja e kulturave të ndryshme do të zërë vend qendror.

Këtë edicion pritet të marrin pjesë rreth 300 studentë vendorë dhe ndërkombëtarë, që do të vendosen në Qendër të Studentëve, të cilët gjatë ditës do të jenë të zënë me aktivitete akademike dhe kulturore, ndërsa gjatë netëve të nxehta të korrikut, Prishtina do të jetë nikoqir i tyre.

UVP-ja përgjatë viteve ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e vlerave të shumta të shoqërisë kosovare. Duke i bashkuar kulturat dhe dijet nga anembanë bota në kryeqendrën e Kosovës, është arritur që pozitivisht të ndryshojnë botëkuptimet rreth shoqërisë kosovare.

UVP-ja tashmë ka arritur t'i bashkojë të rinjtë nga vende të ndryshme të botës, pa dallim, duke u bërë kështu edhe pikënisje e miqësive të reja dhe e bashkëpunimeve profesionale.



engineering, artificial intelligence, mathematics, and medicine. International and local students will gain valuable academic and cultural knowledge.

Beyond the daily lectures from 9:00 to 12:00, students will have the opportunity to participate in workshops, watch films, attend concerts, and visit state and cultural institutions, enriching their two-week experience in Kosovo.

In particular, Prishtina will reveal itself to them in all its dimensions.

As in every edition, this time as well, the 'Traditional Night' will feature the impressive performance of the 'Shota' National Song and Dance Ensemble, allowing participants to experience this treasure of Kosovo's cultural heritage.

The 'International Night' is another activity that will take place during this year's cultural events at the Summer University of Pristina. Participants will enjoy international music and cuisine from various countries represented by the professors and students attending this edition.

On the weekend, as in previous years, PISU students and

professors will explore different cities in Kosovo, delving into its rich history, culture, and natural beauty.

Concerts, film nights, exhibitions, and cultural visits will enrich the program of this edition, where the spotlight will be on the fusion of diverse cultures.

This edition is expected to be attended by approximately 300 local and international students who will be accommodated at the Student Center. They will engage in academic and cultural activities during the day, while the warm July nights will offer them opportunities to explore the vibrant city of Pristina.

Throughout its existence, PISU has played a significant role in promoting the rich values of Kosovar society. By fostering an exchange of cultures and knowledge in the heart of Kosovo's capital, it has effectively shifted global perceptions of Kosovar society.

PISU has successfully united young people from different countries worldwide, without distinction, serving as a starting point for new friendships and professional collaborations.

Aromë libri në Prishtinë

Muaji qershor sjell në Prishtinë një ndër ngjarjet më të mëdha kulturore, Panairin e Librit.

The Fragrance of Books in Prishtina

June brings to Prishtina one of the largest cultural events: the Book Fair.

JETA ZYMBERI



Kjo festë e librit vjen e organizuar nga Shoqata e Botuesve të Kosovës.

As a book feast, this annual event is organized by the Association of Kosova Publishers.

Rrugën e saj e nisi prej vitit 1999, duke përjetuar zhvillime dhe transformime që e kanë bërë atë jo vetëm një ngjarje vendëse, por një platformë me ndikim edhe jashtë kufijve të Kosovës.

Këtë vit, për pesë ditë me radhë, në Prishtinë ngjiteshin shkallëve të Pallatit të Rinisë aroma e librit, gjallëria, destinacioni i shumë historive, i aventurave e i vargjeve plot shpirt.

Ndonëse, duhet thënë se këtë vit, pati më pak vizitorë e blerës se viteve të kaluara, megjithatë autorë, botues, lexues dhe të pasionuar pas librit takoheshin për të shkëmbyer ide e për të blerë libra të rinj. Ndërsa, kafenetë përreth Pallatit të Rinisë, ishin të mbushura me njerëz të librit që takoheshin në këtë panair.

Me arritjen e shumë vizitorëve çdo vit, panairi krijon një atmosferë të jetës dhe të aktivitetit kulturor në qytet, përkundër faktit që sipas botuesve, numri i vizitorëve nga viti në vit është në rënie. Ndërsa përmes promovimit të letërsisë, inkurajimit të leximit dhe krijimit të një platforme për autorët dhe botuesit, ky panair shërben si një bastion për zhvillimin dhe promovimin e kulturës së shkruar në Kosovë dhe përtej saj.

Përgjigja është libri ishte motoja që e shoqëroi edicionin e 24-t të Panairit të Librit, i cili mbledhi rreth 100 botues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Diaspora. Në total, numri i titujve të rinj që u prezantuan këtë vit, ishte rreth 2000, ndërsa numri i titujve të viteve të

Its journey started back in 1999, encountering developments and transformations that rendered it from a local event into an influential platform reaching beyond Kosova's borders.

This year's fair, held over five days, brought the fragrance of books, liveliness, numerous stories, adventures, and verses replete with soul to the Palace of Youth and Sports. Although this year's edition had less attendance and sales than in previous years, authors, publishers, readers, and book admirers still mustered to exchange ideas and purchase new books. The nearby coffee shops were humming with fairgoers.

Upon the arrival of visitors, the Book Fair emanated a lively atmosphere and hosted cultural activities, even though the numbers of visitors, as warned by publishers, is decreasing each year. By promoting literature, encouraging reading, and creating a platform for both authors and publishers, the fair provides a stronghold for developing and promoting written culture in Kosova and abroad. Përgjigja është libri (Albanian for "The Answer is Book") was the motto that accompanied the 24th edition of Book Fair, which brought together around 100 publishers from Kosova, Albania, North Macedonia, and the diaspora. As a whole, the number of new titles that were showcased this year was about 2000, while the number of past years was about 6000. The fair coincided with important anniversaries that were celebrated with activities, commemorations, and discussions. This



FOTO: ERMAL META

fundit – rreth 6000.

Ky panairi përkonte edhe me përvjetorë të rëndësishëm, të cilët u shënuan me aktivitete, përkujtime e debate. Madje prezenca e shkrimtarëve të ndryshëm kombëtarë e ndërkombëtarë, botues, përkthyes e librarë, e bëri edhe më të veçantë këtë ngjarje.

Si i ftuar nderi në këtë edicion ishte shkrimtari francez, Eric Faye, i cili në nisje të Panairit tregoi që kjo ishte hera e dytë që vinte në Prishtinë, pas asaj të vitit 1977. Faye, gjithashtu, përmendi edhe dy shkrimtarët tanë, Ismail Kadarenë dhe Rexhep Qosjen, si dy shkrimtarët që e njohën më për së afërmi me Kosovën.

Në një epokë ku teknologjia po transformon mënyrën si lexojmë dhe shkruajmë, Panairi i Librit mbetet një pikë referimi për vlerat e pazëvendësueshme të librit.

Për drejtoreshën e Kulturës në Komunën e Prishtinës, Sibel Halimi, Panairi i Librit është një festë e vërtetë për kulturën dhe mendimin, një mundësi për të ndarë pasionin e përbashkët për librat. "Libri, ky thesar i pashtershëm i dijes dhe frymëzimit, është një urë që na

lidh me të kaluarën, na ndihmon ta kuptojmë të tashmen dhe ta imagjinojmë të ardhmen", tha Halimi në hapje të këtij edicioni.

Nga ana tjetër, shkrimtari e kritikuar letrar, Ndue Ukaj, thotë se Panairi i Librit është një prej ngjarjeve me peshë specifike në jetën kulturore të një vendi, një dëshmi e fortë për të kuptuar udhën nëpër të cilën ka kaluar njerëzimi, por edhe kombi ynë, për të ardhur këtu ku është. Por ka një sugjerim: "Panairi i Prishtinës, si ngjarje e rëndësishme e librit, mendoj se duhet të kalojë në një rrafsh tjetër: të jetë më dinamik, më gjithëpërfshirës, të fokusohet te afirmimi i letërsisë shqipe, te shkrimtari shqiptar, sepse pa e njohur vetveten, nuk mund ta njohim tjetrin ose të pretendojmë ta njohim tjetrin", thotë ai.

E poetja Vlora Konushevc i sheh Panairin e librit si një mundësi të shkëlqyer për të promovuar kulturën dhe letërsinë vendore. Sipas saj, "veç kësaj kjo ngjarje e bën Prishtinën pikë referimi dhe e ngrit prestigjin e saj në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duke ia forcuar identitetin kulturor".

event was made particularly special by the presence of various national and international writers, publishers, translators, and librarians. The honored guest of this edition was French writer, Eric Faye, who, during the opening day, stated that this was his second visit to Prishtina, while his first being in 1997. He also emphasized two Albanian writers, Ismail Kadare and Rexhep Qosja that helped him to get acquainted with Kosova. In an era where technology is transforming the way how we read and write, the Book Fair remains a focal point for the indispensable values of books.

Sibel Halimi, Director of Culture in the Municipality of Prishtina, described the fair as a true feast for both culture and thought, affording an opportunity to share a common passion for books. "Books, as an inexhaustible treasury of knowledge and inspiration, are bridges that connect us with the past, aids us grasp the present and envision the future", said Halimi during the opening ceremony of this edition.

Writer and literary critic, Ndue Ukaj emphasized that the Book Fair is an event of particular importance in the cultural life of a country, describing it as a solid evidence to understand the path that mankind and our nation have traversed to reach the present point. He further proposed that: "the Prishtina Fair, as an important book event, need to evolve into another level: to be more dynamic, inclusive, and focused on affirming Albanian literature and writers, because without understanding ourselves, it is not possible to understand others".

Poet Vlora Konushevc considered the Book Fair as an excellent opportunity to promote local culture and literature. She stated that "this event makes Prishtina a reference point and increases its prestige on national and international level, bolstering its cultural identity".



FOTO: ERMAL META

Kultura e kafesë

Jo rrallëherë Prishtina ka kapur mediet globale për kulturën e kafesë që e ka të përbrendësuar. Vizitorët e huaj mahniten me shijen e kafesë që shërbehet në Prishtinë. Por, gjithashtu, edhe me ritualin që e shoqëron atë.

Prishtina nuk është thjesht një qendër me kafene të mira, të cilat i frekuentojnë të gjithë, por është e shqendrëzuar me kafene për secilën lagje. Megjithatë, rruga 2 Korriku, e njohur edhe si Te kafet e rakisë, në infrastrukturën e së cilës u investua së fundi, me kalldrëmin që ia ka shtuar hijeshinë, mbetet vendi ideal për të kaluar kohën e lirë.





Coffee Culture

Graffiti are an artistic expression that adds colors to the city. They often carry Prishtina has too frequently captured global media attention with its rich coffee culture. Foreign visitors are amazed by the taste of coffee served in Prishtina and the accompanying rituals. Prishtina is not just a center with good coffee shops frequented by all; additionally, it has coffee spots in every neighborhood. Nonetheless, 2 Korriku Street, locally known as Te kafet e rakisë, with its newly built infrastructure and cobblestone pavement, remains the ideal place to spend free time.



NËPËR ULPIANË

Rituali i shahut - identitetet urban i Prishtinës



FOTO: ERMAL META

JETA ZYMBERI

Pamja më ikonike e kësaj pjese të qytetit janë të moshuarit, të cilët çdo ditë mund t'i takosh në vendin e njëjtë. Ata gjejnë strehim nën hijen e drurëve, aty ku vendtakimi ka si qëllim lojën me shah

Në lagjen Ulpianatë kryeqytetit, një peizazh frymëzues merr jetë çdo ditë. Afër fontanës, nën hijen e drurëve, një grup burrash mbledhen çdo ditë për të zhvilluar aktivitetin e tyre të preferuar - lojën e shahut. Nga larg vërehet energjia e mirë që mbizotëron vendin, ndërsa kur afroresh vëren edhe fytyrat e tyre që nuk harrohen lehtë. Shumica nga ta i takojnë moshës 70-80 vjeç, por nuk mungojnë as moshat më të reja. Përkundër diferencës, komunikimi i tyre ishte i shkëlqyer.

Të ndarë në grupe, rreth pesë vetë në tavolinë të vjetra shahu, që ishin shumë afër njëra-tjetrës, po kalonin pasditen në këtë hapësirë relaksuese.

PASSING THROUGH ULPIANA

Chess ritual - an urban identity of Prishtina

The most occurrent view in this part of the city is that of elderly people, whom you can find daily in the same corner. They take shelter in the shade cast by trees, where they meet to play chess

In the Ulpiana suburb, an inspiring scene emerges every day. Next to fountain, in the shade cast by trees, a group of elderly men gather to engage in their beloved activity – playing chess. From afar, the radiating energy of this place is perceptible, and when you get closer you notice their faces that are not easily forgettable. Most of them are in their 70s or 80s, albeit some younger peers join in. Despite their age differences, their communication goes all smoothly. Divided into groups, with five of them around old chess tables, they enjoy their afternoons at this place. When seen from a distance, this is the most iconic vista in this part of the city. However, to converse with them is not that easy, as interrupting their game is regarded a “violation of order and tranquility”, which is why some of them very reluctantly paused their game to talk more of this activity.

“We are liberal as Prishtina”

75-year-old, Sami Berbatovci, who eagerly awaited for his regular chess opponent, had an unusual confidence in every move. Sami conversed with me without interrupting his



Shikuar nga distanca, kjo është pamja më ikonike e kësaj pjese të qytetit. Por, të bisedosh me ta nuk është e lehtë, ndërprerja e lojës konsiderohet “prishje e rendit dhe e qetësisë”, andaj me vështirësi disa prej tyre u shkëputën pak nga loja për të biseduar me ne e për ta na treguar më shumë rreth këtij aktiviteti që e zhvillojnë për vite të tëra.

“Jemi liberal, si Prishtina”

Sami Berbatovci, 71-vjeçari i cili me ngulm e dëshirë e priste kundërshtarin e tij të përhershëm në lojën e shahut, kishte një siguri të pazakontë në çdo lëvizje të tij në shah. Samiu bisedonte me mua, por pa e ndërprerë lojën. Ai tha se ka rreth 20 vjet që çdo ditë luan shah në vendin e njëjtë dhe me personin e njëjtë, mikun e tij me të cilin rrallë kanë hatërbetjenë lojë.

“I vetmi aktivitet që e bëj unë është shahu, asgjë tjetër. Jam pensionist dhe çdo ditë, deri në 4-5 orë rri këtu duke luajtur”, thotë Samiu i cili propozon të krijohen edhe disa ulëse nga druri.

“Përveç lojës, ne këtu edhe bisedojmë, shoqërohemi, e kështu e kalojmë kohën. Këtu do të ishte mirë me e ndreq ende, një plato me ca ulëse druri apo ndonjë shtëpizë të vogël prej druri



game, stating that he plays chess daily for over 20 years in the same spot and with the same friend, with whom he rarely has any squabble.

“The only activity I engage in is chess, nothing else. I’m retired and I play every day for 4 to 5 hours”, he said, while demanding more wood chairs from the municipality authorities.

“Besides playing chess, we talk, socialize, and hang out. It would be great to have a table with some wooden chairs or a small shelter where we could stay. Similarly, a Ping-Pong table would also be nice to change up the routine”, Sami added, with an apparent unwillingness to further converse because he was very attentive on his game.

Meanwhile, 75-year-old Sadik Pervetica seemed quite calm. For him, playing chess was merely a break from the internet. He explained that he plays a little and rather watches his friends, which he finds enjoyable.

“I rarely come here, just at times to relax and take some break from the computer. I usually spend 1 or 2 hours playing chess, and the rest of time watching my friends”, he noted.

Becoming part of the chess-playing society isn’t difficult; all it takes is knowing how to play. This is confirmed by Enver Qerimi, who visits this place once a week to play chess, differing from his friends who come every day.

“I usually come here on Sundays, staying from



ku do të mund të qëndronim. Mirë do të ishte edhe ndonjë tavolinë e ping-pongut, me ndryshu pak lojën", shprehet Samiu, i cili pa dashur të zgjasë shumë muhabetin, vazhdon lojën me një interesim të jashtëzakonshëm.

Ndërsa Sadik Pervetica, një 75-vjeçar, dukej se gjithçka e merrte më shumë qetësi. Loja e shahut, për të, ishte vetëm ikje nga interneti. Sadiku thotë që luan pak, më tepër i shikon miqtë e tij, po që kjo i ndihmon të kalojë kohë të mirë.

"Unë dal rrallë këtu, dal nganjëherë me urelaksu, kur duatë çlodhem prej kompjuterit. Unë zakonisht rri 1 orë apo 2 duke luajtur, pjesën tjetër i shikoj të tjerët".

Integrimi në shoqërinë e shahistëve nuk është i vështirë, mjafton të dish të luash. Këtë e pohon Enver Qerimi, i cili vjen vetëm një herë në javë të luajë shah, ndryshe nga shokët e tij që vijnë çdo ditë.

"Zakonisht unë vij të dielën e rri prej orës 1 deri në 7 pasdite. Përveç shahut, bëjmë muhabet, shaka, ngacmohemi mes vete, hajna e pina bashkë. Këtu edhe parkun e kemi shumë të mirë që na jep një lloj relaksi. Ndosh ta me na shtu edhe një 2-3 tavolina të shahut dhe disa drita na kishin ndihmu shumë. Shpesh na bashko-

“ Loja vazhdon me shumë seriozitet, por pa munguar shakatë me njeri-tjetrin. Në ato tavolina, dukej se askush nuk hidhërohej, shakat merreshin me sportivitet e i linin hapësirë takimit të nesërm.

hen edhe të tjerë për lojë, na se kemi problem, veç a din me luftë edhe bohet pjesë e jona. Jemi si vllazen. Nuk i kqyrim diferencat krahinore e partiake, jemi liberalë si Prishtina", thotë Enveri i cili i kthehet shpejt e shpejt lojës, duke u kërkuar falje shokëve për këtë pauzë.

Soliterat, ikona urbane të Prishtinës

Po në këtë hapësirë, qëndrojnë stoeke edhe ndërtesat më ikonike të Prishtinës. Me pamjen mbizotëruese në qytet, në lagjen "Ulpiana", Soliterat morën jetë në vitin 1963, duke u shndërruar në simbole të kryeqytetit.

Këto ndërtesa, pesë sosh, për dekada, janë më shumë se thjesht struktura urbane, ato janë identifikim i kësaj

↑ 1 PM to 7 PM. Besides playing chess, we talk to one another, tell jokes, eat, and drink together. The park here is quite beautiful and gives some sort of repose. Maybe there are some 2-3 chess tables that are needed as well as lights. Often, we are joined by others, we have no issue about that, all that is needed is to know how to play chess, and they can join our group. We are like brothers and don't care about political or regional differences, we are liberals as Prishtina", Enversaid as he quickly rejoined his game, apologizing his friends for this pause. The game goes on with seriousness, with friendly jokes hurled all the time. It seemed that at these tables there was no resentment whatsoever, jokes were received warmly, and they were impatient to meet the next day.

The Tower Blocks: Urban Icon of Prishtina

In this area, the most iconic buildings of Prishtina stand imposing. With their dominating view over the city, in the Ulpiana neighborhood, the "Soliterat" (urban term for 'tower blocks') were built in 1963 and have become symbols of Prishtina. Those buildings, consisting of five edifices, are more than just urban structures for they have become a sort of identification for this part of the city. Apart from their considerable height, their unique outlook comes from the sheet metal façade. Considered architectural heritage, the "Soliterat" convey in a way the identity of Prishtina. Despite falling into a state of disrepair over time, their renovation in 2022 was felt like a renewal of this area, making them an attractive destination for both locals and visitors. A lively life is constantly buzzing under these high structures. There are a lot of businesses and coffee shops all around with people walking in these areas.

pjesë të qytetit. Përveç të larta, janë objektet me pamjetë veçantë që ua jep llamarinë e përdorur në fasadën e jashtme.

Të konsideruar si trashëgimi arkitektonike e kryeqytetit, Soliterat përfaqësojnë identitetin e Prishtinës. Pas dëmtimeve të shumta që erdhën si pasojë e kohës, rinovimi i tyre në vitin 2022 ka qenë si një rilindje për këtë pjesë të kryeqytetit, duke u shndërruar në një destinacion tërheqës për banorët dhe vizitorët. Nën këto struktura të larta, ka vazhdimisht gjallëri. Biznese dhe kafene ndriçojnë rrugën, ndërsa njerëzit lëvizin lirshëm, duke i dhënë jetë kësaj hapësire.

Ndërsa, në mes të Soliterave, si pjesë lidhëse e tyre, qëndron Fontana. E kush nuk e ka dëgjuar të paktën njëherë shprehjen Te fontanën Ulpianë, që përdoret si pikë referimi, shpesh si vendtakim i studentëve, konviktet e të cilëve janë shumë afër saj. Ose, në vargun e këngës së Sabri Fejzullahut: "Sa herë çelin trëndafilat, te Fontana në Prishtinë". Ndonëse aktualisht është jashtë funksioni, vazhdon të mbetet si një ndër vendet e preferuara të qytetarëve. E rrethuar me drurë e ulëse, të cilat asnjëherë nuk janë asnjëherë të zbrazëta, përbën një skenë përralle.

Kjo bukuri e lagjes Ulpiana haset në secilën stinë të vitit. Në pranverë, lagja është si një botë e re, ku dominon ngjyra e gjelbër dhe aroma e luleve të freskëta. Kur gjethet bien, ajo kthehet në një pikturë të mrekullueshme të vjeshtës, ndërsa bora, i jep shkëlqim si njëmbulesë e artë.

Lirshëm mund të themi, se kjo pjesë e qytetit është një thesar i natyrës dhe i arkitekturës, një oazë urbane që nuk zbehet dot.



In the midst of these buildings is the famous Fountain. It feels familiar with the well-known line "Te Fontana në Ulpianë" which is used as a reference point, often as a meeting venue for the students who reside in the nearby dormitories.

This image is immortalized in Sabri Fejzullahu's song: "Saherë çelin trëndafilat, te Fontana në Prishtinë" (When roses bloom at the Fountain in Prishtina). Even though it is not functioning, it remains a preferred place for local residents. Surrounded by trees and chairs, which are always full of people, it appears as a beautiful scene.

The beauty of the Ulpiana neighborhood is present in every

season. In spring, this quarter feels like a new world with lush colors and the fragrance of fresh flowers. When leaves fall, this part renders into an exquisitely beautiful scene of autumn, while snow gives it a unique charm in winter. Overall, this part of the city appears as a treasure of both nature and architecture, an urban oasis that never fades.



Kosova po shënon rritje të turistëve ndërkombëtarë



BAKI HOTI
KRYETAR I UNIONIT TË
TURIZMIT TË KOSOVËS

Kosova, në 6 mujorin e parë të vitit 2024 ka shënuar rritje të numrit të vizitorëve ndërkombëtarë të cilët po zgjedhin Kosovën për ta vizituar.

Përfshirja e Kosovës në paketat turistike Ballkanike dhe Europiane, kontributi dhe promovimi i potencialeve turistike nga Unioni i Turizmit të Kosovës dhe pjesëmarrja në Panaire Ndërkombëtare të Turizmit janë disa faktorë të cilët po japin rezultate pozitive në rritjen dhe interesimin e grupeve të ndryshme turistike për ta vizituar Kosovën.

Shtimi i aktiviteteve kulturore e po ashtu edhe festivaleve ka ndikuar pozitivisht në rritjen e interesimit për ta vizituar Prishtinën dhe kjo ka sjell rezultate pozitive që në 6 mujorin e parë të këtij viti, ku kemi mbi 30 për qind rritje të vizitorëve në Kryeqytet.

Kur jemi tek aktivitetet Panairi Ndërkombëtar i Turizmit Kosova 2024 i cili u mbajt në muajin prill, i cili është produkt dhe i organizuar nga Unioni i Turizmit të Kosovës dhe nën patronatin e Komunes së Prishtinës ka dhënë një efekt shumë pozitiv tek e gjithë Industria e Turizmit duke ditur që këtë vit në këtë Panair morën pjesë si Expozues mbi 300 Kompani Turistike dhe Hoteliere nga 15 shtete.

Kosova Marks an Increase in International Tourists

In the first half of this year, Kosova has seen an increase of international visitors opting to spend time in our country.

Factors contributing to these positive trends include Kosova's inclusion in Balkan and European tour packages, the efforts and promotion of touristic potentials by the Kosova Tourist Union, and participation in the International Tourism Fair. Additionally, an increase in cultural events and festivals has led to a 30% rise in tourist numbers in Prishtina during the first half of this year.

The International Tourism Fair Kosova 2024, held in April and co-organized by Kosova Tourism Union and the Municipality of Prishtina, positively impacted the entire tourism industry. This year's edition featured over 300 tourism and hotel companies from 15 countries, including Malta, Greece, Bulgaria, Slovenia, and many others, emphasizing their interest in advancing cooperation with Kosova in tourism.

The Kosova Tourism Union has recommended that both local and



Pjesëmarrje e shtetit të Maltës, Greqisë, Bullgarisë, Sllovenisë e shumë shtete të tjera tregojnë interesimin dhe thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe këtyre shteteve sa i përket Industrisë së Turizmit.

Unioni i Turizmit të Kosovës ka rekomanduar edhe tek institucionet lokale dhe ato qendrore që t'i jepet prioritet turizmit dhe të punohet intensivisht në zhvillimin dhe promovimin e vlerave tona kulturore dhe natyrore, duke intensifikuar përpjekjet dhe krijuar kushtet për zhvillimin e turizmit rural dhe agroturizmit si dhe turizmit shëndetësor.

“ Krijimi i kushteve më të mira të infrastrukturës rrugore, politika dhe strategji zhvillimore dhe mbështetëse për sektorin privat, ulja e taksave dhe të tjera lehtësira do të ishin disa nga elementet kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm të turizmit të Kosovës.

central authorities prioritize tourism, working tirelessly to develop and promote cultural and natural values, and amplifying efforts to create conditions for rural tourism, agro tourism, and health tourism.

“ Some of the key elements for sustainable development of Kosovo's tourism include better road infrastructure, policies and strategies supporting the private sector, tax reductions, and other facilitation measures.

SHËTITJE ME TURISTË E CICERON

Dy orë udhërrëfim për Prishtinën

Rreth dy orë është rrugëtimi i një guide për turistët e huaj, për të rrëfyer aq sa është e mundur nga historia e pasur e nga aktualiteti dinamik i kryeqytetit tonë.

ALBERINA HAXHIJAJ

Të takosh Astrit Sahitin te Teatri Kombëtar është veç hapi i parë drejt të kuptuarit të Prishtinës nga perspektiva e vizitorëve të huaj. Me të biseduar me të, të ofrohen detaje mbi atë se cilët vizitorë janë më shumë të interesuar për Kosovën. Thotë se shumica e vizitorëve në Prishtinë janë transit nga vendet e tjera fqinje.

Thekson se vizitorët e huaj i kërkojnë kryesisht vendet kulturore e tradicionale të qytetit, veçanërisht pjesën e vjetër të Prishtinës, ku ndodhen Muzeu Etnologjik, Xhamia e Madhe, Sahat Kulla, që të gjitha si përfaqësuese të arkitekturës osmane. Megjithatë shton se turistët janë të interesuar edhe

për pjesën e re të qytetit, veçmas për monumentet e ndërtesat që, siç thotë ai, “përbëjnë identitetin e Prishtinës”.

“Ata janë të interesuar për monumentin NEWBORN dhe Pallatin e Rinisë, por edhe për Monumentin e Heroinave të luftës së fundit. Në pjesën e re të qytetit, pikat kyçe për vizitorët janë Biblioteka Kombëtare dhe Katedralja”, thekson Sahiti.

Fillimi i udhëtimit

Grupi fillimisht njoftohet me njëri-tjetrin dhe kur mësojnë që atyre do u bashkohet edhe një gazetare e fotograf, biseda kalon te pyetjet rreth gazetarisë, fjalës së lirë e mungesë së gazetave të shtypura.



FOTO: ERMAL META

A WALK WITH TOURISTS AND A GUIDE

Two Hours of Prishtina's Story

The journey across Prishtina, led by a local guide for foreign tourists, lasts about two hours and purports to tell as much as possible the city's rich history and dynamic present.

Encountering Astrit Sahiti next to the National Theatre building was just the first step to getting a glimpse of Prishtina from the perspective of foreign tourists. Once you converse with him, you get an idea about what attracts the most visitors to Kosovo. According to Sahiti, most tourists come through Kosovo while in transit from neighboring countries.

Astrit noted that tourists are particularly fond of cultural and traditional sections of the city, notably the old part of Prishtina where the Ethnological Museum, the Great Mosque, and the Clock Tower Clock are situated—with most of them reflecting Ottoman architecture. Yet, tourists also show curiosity about the new part of the city, especially the monuments and buildings that define Prishtina's identity.

“They are interested in the Newborn monument and the Palace of Youth, but also in the Heroines Monument. In the modern section of the city, the National Library and

Sidoqoftë, shpejt fokusi rikthehet të trashëgimia e kultura.

Te Teatri Kombëtar i Kosovës, Astriti zhytet në historinë e Prishtinës, tregon për kohën kur u zgjodh ky qytet të bëhet kryeqytet dhe se si njëherë përgjatë tij kalonin dy lumenj. Ai jep të dhëna për demografinë e qytetit, thekson se pjesa dërrmuese e popullsisë janë të rinjtë dhe ndan informata të lezetshme për turistët, si ajo për rolin e kafeneve në vend.

Një veçanti e udhëtimit dyorësh ishte edhe paraqitja e një qeni të rrugës që iu bashkua grupit që më fillim. “Ky qen është një pjesë e pandashme e grupit tonë”, thotë Astriti. Qeni qëndroi gjatë gjithë kohës me grupin, duke i dhënë një hijeshi të veçantë këtij udhëtimi.

Për Mirte-n nga Holanda, ky udhëtim është një mënyrë e mirë për t’u njoftuar me Prishtinën. “Ne kemi mësuar të dhëna interesante për vendin dhe kemi pasur një bisedë shumë të këndshme”, thotë ajo.

Të dhëna historike dhe monumentet kryesore

Gjersa grupi ecën nëpër qytet, Astriti ndan histori që nisin para më shumë se 4 mijë vjet, përmend ilirët dhe rëndësinë që kishte kjo pjesë në Perandorinë Romake si transit për rrugë tregtare.

Astriti tregon se Teatri Kombëtar është duke u rinovuar dhe se Trupa e Baletit dhe ajo e Teatrit janë duke ushtruar në një vend tjetër gjatë kësaj kohë. Nga aty kalojnë te statuja e Skënderbeut, ku mësojnë për heroin kombëtar dhe namin arbëror të kohës së tij. Më pas mësojnë për Ibrahim Rugovës dhe ndikimin e politikës së tij për paqe, liri e pavarësi. E shkurtër është ndalesa edhe te monumenti dedikuar të zhdokurve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ndalesa tjetër është te xhamia e Sulltan Mehmetit II (Fatihut) në Prishtinë, që njihet edhe si xhamia e madhe e Prishtinës, te Hamami i Madh ose Hamami i Sulltan Mehmet Fatihut dhe te Sahat Kulla. Astriti jo vetëm që ndan informata



the Cathedral remain the main attractions for tourists”, Sahiti said.

The Start of the Journey

At the beginning, group members introduced themselves to one another. Once they learned that a journalist and a photographer will be joining them, the conversation quickly turned to topics like journalism, freedom of speech, and the absence of printed newspapers. However, their focus soon shifted to heritage and culture.

Next to the National Theatre, their meeting point, Astrit delved into Prishtina’s history, recounting the times when the city was chosen as the capital and how there were once two rivers that traversed the city. He shared information about the city’s demographics, asserting that the bulk of population is made up of young people. Then, the guide also offered other interesting glimpses for tourists, such as the role of cafes in society.

This two hour journey was accompanied by a street dog who joined the group since it started to walk through the square. “This dog is an inseparable part of our group”, Astrit said. Indeed, the dog stayed with the group the whole time, enriching the experience.

Mirte, a tourist from Holland, stated that the tour provided a great

opportunity to get to know Prishtina. “We learned very interesting information about the country and had very enjoyable conversations”, she said.

Historical Tidbits and Monuments

While walking across the city, Astrit shared histories that stretch back more than 2,000 years, explaining of the Illyrians and the importance of this region within the Roman Empire as a transit hub for trade routes.

He informed his group that the National Theatre is currently undergoing renovations, and that both the acting and ballet ensembles are rehearsing at a different location. From there, the journey continued a few meters away to the Scanderbeg monument, where he spoke about the National Albanian hero and his renown during his era. The tourist group then learned about Ibrahim Rugova and the influence his politics had in pursuing peace, freedom, and independence. There was a brief stop at the monument dedicated to the missing persons from World War II.

The next stop was at the Mosque of Sultan Mehmed II, officially known as the Great Mosque of Prishtina, followed by the Great Hamam and the Clock Tower. Astrit not only

historike rreth këtyre monumenteve, por edhe fakte interesante si vjedhja e sistemit të orës së Sahat Kullës, së ndërtua në shekullin XIX, në bërthamën e zonës kulturore-historike të Prishtinës.

Rrugës, turistët bëjnë pyetje të ndryshme duke nisur nga procesi i vizave, vendosja e flamurëve afër çrimeve të mallrave të ndryshme nëpër markete, marrëdhëniet me Serbinë dhe vendet e tjera fqinje, restorantet më të mira për të provuar ushqim tradicional, baret për të pirë në mbrëmje e shumë të tjera. Me elokuencën e tij, Astriti ka përgjigje e rekomandime për secilën nga këto. "Udhëtimi ishte shumë i mirë për të marrë informata për vendin nga perspektiva e vendësve", thotë Ariel, njëri prej turistëve.

Një ecje përgjatë tranzicionit

Ndalesa më e gjatë është te Muzeu Etnologjik, ndërtesa prej guri dhe druri që ishte shtëpia e familjes Gjinolli për shumë vjet, para se të bëhej muze. I vetmi monument që turistët e vizitojnë nga brenda dhe kalojnë më shumë kohë. Aty mund të shohin një mënyrë të detajuar se si familjet jetonin, çfarë rrobash vishnin, armët dhe artefaktet që zotëronin gjë që e pasuron vizionin se si shqiptarët jetonin në shekujt e kaluar.

Secila prej dhomave rrëfen për rutinën, e detajet e së përditshmes së një familjeje. Tani muzeu prezanton edhe kostumet historike, tradicionale në Kosovë.

Aty grupit i bashkohet edhe një anëtar i ri që vazhdon pjesën tjetër të udhëtimit me ta. Është Davide Bella që u thotë të tjerëve që mund ta thërrasin Asti.

"Një udhëtim shumë i mirë në këmbë me një çmim të arsyetueshëm", thotë ai për këtë



eksperiencë.

Udhëtimi vazhdon drejt Pazarit të vjetër, pastaj drejt sheshit Adem Jashari, ku mësojnë për historinë e Trekëndëshit. Nga aty kalojnë përgjatë ndërtesës së Qeverisë dhe Parlamentit. E ecja vazhdon drejt Newborn-it, duke bërë edhe disa ndalesa: te statuja e Nënë Terezës, me të cilën vendësit krenohen e te pllaka që përkujton ushtarët e KFOR-it të rënë në Kosovë nga viti i hyrjes së NATO-s në vend. Pastaj në sheshin Zahir Pajaziti, ku shkurtimisht mësojnë për hotelin Grand. Aty murali i këngëtares Dua Lipa, nxit diskutim për festivalin Sunny Hill dhe për yjet e tjera të muzikës që janë të njohura ndërkombëtarisht, si: Rita Ora, Bebe Rexha e Ava Max. Kjo ecje u bë më 1 qershor, për Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, kur sheshet ishin të mbushura me fëmijë dhe aktivitete të ndryshme, duke i shtuar kështu gjallëri kryeqytetit që turistët e këtij grupi e gjetën të qetë në mëngjes.

Kjo i la përshtypje edhe Ashok-it, nga Toronto i Kanadasë, që po udhëton nëpër Ballkan e që pas Prishtinës vazhdon udhëtimin e tij për në Pejë.

brought forth interesting information but also shared little-known facts, such as the theft of the clock mechanism from the Clock Tower, which was built in the 19th century in the very heart of old Prishtina.

As they walked, tourists posed various questions, starting from visa requirements and the presence of flags next to prices in stores, to relations with Serbia and other neighboring countries, the best recommended restaurants for tasting traditional foods, night bars, and so forth. With his eloquence, Astrit provided answers and recommendations for each of these questions. "The trip was very good for getting information about the country from a local perspective", said Ariel, one of the tourists.

A Walk Through Transition

The longest stop was at the Ethnological Museum, housed in a stone and wood home that was once the property of the Gjinolli family before becoming a museum. It was the only monument that tourists went inside, spending a lot of time there. This place allowed them to get a detailed understanding of how was the life back then, displaying traditional dress, arms, and other possessions, enriching their vision of how Albanians used to live in past centuries.

Each of the rooms attests to the daily routines of family life from the 19th century. Now, the museum also displays traditional and historical costumes from Kosova.

There a new member, Davide Bella, who asked to be called Asti, joined the group and continued the rest of trip.

"It is a very good journey with a reasonable price", he said about the experience.

The journey continued towards the old Bazaar, then followed to Adem Jashari Square, where they learned

"Ishte fasionuese të shohësh monumente historike përgjatë këtij udhëtimi në këmbë. Po ashtu, ishte diçka shumë e mirë të shohësh gëzimin e fëmijëve në sheshin Nënë Tereza, për shënimin e ditës së tyre gjatë manifestimit", thotë ai.

Te Newborn-i, grupi mëson për shpalljen e pavarësisë dhe mungesën e presidentit Ibrahim Rugova gjatë këtij momenti historik, çfarë ngjall keqardhje edhe te turistët që tashmë e njohin këtë figurë të rëndësishme për vendin. Monumenti i Pavarësisë është vendi ku grupi realizojnë foto kolektive si kujtim. Aty mësojnë edhe për Pallatin e Rinisë dhe ndalen edhe te një monument që u lë shumë përshtypje - Heroinat.

Ndalesa tjetër, e fundit për këtë udhëtim, është Biblioteka Kombëtare e Kosovë.

Për Vincentin nga Holanda që po bën këtë udhëtim bashkë me të dashurën e tij, Mirte, kjo ishte një eksperiencë shumë e mirë. "Faleminderit", thotë ai në shqip, si shenjë mirënjohje.

Astriti u rekomandon të vizitojnë edhe qytet të tjera, si Pejë e Prizrenin. Por edhe lokacione brenda Prishtinës si Galerinë Kombëtare disa hapa më tutje, pastaj Katedralen Nënë Tereza e statujën e Bill Clinton-it.

Përfundimi i kësaj ecjeje ishte i këndshëm edhe për Kiraz Yurt-in nga Gjermania.

"Ishte një ditë shumë e mirë. Shoqëruar me njerëz shumë miqësorë dhe me një mot shumë të mirë", thotë ajo. Grupi, që krijon një lidhje brenda këtyre dy orëve, ndan numrat e telefonit me njëri-tjetrin. Disa vendosin të vazhdojnë eksplorimin e qytetit së bashku, të tjerë bëhen gati për të lënë kryeqytetin e disa prej tyre lënë edhe një takim për në mbrëmje, për të pirë së bashku nga një pije apo për të vazhduar eksplorimin e jetës së natës në Prishtinë.



more about the history of the Triangle space ("Trekëndëshi" in Albanian). From there, the group walked past the Parliament and Government buildings. Their trip continued towards the Newborn monument with some stops along the way: at the Mother Theresa statue, a source of pride for the residents, and at the plaque remembering the fallen KFOR soldiers in Kosovo. The group spent some time in Zahir Pajaziti Square, where they learned about the Grand Hotel. The nearby mural of Dua Lipa sparked some discussions about the Sunny Hill festival and for other internationally recognized stars from Kosovo such as Rita Ora, Bebe Rexha and Ava Max. This trip occurred on June 1, coinciding with the International Day of Children's Rights, and the squares were full of children and activities, thus creating a vivacious atmosphere in the city, which had been quite calm in the morning when the group started their trip.

Ashok from Toronto, Canada, was impressed and planned to continue his trip to Pejë.

"It was fascinating to see historical monuments during this trip. It was wonderful to see the joy of the children in Mother Theresa Square celebrating their day", he said.

At the Newborn Monument stop, the group learned about the proclamation of independence and the absence of Ibrahim Rugova on that

occasion, which elicited some remorse among the tourists who were already acquainted with this important figure. The Independence Monument is where the group takes a collective photo to remember their experience. There, they also learned about the Palace of Youth and then stopped at a monument that triggered a lot of interest—the Heroines Monument.

The last stop was the National Library of Kosovo.

Vincent from Holland, who made the trip with his girlfriend Mirte, found this experience very memorable. "Falemninderit", he said in Albanian as a token of gratitude.

Astrit recommended they visit other cities as well, such as Pejë and Prizren. He also suggested they visit other locations in Prishtina, like the National Gallery which was a short distance away, then the Cathedral Mother Theresa, and the statue of Bill Clinton.

The entire walking trip was delightful for Kiraz Yurt from Germany. "It was a very good day. We were accompanied by very friendly people and had lovely weather", she said.

The group members, who already formed acquaintances during these two hours, exchanged phone numbers to one another. Some decided to continue exploring the city, while others prepared to leave Prishtina. A few of them planned to meet in the evening to enjoy Prishtina's nightlife together.

IN MEMORIAM: SHAQIR HOTI (1936-2021)

Krijuesi i tingujve të përjetshëm

Krahas krijimtarisë së madhe muzikore që la pas vetes, ishte i njohur edhe për punimin e veglave frymore nga thesari i trashëgimisë kulturore artistike

JETA ZYMBERI

Mbi 2 mijë ekzemplarë instrumentesh të ndryshme janë gdhendur nga duart e tij e mijëra melodi kanë marrë jetë nga fryma dhe gishtat e tij, duke krijuar një trashëgimi të pavdekshme për kulturën e traditën tonë.

Tingujt e parë nisi t'i nxirrte qysh në fëmijëri, nën hijen e kodrave të Hasit, aty, mes drurit të gjallë e gurit të përjetshëm, mes këtyre materialeve natyrore që më vonë i shërbyen për të bërë art.

Sa ishte gjallë, Shaqir Hoti kishte vetëm një kërkesë, që "këto instrumente të mos lihen në harresë, sepse kanë qenë shumë shekuj në këto treva". E thirrja duhet të jetë kjo - që njeriun e artë të melodisë folkloristike dhe veprën e tij të veçantë, të vazhdojmë t'i kujtojmë përherë.

Baca Shaqë, ashtu siç e thërrisnin të gjithë nga dashuria dhe respekti, nuk iu nda asnjëherë instrumenteve. Krahas krijimtarisë së madhe muzikore që la pas vetes, ishte i njohur edhe për punimin e veglave frymore nga thesari i trashëgimisë kulturore. Ai luante në instrumente, i krijonte ato, i studionte e u falte gjithë dashurinë e mundshme. Kështu, me tingujt e lëshuar ngjallte emocione te secili njeri. Tetë dekada jetë, baca Shaqë me një qetësi shpirtërore e



një urtësi të paparë ia falë punës së tij si instrumentist. Nxjerrja e instrumenteve shqiptare në pah, për të ishte mision jetësor, ndërsa për ne mbetet traditë që nuk duhet harruar.

Një hapësirë poshtë shtëpisë së tij, ishte vendi ku ai kaloi një pjesë të mirë të jetës. Në atë vend merrnin jetë të gjitha instrumentet që vinin si prodhim nga druri, guri, briri, kallami, lëkura, gëzhoja e frytit të arrës e të lajthisë. Fyellin, kavallin, bishtnicat, pipëzat i kishte trashëgim nga familja.

Shaqir Hoti, të cilin rrallë mund ta shihje pa fyell apo kavall në duar, nuk ishte thjesht një muzikant, por një arkitekt i tingujve, një krijues atmosferash festive.

Në këngën Baresha, që erdhi nën interpretimin e mahnitshëm të Nexhmije Pagarushës, një këngë e pavdekshme që të merr me vete qysh në melodinë e

The Creator of Immortal Sounds

Besides an immense body of musical oeuvre handed down to posterity, he was famous for crafting wind instruments from the treasure of artistic and cultural heritage

Over 2,000 exemplars of various instruments were crafted from his hands, thousands of melodies came to life from his breath and fingers, coalescing into an immortal legacy for Albanian culture and tradition.

The first sounds he produced were while he was a child, in the shade of Hasi hills, among living trees and eternal stones which later served to forge his art.

While he was still living, Shaqir Hoti had only one request: that "these instruments shouldn't fall into oblivion, as they had centuries-long presence". This calls for a continuous remembrance of the revered man who marked his traces through folk melodies and his unique work.

Known affectionately as Baca Shaq (Albanian term for 'uncle'), he was never separated from his instruments. Besides an immense body of musical oeuvre handed down to posterity, he was famous for crafting wind instruments rooted in artistic and cultural heritage. He played with instruments, crafted, studied, and gave all of his love to them. Through the sounds he stirred emotions in everyone. With a life that spanned over eight decades, baca Shaq, with spiritual calmness and exceptional wisdom, dedicated himself to the instruments. For him, it was felt like a lifelong mission to affirm Albanian instruments, while for our generation it remains a tradition that should not fall into oblivion.

A large part of his life was spent in a space just below his house. In that workshop, all

parë, nuk ka munguar edhe fryma e Shaqir Hotit. Me mjeshtërinë e tij të rrallë, ai e ka përcjellë me flaut, në versionin e saj origjinal.

Në veçanti, Shaqir Hoti u njoh për punën e tij në kultivimin e okarinës – të parën prej dheu e krijoi në vitin 2010. Këtë instrument ai e kishte shumë për zemër, shumë të tilla zinin vend në studion e tij. Madje duket sikur vitet e fundit ia ia dedikoi në tërësi këtij instrumenti, origjinali i secilës u gjend në Runik afër Skenderajt. Por baca Shaqë nuk arriti ta shihte asnjëherë instrumentin origjinal që dikur u ekspozua edhe në muze, por duke u bazuar në fotografi dhe me specifikat që ia përshkruan, ai arriti të sjellë në jetë shumë të tillë, duke e shndërruar atë në një instrument të vlerësuar në skenën muzikore.

Shaqir Hoti ishte një promotor i zhvillimit të instrumenteve frymore në Kosovë. I njohur si flautisti i parë i Kosovës, ai ishte më shumë se një interpretues i shquar në ansamblet folklorike dhe klasike - ai ishte një inovator i muzikës shqiptare.

Me vdekjen e tij, Kosova humbi një figurë të rrallë, një udhëheqës të dashur dhe të urtë. Me talentin, diturinë dhe humanizmin e tij, ai jo vetëm që promovoi artin, por gjithashtu kontribuoi në ngritjen e kulturës sonë kombëtare.

Shaqir Hoti, gjithë jetën punoi për autentikën, për zanafillën, për muzikën burimore e folklorin. Studios së tij që gjendet në Prishtinë, pritet t'i bëhet një vend në Muzeun Kombëtar të Kosovës, aty ku me veprimtarinë e tij do të njihen edhe brezat e ardhshëm.

Okarina e Runikut është një instrument muzikor frymor që i takon periudhës neolitike dhe si i tillë paraqet instrumentin më të hershëm muzikor të zbuluar ndonjëherë në Kosovë. Në bazë të analizave dhe të studimeve arkeologjike, vogla muzikore e zbuluar në Runik të Skenderajt, është një instrument muzikor frymorë autokton dhe i takon të ashtuquajturës Kultura e Starçevës por që mund të quhet edhe Kultura e Runikut.

Ky artefakt unik, i punuar prej argjile, ka formën e një ene të dyfishtë me lartësi 8 cm dhe gjerësi 5 cm, me vrima të bëra në pjesën e epërme dhe dy vrima anash. Emërtimi Okarina rrjedh nga një vegël muzikore italiane e shekullit XIX. Ky instrument, i cili prodhon një zë të butë si flauti, konsiderohet si një nga instrumentet muzikore më të hershme edhe në Evropë.



FOTO: ARBEN LLAPASHTICA

instruments made of wood, stone, horns, reeds, leathers, kernels of nuts, and hazelnuts came to life. His family tradition passed down to him the flute, kaval, double pipe, and pipes.

As someone who could rarely be seen without his flute or kaval, Shaqir Hoti was not just a musician but an architect of sounds and a begetter of festive vibes.

He had a notable share in the song "Baresha" (The Shepherdess), superbly performed by Nexhmije Pagarusha, which still enthralls us with its first melodies. With his exceptional skills, he accompanied the original version with the flute.

More specifically, Shaqir Hoti gained reputation for his work in promoting ocarina – the first made from soil he devised in 2010. Having an inclination for ocarina, many of them were placed in his studio. In his last years, it seems that he became wholly dedicated to this instrument, whose original was found in the village of Runik in the Skenderaj region. Despite never seeing the original piece (which once was exposed in museum), he recreated many of them based on photographs and other specifics, making it a well-received instrument in the musical domain. He made use of Albanian folk tradition by creating new original works.

Shaqir Hoti was a promoter of further developing wind instruments in Kosova. Hailed as "the first flutist

in Kosova", he was more than a renowned interpreter in folk and classical ensembles; overall, he was an innovator of Albanian music.

With his passing, Kosova lost a unique, larger-than-life sage. Through his talent, knowledge, and humanitarian spirit, he promoted art and made a major contribution to elevating Albanian national culture.

Shaqir Hoti dedicated his life to bringing forth original values, original songs, and folk music. His studio is set to be exposed in the National Museum of Kosova, offering future generations an opportunity to cherish his life and legacy.

The Ocarina of Runik is a wind musical instrument that pertains to the Neolithic period. As such, it represents the earliest musical instrument discovered so far in Kosova. According to archaeological studies and analysis, this indigenous wind instrument belongs to the so-called Starçeva culture, which can also be interchangeably called the Runik culture.

This exceptional clay artifact has a double-vessel shape, measuring 8 cm in height and 5 cm in width. It features finger holes on the top part and two side holes. The term 'ocarina' stems from a 19-th century Italian musical instrument. This instrument, known for producing flute-like sounds, is considered one of the earliest musical instruments in Europe.

MODERNIZIMI I TRADICIONALES:
GRANITA GREZDA - LILA

Arti në qeramikë

Zanatlinjtë e punimeve prej argjile kanë me mijëra ndjekës në rrjete sociale, e veprat artistike të punuara nga balta po shiten me çmime marramendëse. Ky lloj arti duket se po përjeton edhe njëherë lavdinë e dikurshme. Interesim ka edhe në Kosovë. Gjenerata të reja kanë marrë përsipër pjekjen në furrë dhe kanë krijuar një trend të ri. Mes tyre është Granita Grezda – Lila, dyqani i së cilës është shndërruar në një pikë frekuentuese për adhuruesit e artit prej balte. Ajo po i jep një frymë të re dhe moderne një tradite të lashtë.

ALBERINA HAXHIJAJ

Prishtina ndër vite është bërë shtëpi për studentët, të cilët kanë ardhur në kryeqytet nga qytete të ndryshme të vendit për t'i përfunduar studimet. Shumica prej tyre erdhën me ëndrra të mëdha. Edhe Granita Grezda-Lila ishte njëra prej tyre. Ajo po e ndiqte ëndrrën e saj për të shkëlqyer si piktore, por ja që jeta pati plane të tjera për të. Përkundër sfidave, ajo vazhdoi t'i hapte vetes shtigje në art, ani pse në një medium krejt ndryshe. Larg pikturës, po lë gjurmë në artin e qeramikës.

Lokali i saj në Aktash është kthyer në një pikë të rëndësishme për trashëgiminë e qytetit. Është disa hapa larg Qendrës së Studentëve - konvikteve, ku Granita qëndroi gjatë studimeve, e ku tani zënë vend ëndrra të reja.

DHË është emri që i ka lënë dyqanit, ku marrin jetë punë të zanatit, i cili dikur ishte i zakonshëm, më pas mbeti trashëgimi, u harrua për një periudhë, por tash po jep shenja ringjalljeje dhe kthimi në trend. Poçarët e moçëm numërohen në gishta, por ata që i rreken artit në qeramikë – qoftë thjesht për dëfrim – po bëhen më të numërt thujse çdo ditë. Granita Grezda-Lila është në mesin e atyre që po e promovojnë këtë zanat me një frymë të re.



MODERNIZATION OF THE
TRADITIONAL: GRANITA
GREZDA – LILA

Art in pottery



Craftsmen of clay works have thousands of followers on social media, while artistic works made of clay are selling at staggering prices. Apparently this kind of art is experiencing once again the old glorious days. Even in Kosovo, it has sparked some interest. Young generations have undertaken baking clay crafts in ovens and engendering a new trend. Among them is Granita Grezda – Lila, whose shop has become a frequented venue for all those who appreciate clay art. She is animating an ancient tradition with fresh and modern touch.

Over the years, Prishtina has become a home for students who came from all over the country pursuing their studies. Many arrived with big dreams, and Granita Grezda-Lila was of them. She was originally pursuing her dream to excel as a painter, but life had reserved other plans for her. Instead of painting, she is marking her trails in the art of pottery

Her shop in Aktash has become a notable venue for the city's heritage. It is just some steps away from Student's Center (Dormitories), where Granita stayed during her studies, while now it hosts new dreams.

"DHË" (Albanian word for 'soil') is the name of her shop, where handcrafted works are brought to life. Once widespread, then almost reduced into a legacy, pottery art is now showing signs of revival and becoming

FOTO: ERMAL META

Punime dashnie

Dyqani i vogël i Granitës me xhamat e mëdhenj – prej të cilëve lehtësisht që nga larg mund të dallohen punimet e veçanta prej qeramikës – është atë joshës sa është e pamundur të mos ndalesh po kalove përgjatë rrugës Rexhep Mala.

Granita Grezda-Lila u lind në Gjakovë, erdhi në Prishtinë në vitin 1999 për të ndjekur studimet në Akademinë e Artit, në një kohë shumë të vështirë për Kosovën. E lehtë nuk ishte as periudha pas diplomimit në vitin 2003. Si shumë të rinj në vend, Granita hasi në vështirësi për të gjetur punë në fushën për të cilën studioi. Jeta si nënë e një djali dhe një vajze nuk i bënte më të lehta gjërat. Në rrethanat kur ishte gati t'i humbte shpresat, ajo gjeti dëshirën për të bërë diçka kreative, e që e çoi në zbulimin e botës së deltinës.

Pasioni iu ngjall kur nisi të shikonte video të atyre që më zotësi shndërrojnë copa balte në diçka të dobishme a vepër arti. Punimet e para, ani pse jo perfekte, ishin të punuara me shumë dashuri e përkushtim. Këto copa eksperimentuese, që i bëri më tepër për t'u qetësuar e relaksuar, ua dhuroi miqve e familjarëve. Ishin shprehje e re e artit që merrnin formë në shtëpi si kundërpërgjigje ndaj

trendy again. Pottery artisans are exiguously few, but now they are endorsing the pottery art – even for entertainment – and growing in numbers each day. Granita Grezda-Lila is among those who are promoting this craft with a new spirit.

Crafts Made with Love

Granita's small shop, with its large windows – through which are easily perceived beautiful pottery handcrafts – is so appealing that it's impossible not to stop if you chance to come upon Rexhep Mala Street.

Born in Gjakovë, Granita Grezda-Lila came to Prishtina in 1999 to pursue

monotonisë.

"E bëja për ta mbytur kohën", janë fjalët e Granitës kur evokon këto kohë.

Por, postimet në rrjete sociale e ndryshuan rrjedhën e gjërave. Interesimi e pëlqimet veç po rriteshin. Më 2019, pasioni e përkushtimi i saj u shpërblyen në një garë të organizuar nga UNDP-ja, ku u ekspozuan punime artizanale. Kjo fitore i dha vetëbesimin e nevojshëm për të hapur dyqanin e saj.

"Lidhja ime me artin më ka lehtësuar punën me qeramikë, prandaj nuk e kam pasur problem të krijoj punime, edhe pse ka teknika dhe materiale të shumta, por gradualisht i mësova edhe ato", thotë ajo.

Inspirim nga tradita

Granita e nis ditën duke e hapur furrën e pjekjes



her studies at the Academy of Arts, during a very troubled period for Kosovo. Even the time following her graduation in 2003 was not easy either. As many young people, Granita faced difficulties to find a job in her field. The things were not made easier by being a mother of a boy and a girl. At a point where she nearly lost all hope, she discovered an interest in devising something creative, leading

për të shikuar rezultatin e punës së saj. Realizimi i punimeve merr goxha kohë. Fillimisht ajo u jep formë pjatave, gotave, filxhanëve, mbajtëseve për çelësa, mbajtësve të qirinjve e punimeve të ndryshme që i bën me duart e saj. Të njëjtëve u duhen 2 deri në 3 javë për t'u tharë para se të marrin formën përfundimtare e të vendosen në furrë për herë të parë. Vetë procesi i pjekjes merr më shumë se 18 orë.

Pasi të jenë pjekur, ajo vë glazurë për t'i dhënë shkëlqim e për t'i bërë të përdorshme për ushqim. Tutje

her to the the world of clay.

Her passion was renewed when she watched videos of those artists who skillfully transformed pieces of mud into useful items or artworks. Her first crafts, though far from being perfect, were made with a lot of love and dedication. These experimental pieces, created as a form of relaxation, were given to friends and relatives. They were new expressions of art that took shape at home as a response to monotony.

"I did all these works to kill time", Granita says, while evoking those past times.

However, her posts in social media changed everything. Interest and likes steadily increased. In 2019, her passion and commitment were recognized in a competition held by UNDP, where her handcrafted works were shown. This triumph gave her the self-confidence she needed to open her shop.

"My bond with art made pottery work easier for me, which is why I didn't have much trouble creating crafts. Although there are many techniques and materials, I learned them gradually", she says.

Inspiration from Tradition

Granita commences her day by opening her pottery kiln to see the results of her work. Creating such handcrafts takes a lot of time. First, she shapes plates, cups, key holders,



pason faza e dytë e pjekjes. Me siguri që secili punim kërkon punë e kujdes të veçantë.

"Inspirim për mua janë motivet tona tradicionale, kryesisht prej qilimave të vjetër të punuar në vek", thotë Granita.

Por, ajo nuk ndalet me kaq. Muzë për të janë edhe gjetjet arkeologjike, si Hyjnesha në Fron, që tani është simbol i kryeqytetit. Ky simbol është veç një prej imazheve që mund të shihet i stampuar në veprat e saj. Ai vjen si dëshmi që punimet e Granitës nuk janë vetëm funksionale, por edhe artistike.

Shpesh punimet janë të krijuara enkas sipas teksteve a simboleve që klientët e saj i kërkojnë. Gjithmonë janë dhuratë e përkryer apo shtesë e mrekullueshme për shtëpi.

Arritjet e saj në artin e qeramikës janë dëshmi e kreativitetit dhe këmbënguljes për më mirë e më mirë. Ajo ka arritur të krijojë një brend që është i njohur edhe përtej Kosovës, duke pasur klientelë që është e ndarë thuajse në mënyrë të barabartë mes vendësve dhe të huajve.

"Komentet pozitive dhe lëvdatat për punën që bëj më kanë motivuar që të mos ndalem së krijuari", thotë ajo.

Çdo herë është në kërkim të disenjeve të reja. Ditëve të fundit ka punuar edhe një cikël të ri me motive nga deti. Ajo vazhdon të bëjë ende eksperimente teknikash, por tani me disenje, e ndonjëherë edhe me baltë me ngjyrë kur ndihet nevoja për të krijuar diçka më ndryshe, por pa ikur prej stilit të saj.

Rrëfimi i Granita Grezda-Lila është një rrëfim frymëzues, shembull se si pasioni mund të kthehet në një biznes të suksesshëm e artizania të përshtatet me modernen.

candle holders, and other handcraft items. These pieces require 2 to 3 weeks to dry before they take their final form. The baking process needs over 18 hours. Once baked, she applies glaze in order to give them brightness and make them usable items for food. Then it follows a second baking stage. Surely each handcrafted item requires special care and attention.

"My inspiration comes from our traditional motifs, mainly from old rugs produced on looms", Granita says. But her work is not confined here. A muse for her are archaeological findings, such as The Goddesses on the Throne, which now stands as the symbol of Prishtina. This symbol is one of the images that can be seen in many of her works. It accounts to the fact that Granita's handcrafts are not only functional, but even carry an artistic touch.

Often, her creations are made based on texts or symbols requested by her clients. Those handcrafts are perfect gifts or startling pieces for the home.

Her achievements in pottery art are a testament to her creativity and persistence. She succeeded in creating a brand that gained reputation far beyond Kosova, with clients being evenly made of **locals** and foreigners.

"Positive comments and praises for my work serve as motivation to keep creating", she says.

Hana is continuously searching for new designs. Recently, she has devised a new cycle with sea motifs. She keeps introducing technique experiments with designs, and from time to time even with colored clay when she wants to create something more different while staying true to her style. Granita Grezda-Lila is an inspiring story, a glaring example demonstrating how passion can be converted into a successful business, aligning traditional crafts with the modern world.

E ardhmja e rrobave të mençura

Teknologjitë veshëse dhe disenjet inovative të Hana Zeqës



Teknologjitë veshëse (wearable technology) janë trend në rritje në industrinë e modës. Qëllim kanë të transformojnë gardërobën tonë duke e mbushur me veshje që parimisht mund të bëjnë gjithçka prej monitorimit të shëndetit e deri të ndikimi në përmirësim të performancave të atletëve. Disenjatorët që po integrojnë teknologjinë në veshje, po tejkalojnë kufijtë tradicionalë të modës. Hana Zeqa, disenjatorja vizionare e Prishtinës, është në rend me revolucionarizuesit ndërkombëtarë të këtij trendi.

ALBERINA HAXHIJAJ

Viteve të fundit, teknologjitë veshëse po revolucionarizojnë industrinë e modës duke e gërshetuar stilin me funksionalitet. Disenjatorë në mbarë botën po e përvetësojnë këtë trend duke krijuar veshje që e tejkalojnë anën estetike. Është fjala

The Future of Smart Wearable Technology

Wearable technology and innovation designs
by Hana Zeqa

Wearable technology is an increasing trend in the fashion industry. Its goal is to transform our wardrobes with clothes that can literally do everything from health monitoring to improvement of athlete's performances. These designers who merge technology with fashion are indeed surpassing traditional boundaries. Hana Zeqa, a visionary designer from Prishtina, is on a par with those who are pushing forward this international fashion.

In recent years, wearable technology has revolutionized the fashion industry by introducing functionality alongside style. Designers from all around the world are embracing this very trend by devising clothing that goes far beyond the esthetic side. These are technological devices that either can be worn or integrated as accessories. These devices are capable of monitoring health and amplifying communication. Just to get a notion imagine a ring that lights once you receive an important message. Or, for that matter, a shirt that displays various messages. Thus the integration of technology into daily clothing is steadily becoming more sophisticated.

Hana Zeqa's designs align with the development of both fashion and technology. Her work lay stress on the potential of wearable technologies to inspire a new generation of local designers to explore new opportunities within what is being considered smart fashion.

për pajisje teknologjike që mund t'i vishni ose t'i integroni si aksesorë. Këto pajisje mund të monitorojnë shëndetin tuaj, t'ij ndihmojnë në komunikim. Për ta thjeshtësuar, mendoni sikur unaza juaj do të ndriçojë çdoherë kur pranoni një mesazh me rëndësi. ose këmisha juaj që u shfaq mesazhe të ndryshme. Integrimi i teknologjisë në veshjet e përditshme po bëhet gjithnjë e më i sofistikuar.

Në mes të gjithë këtij zhvillimi të modës dhe të teknologjisë, gjejnë vend edhe disenjet e realizuara nga Hana Zeqa. Edhe këtu këto dy fusha bashkëdyzohen. Disenjet e saj theksojnë potencialin që kanë teknologjitë veshëse për të inspiruar një gjeneratë të re të disenjatorëve në vend që të eksplorojë mundësi të reja brenda asaj që po konsiderohet si modë e mençur.

Pionerja e modës së mençur në Kosovë

Në Londër, Hana Zeqa për herë të parë u njoftua me mundësinë e integritit të teknologjisë. Në "London College of Fashion" përfundoi master-in për disenj të kostumeve, me fokus në hulumtimin e veshjeve interaktive dhe "wearable technology".

"Njoftimi me teknologjinë thjesht e ka hapur një horizont të mundësive për shprehjen e ideve të ndryshme, qoftë edhe abstrakte që ndoshta normalisht do të ishin të limituara me metodat standarde", thotë Hana.

Ajo thotë se pasi ka studiuar disenj të kostumeve – një fushë e gjerë që aplikohet në teatër, film, performancë, muzikës etj. – ka qenë e natyrshme një lidhje interesante dhe e gjerë për t'u hulumtuar. Kurse përtej modës, ishte edhe muzika - arsyeja që e kishte shtyrë drejt zgjedhjes së kësaj fushë për studim.

Për të, jo vetëm veshjet me te



A Pioneer of Smart Fashion in Kosova

It was in London where Hana Zeqa was first introduced to the possibility that technology could be well integrated into clothing. She completed her master's degree in costume design at the London College of Fashion, focusing on exploration of interactive clothing and wearable technology.

"Being introduced to technology opened up a horizon of opportunities to expound various ideas, even abstract ones that perhaps might be limited by standard methods", Hana explains.

She goes on to say that her studies in costume design – a vast field that applies in theater, movies, performances, music, and more – naturally led her to scrutinize an interesting link between them. In addition, the music was a further reason that paved the way in her decision to pursue this field.

According to Hana, not only wearable technologies but every design requires examination and embodiment of the core idea and purpose. However, when dealing with such designs, she endeavors to justify every element in a way that is both visually and conceptually meaningful. What emerges is a process that goes through some test stages ensuring that everything is in its right place and functional. However, the whole thing is not an easy task.

"This field is comparatively new and still developing, this is why it has limited resources in our country. By resources, I mean people, materials, devices, and so forth", she explains. The advantage of these designs, according to her, is that they are accomplished through teamwork.

Textile innovations

Hana has no background in the technology field, therefore she has to collaborate with experts to bring her ideas to life. "It's an awesome thing to learn from one another. We are a regular team within the design studio 'Fight or Flight', which I founded in 2018 envisaged with the intention of creating a cooperative space for similar projects. Even other members join in on every project we are engaged in", she emphasizes.

Work in her Prishtina-based studio conveys performances and collaborations with organizations such as Ars Electronica, Manifesta 14, Muzeu Bakhrushin



knologji, por secila veshje kërkon hulumtim dhe mishërim me idenë dhe qëllimin e atij disenji. Por kur punon me disenje të tilla, mundohet ta arsyetojë çdo element, në mënyrë që secili sish të ketë edhe kuptim vizual, por edhe konceptual. E pas kësaj vjen edhe realizmi që kalon nëpër disa faza testimi në mënyrë që çdo gjë të jetë në vendin e duhur dhe të jetë funksionale. Por jo gjithçka është e lehtë.

“Kjo është fushë relativisht e re dhe ende në zhvillim e sipër, prandaj ka resurse të limituara – e kam fjalën në Kosovë. Me resurse nënkuptoj, njerëzit, materialet, pajisjet, etj.”, tregon ajo. Por e mira e këtyre disenjeve, sipas saj, është se ato realizohen falë punës ekipore.

Inovacioni në tekstil

Hana nuk ka formim të mëherëshëm në fushën e teknologjisë, prandaj i duhet të punojë me ekspertë të kësaj fushe për të sjellë idetë e saj në jetë. “Është proces i këndshëm të mësojmë prej njëri-tjetrit. Në kuadër të studios së disenjit Fight or Flight, të cilën e kam themeluar në vitin 2018 - pikërisht që të jetë një hapësirë bashkëpunuese për projekte të tilla, jemi një ekip i rregullt, por,

po ashtu, angazhohen anëtarë të tjerë për çdo projekt që e realizojmë”, thekson ajo.

Puna në studion e saj në Prishtinë, përfshin paraqitje dhe bashkëpunime me Ars Electronica, Manifesta 14, Muzeu Bakhrushin Moske, H&M Gjermani, TEDxTirana, Phoebe Heess, Printfresh, Bunka Fashion College Toky dhe projektin Shkrepëtima nga Petrit Halilaj. Ajo, gjithashtu, ishte kostumografe e filmit Zgjoj nën regji të Blerta Bashollit dhe stiliste e disenjeve për shumë produksione televizive, filmike e teatrale.

Njëllon si të gjithë në industrinë e modës edhe Hana Zeqa është kureshtarë t'i shohë zhvillimet që do të bëhen në aspektin e tekstilit dhe të teknologjisë. Për të, është një

Moske, H&M Gjermani, TEDxTirana, Phoebe Heess, Printfresh, Bunka Fashion College Toky and Petrit Halilaj's project “Shkrepëtima”. She is also the costume designer for the movie “Hive”, directed by Blerta Basholli, and a design stylist for many TV, movie, and theatrical productions.

As with the overall fashion industry, Hana is curious to see the new advancements in textile technologies. It is a field that provides for her more space for exploration and innovative ideas. It's something promising that is constantly developing.

“Even though it requires still time to be integrated into the market for selling, I believe that the greatest benefits of wearable technologies are especially for health monitoring, but also for adding functionality to clothing and making daily life easier”, she explains. Filled with enthusiasm,

fushë që ka shumë hapësirë për hulumtime dhe për ide inovative. Diçka premtuese që vazhdimisht po zhvillohet.

“Edhe pse i duhet ende kohë të integrohet më shumë në treg për blerje, mendoj që përfitimet më të mëdha të përdorimit të teknologjisë në veshje janë sidomos për monitorimin e shëndetit, duke i shtuar funksion veshjes dhe lehtësim të përditshmërisë përmes asaj veshje”, thotë ajo. E entuziazmuar thotë se imagjini këto veshje si “rroba të

Hana invites us to conjure up of these clothing as “smart clothes”, much in the same vain as other technological devices or smartphones.

Creative Freedom

“Fight or Flight” studio has become a space in Prishtina where creativity is freely expressed. All the members are free to retain their identity and their inner worlds. Hana holds that creative work in this field should have no limits or outside influences, such as micro-trends. In her studio, they are exploring and designing new clothing. Now, they are working on a new project.

“Currently, we are researching the development of biotextiles through food products”, Hana explains.

Beside these innovative projects, that are research-based, they are also developing a commercial component, designing clothes for their online shop. They often participate in various movie and TV projects. In such cases, they do not use technologies for their designs.

“I believe that not only my work, our work, but every other work that provides diversity to Kosova's

mençura", njëlloj si pajisjet e tjera teknologjike e telefonat e mençur të këtyre ditëve.

Liria kreative

Studioja Fight or Flight është shndërruar në një hapësirë në kryeqytet ku kreativiteti mund të shprehet lirshëm. Të gjithë janë të lirë t'i qëndrojnë besnikë identitetit dhe botës së tyre. Hana thekson se puna kreative e kësaj fushe nuk duhet të ketë limite dhe ndikime të jashtme nga çkado, qofshin edhe mikrotrende. Brenda studios vazhdimisht hulumtojnë e konceptojnë veshje. Gjatë kësaj kohë i janë përveshur punës për një projekt të ri.

"Momentalisht jemi duke hulumtuar zhvillimin e biotekstilitit përmes produkteve ushqimore", tregon Hana.

Por, krahas këtyre projekteve inovative që kanë bazë hulumtuese, në studio zhvillojnë edhe segmentin komercial, ku realizojnë veshje për dyqanin e tyre online. Shpesh janë edhe pjesë e projekteve të ndryshme filmike e televizive. Në të dy këto rastet për disenjet e tyre nuk përdorin teknologji.

"Mendoj që jo vetëm puna ime, jona, por çdo punë tjetër që krijon llojllojshmëri në tregun e Kosovës dhe del prej shabllonit të asaj çka jemi mësuar të shohim, është mundësi e mirë për ta krijuar një pasqyrë më të mirë të rinisë apo kulturës së Kosovës, ku në të njëjtën kohë është mundësi e mirë për edukimin e masës në përkrahjen e krijuesve vendorë", thotë Hana e cila ligjëron teknologjinë e modës dhe qëndrueshmërinë në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë.

Disenjet e Hana Zeqës, kanë rëndësi të veçantë për Kosovën, si vend që nuk njihet për përdorim të modës së mençur. Duke i vënë teknologjitë veshëse në pah, ajo po ndikon në zhvillim e kësaj fushe në vend dhe po inspiron gjeneratat e reja të disenjatorëve që të vazhdojnë e të hulumtojnë bashkëdyzimin e modës dhe të teknologjisë.

"Lexoni dhe hulumtoni sa më shumë, ëndërroni dhe ushqejeni kuriozitetin me mundësi të pafundme që i ofron kjo fushë", thotë ajo.

Suksesi i saj shërben si testament për potencialin kreative brenda Kosova. Bashkëpunimet e arritjet e saj e kanë bërë të njohur edhe në arenën ndërkombëtare dhe, gjersa teknologjitë veshëse vazhdojnë të evoluojnë, Hana vazhdon të jetë shtegshënuese duke demonstruar se si inovacioni mund të ridefinojë të ardhmen e modës. Puna e saj jo vetëm që e vendos Kosovën brenda hartës së këtij zhvillimi kreativ e inovativ, por gjithashtu vendos standarde të reja se për arritjet në botën moderne të disenjit.



market and transcends the common template, is a good opportunity to better understand young people and the culture in Kosovo. It is also a good opportunity to educate people to support local creators", says Hana, who lectures on fashion technology and sustainability at the University for Business and Technology (UBT) in Prishtina.

Hana's designs are of special importance for Kosovo, a country that does not have any reputation for using smart fashion. By highlighting wearable technologies, she strives to develop this field and inspire new generations of designers to keep their work in merging fashion and technology.

"Read and explore as much as possible, dream, and feed your curiosity with infinite opportunities this field provides", she emphasizes.

Her success is a testament to the creative potential that is encapsulated in Kosovo. Her collaborations and achievements have gained her reputation abroad. As wearable technologies are continuously evolving, Hana is a trail marker, showcasing that innovation can redefine the future of fashion. Her work not only puts Kosovo on the map of creative and innovative development but also sets new standards for what can be achieved in the modern world of design.

PaperHouse - gërshtetimi i muzikës dhe artit në një vend

Bazuar në ngjarje të vërtetë, nuk është vetëm motoja aktuale e PaperHouse-it. Nëse fokusohemi në historinë mbrapa kësaj fjalie, kthehemi në qytetin magjepsës të Londrës, vendi ku nisi krijimi i Paper-it, i cili më vonë do të ishte vendi ku bëhen bashkë radio, galeria dhe komunikimi.



Paper House: The Fusion of Music and Art in One Place

Based on true story, this isn't just the current motto of Paper House. If we focus on the story behind this phrase, we return to the enchanting city of London, where the creation of Paper began.

ERLETË RRUSTEMI

Forma e komunikimit me audiencën filloi të realizohej me kreativitet, muzikë, art pamor dhe gjithëpërfshirje. Misioni ishte ky: edhe atëherë kur të ndalojmë së krijuari do të jenë punët tona të dikurshme që do të flasin për ne.

Rrugëtimi i Paper-it fillon që nga viti 2009, si agjensioni i parë i komunikimit në Kosovë, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë.

Çdo koncept apo reklamë e prodhuar nga Paper-i, kishte brenda motive shqiptare, të cilat e kanë sjell një formë të re të krijimit, ndryshe nga ajo që ishte dikur në industrinë e marketingut.

Në dhjetor të vitit 2020, ëndrra e dikurshme e një fëmije për të funksionalizuar një radio, e cila do bënte gërshtetimin e informacionit dhe muzikës më të mirë në një frekuencë, u shndërrua në realitet. Një vend, i pari i këtij lloji në kryeqytet dhe Kosovë, që posedonte radio dhe galeri në një vend.

Maratona që zgjat çdo ditë

Tash Paper-i kishte rritur ndikimin e tij me një gjuhë tjetër të komunikimit, atë valore. Me frekuencë regjionale, Paper-i arriti të edukojë një audiencë së pari me muzikën e mirëfilltë, pastaj edhe me vepra artistike që ngrenë vetëdijesimin për tema shoqërore dhe kulturore.

Paper, which later in time would become a place where radio, gallery, and communication converge. The form of communicating with the audience started to be realized with creativity, music, visual art, and inclusivity. The mission was clear: even when we stop creating, our past works will speak for us.

The journey of Paper started in 2009, as the first communication agency in Kosovo, right after the declaration of independence. Every concept or advertisement produced by Paper contained Albanian motifs, bringing a new form of creation different from what was previously seen in the marketing industry.

In December 2020, a child's dream of operating a radio that would blend the best information and music into one frequency became a reality. A place, the first of its kind in the capital and Kosovo, that housed both a radio station and a gallery in one location.

A Daily Marathon

Now, Paper had expanded its influence with another form of communication, that of radio waves. With a regional frequency, Paper managed to educate an audience first with quality music and then with artistic works that raise awareness of social and cultural issues.



Për frekuencën 91.1 FM vetëm një gjë kishte rëndësi: dëgjuesi. Dëgjuesi që zgjedh të bashkohet në mëngjes për t'i dëgjuar më të rejtat. Që ka dëshirë të dëgjojë një fakt interesant nga emisioni i kulturës. Që dëshiron të dijë pak më saktë rreth situatës në vend. Ai dëgjuesi që ka qejf që kolona nga Veterniku deri te Katedralja të duket se ecën për dy minuta. E tëra për maratonën e cila zgjat çdo ditë.

15 emisione aktuale të projektuara për dëgjuesin, që të zhytet në historitë e mbajtura brenda, dhe të bëhet një me emocionet që prodhojnë moderatorët e radios.

Teksa simboli më unik dhe i vetmi i tillë në mediet tona mbetet PAPER TOP 40, lista unike që grumbullon këngët më të popullarizuara në botë duke u përditësuar çdo javë.

Vlen të theksohet që hapësira për komunitetet joshumicë në Kosovë, ka ekzistuar në Paper që nga themelimi, si në formatet e shkruara, ashtu edhe në atë të dëgjuar. Tash e tre vjet, në Paper Radio promovohet edhe kultura e komunitetit turk përmes emisionit Geveze-Llafazan me moderatorin TeomanGlloboder. Kjo e bën Paper-in të vetmin medium privat me emision për komunitetet joshumicë dhe kjo nuk është e vetmja. Në një të ardhme të afërt Paper-i do të krijojë hapësira informuese edhe për komunitetet e tjera që do ta kenë mundësinë të informohen në gjuhën që ato flasin.

Magjia e radios nuk ndalet këtu. Në blogun e PaperHouse do të gjeni një thesar me artikuj që hedhin dritë mbi kulturën tonë, mbi artin, profilet e artistëve dhe çdo risi rreth Prishtinës.

**Me art për të nxitur mendimin,
zhvendosur idenë e traditës
e për të inkurajuar risi**

Në anën tjetër të Paper-it kurohet çdo vepër arti deri në detaje. Pra, në PaperGallery aty ku e ka edhe vendin.

For the 91.1 FM frequency, only one thing mattered: the listener. The listener who chooses to join in the morning to hear the latest news, who enjoys hearing an interesting fact from the culture show, who wants a better understanding of the local situation. That listener who feels like the traffic from Veterniku to the Cathedral moves in just two minutes, all for the daily marathon.



There are 15 current shows designed for the listener to dive into the stories within and become one with the emotions released by the radio hosts. The most unique and singular symbol in our media remains the PAPER TOP 40, a unique list that gathers the most popular songs worldwide, updated weekly.

It is worth noting that the space for minority communities in Kosovo has been present at Paper since its inception, both in written and audio formats.

For the past three years, Paper Radio has also promoted the culture of the Turkish community through the show Geveze-Llafazan with host TeomanGlloboder. This makes Paper the only private medium with a show for minority communities, and this is not the only one. In the near future, Paper will create informative spaces for other communities, allowing them to get informed in their own languages.

The magic of radio doesn't stop here. On the Paper House blog, you will find a treasure of articles shedding light on our culture, art, artist profiles, and all the latest about Prishtina.

Art to Stimulate Thought, Shift Tradition, and Encourage Innovation

On the other side of Paper, every artwork is curated down to the details, precisely in Paper Gallery, where it belongs.

Paper Gallery is an exhibition space that aims to highlight contemporary artists and curators, both locally and internationally. The gallery's location in the heart of Prishtina brings a fresh breath for Kosovo, stimulating thought, shifting the idea of tradition, and encouraging innovation in all dimensions and forms of art.

The gallery was created just before the lockdown due to the COVID-19 pandemic. Paper Gallery started as a memory, and no one thought it would create the impact it has today in the capital. To date, more than 35 exhibitions have been





PaperGallery është një hapësirë ekspozuese që synon të nxjerrë në pah artistët dhe kuratorët bashkëkohorë, në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Lokacioni i galerisë është në zemër të Prishtinës, një frymë e freskët për Kosovën që nxit mendimin, zhvendos idenë e traditës dhe inkurajon risi në të gjitha dimensionet dhe format e artit.

Galeria u krijua pak para mbylljes së përkohshme, si pasojë e pandemisë COVID-19. PaperGallery filloi si kujtim dhe askush nuk mendoi që do të krijonte ndikimin që sot ka në kryeqytet. Deri më sot, në Paper-i janë shfaqur më shumë se 35 ekspozita, ku secila ka pasur peshën e vet.

Disa me emocione personale, disa me qëllim informues e disa me qëllim vetëdijesues e si total të gjitha janë bërë për të qëndruar të shkruara në letër-paper.

Deri sot janë shfaqur ekspozita arti që thellohen në pyetjet dhe emocionet turbulluese që përshkojnë jetën tonë të përditshme.

Ekspozita që kanë ftuar vizituesit në udhëtime introspektive, duke i inkurajuar ata të përballen dhe të reflektojnë mbi pasiguritë dhe kompleksitetin që përcaktojnë ekzistencën njerëzore.

Ekspozita me pyetje enigmatike dhe shpesh pa përgjigje, me të cilat përballen individët në përvojat e tyre të përditshme.

Ekspozita që synonin të ndezin soditje dhe dialog rreth natyrës së njohurive, perceptimit dhe reagimit emocional.

Ekspozita që eksploruan një sërë çështjesh personale dhe shoqërore.

Ja edhe disa emra të aktiviteteteve dhe ekspozitave që u shfaqën në Paper:

- Kashta e Kumtrit ARTAN HAJRULLAHU
- Looking in Looking out, Chuck Blue Lowry (UK)
- Camera Isolata, Naho Kawabe (Japan)
- RETROSPEKTIVE Nysret Salihamixhiqi
- Hang on Hang out (studio e hapur) Arbnor Karaliti, Lumturie Krasniqi, Yll Xhaferi
- NOISE POLLUTION
- Studio e Hapur (Valdrin Thaqi Bler-ta Hashani)
- Reporting House (Anri Sala, Adrian Paci, Olafur Eliasson, Zhanna Kadyrova, Lana Cmajcanin, Goncalo Mabunda, Lala Meredith Vula, Vullnet Jakupi, Vita Kasapolli) DHE 150 storie televizive të raportuara nga mediat ndërkombëtare. PaperHouse është vlerë e shtuar e komunitetit tonë, një domosdoshmëri e kryeqytetit që reflekton mbi temat që përkufizojnë artin, medien dhe komunikimin.

Vizitoheni këtë vend për ta ndier e për ta përkur atë që lexuat.

showcased at Paper, each with its own significance.

Some with personal emotions, some with informative purposes, and some with awareness-raising goals, all created to be written on paper.

To date, art exhibitions have delved into the questions and turbulent emotions that permeate our daily lives.

Exhibitions that invited visitors on introspective journeys, encouraging them to confront and reflect on the uncertainties and complexities that define human existence.

Exhibitions with enigmatic questions, often without answers, that individuals face in their daily experiences.

Exhibitions aimed at igniting contemplation and dialogue about the nature of knowledge, perception, and emotional response.

Exhibitions that explored a range of personal and social issues.

Here are some names of activities and exhibitions showcased at Paper:

- Kashta e Kumtrit: By artist Artan Hajrullahu, with a traditional approach
- Looking in Looking out, Chuck Blue Lowry (UK)
- Camera Isolata, Naho Kawabe (Japan)
- RETROSPEKTIVE Nysret Salihamixhiqi
- Hang on Hang out (open studio) Arbnor Karaliti, Lumturie Krasniqi, Yll Xhaferi
- NOISE POLLUTION
- Open Studio (Valdrin Thaqi Bler-ta Hashani)
- Reporting House (Anri Sala, Adrian Paci, Olafur Eliasson, Zhanna Kadyrova, Lana Cmajcanin, Goncalo Mabunda, Lala Meredith Vula, Vullnet Jakupi, Vita Kasapolli) and 150 tv stories reported by the international media. Paper House is an added value to our community, a necessity for the capital that reflects on the themes defining art, media, and communication.

Visit this place to feel and touch what you just read.



FOTO: ARBEN HOTI

Lule të bukura ka Prishtina

Lulet janë sharmi i Prishtinës. Në shesh e në skaje të ndryshme të qytetit gjenden dyqane që kultivojnë dhe shesin lule, në mënyrë që rastet e veçanta të gëzimit të shënohen me dashuri e respekt. Lulet janë gjithmonë zgjidhje e duhur për këtë. Ato i shtojnë jetë dhe freski gëzimit tonë.





Prishtina's Beautiful Flowers

The flowers are Prishtina's charm. Both in the main square and other venues, there are shops that cultivate and sell flowers, so special joyous moments can be remembered with love and respect.



Blerta Bërveniku: Vrapuesja e Prishtinës

Runner of Prishtina



ARTAN KRASNIQI

“Vrapi për mua është shndërruar në një shkollë për jetën dhe mendoj që përmes vrapit jam bërë një version më i mirë i vetes

Blerta Bërveniku është shembulli i një gruaje që menaxhon në mënyrë të përkryer punën dhe pasionet e saj. Krahas punës së përditshme me teknologjinë e informacionit, ajo vrapon çdo mëngjes, pikturon dhe ka një parajsë me bimë, për të cilat kujdeset vazhdimisht.

Për Gërminë, që shumëkush e quan “mushkëritë e Prishtinës”, thotë se është pasuri dhe bekim.

Blerta, vrapin thotë se e kishte nisur e nxitur nga ideja për ta njohur më mirë natyrën. Por tash, thotë se i është shndërruar në shkollë për veten.

“Arsyet pse vrapoj kanë ndryshuar përgjatë kohës. Kur kam filluar të vrapoj, më së shumti më ka tërhequr natyra. Kam bërë diçka të mirë për trupin dhe gjatë procesit i kam shijuar bukuritë e natyrës: formën e gjetheve, rrënjët e drurëve mbi tokë (për të cilat bëhesh shumë vigjilente, meqenëse gjatë vrapit vëzhgon në çdo hap), aromën e bimëve, e shumë stimuj të tjerë, të cilët na mungojnë në përditshmëri”, thotë Blerta.

Por me kalimin e kohës, vrapit asaj i është bërë një prej kënaqësive dhe boshteve kyçe të jetës. Thotë se është e çuditshme, se si një veprim aq i thjeshtë i vendosjes së një hapi pas tjetrit mund të na mësojë aq shumë për veten.

“Running has become a life lesson, and I believe it has helped me become a better version of myself

Blerta Bërveniku is an example of a woman who perfectly balances her work with her passions. Beside her daily job in information technology, she runs every morning, paints and tends to a garden full of plants for which she constantly take care of them, creating her own little paradise.

When speaking of Gërmia, often hailed by many as “the lungs of Prishtina”, she concurs by calling it both asset and blessing. Blerta explains that she commenced running driven by the idea to connect more with nature. But now running has become a personal school for her.

“My reasons for running have changed over time. When I started, I was mainly driven by the nature. I did something beneficial for my body while enjoying the beauty of nature: the shapes of leaves, the roots of trees (which you become more familiar with as you notice every step while running), the fragrances of the trees, and many other stimuli that are absent in our daily lives,” says Blerta.

As time went by, running became one of the main pleasures of her life. She ponders on how it feels strange that such

“Vrapi të bën të merresh me veten, ta dëgjosh frymëmarrjen tënde, të jesh e vëmendshme për të rrahurat e zemrës, për atë se si po ndihesh. Të bën ta njohësh veten, t’i kuptosh faktorët që ndikojnë në performancën tënde. Të bën më të mirë në vendimmarrje, në menaxhim të burimeve të energjisë (qoftë fizike, ashtu edhe mentale), meqenëse distancat, të cilat i vrapojmë unë dhe shoqëria ime janë tejtejt të gjata për t’u menaxhuar vetëm me qëndrueshmëri fizike”, thotë Blerta, teksa shton një gjë shumë interesante - “Vrapi për mua është shndërruar në një shkollë për jetën dhe mendoj që përmes vrapit, jam bërë një version më i mirë i vetes”.

Grupi me të cilin vrapon çdo mëngjes Blerta Bërveniku quhet KTRA. Natyrshëm që ata janë bërë si një familje. Një familje e dytë për secilin anëtar. Të gjithë së bashku, e nisin vrapin çdo ditë në Gërmia, në orën 5:40. Blerta ka ca fjalë për atë që ofron Gërmia dhe lidhjen që ajo ka krijuar me këtë hapësirë.

“Gërmia është pasuria jonë dhe jemi të bekuar që kemi shtigje aq lehtë të qasshme, me një llojllojshmëri të vështirësisë së terreneve, të cilat mund të shijohen qoftë nga vrapues fillestarë, të pasionuar apo edhe nga ata elitare”, thotë Blerta.

Ajo nënvizon faktin se Gërmia është e vrapueshme në çdo stinë.

“Kjo na bën që çdo mëngjes, në 365 ditë të vitit, anëtarët e KTRA-së (Kosova Trail Running Association), të fillojnë vrapin në orën 5:40. Grupi është bërë si familje e dytë për të gjithë ne dhe shoqëritë që kemi krijuar, duke përjetuar bashkë të mira e sfida të ndryshme, tashmë janë shumë më të rëndësishme në jetën tonë, sesa thjesht të qenët bashkëvrapues. Sidomos për ne që garojmë në distanca të gjata, 100 km+, një ndër vendimet më të rëndësishme është zgjedhja e shoqërisë, pra me kë vendosim t’i ndajmë mbi 20-30 orë vrap”, thotë ajo.



a simple action—taking one step after another—can teach us so much about ourselves.

“Running makes it possible to cope with yourself, to hear your breath, to be attentive to your heartbeats, and to understand the way you feel. It helps you know yourself and understand the factors that affect your

performance. It improves your decision-making and managing your energy sources (whether physical or mental), as the distances my friends and I run are fairly long and require more than just physical endurance”, says Blerta, adding an interesting point.

“Running has become a life lesson, and I believe it has helped

Grupi merr pjesë në gara ultramaratonë, gjegjësisht, distanca më të gjata se maratona e plotë 42.195 km. Gara e parë e një niveli të tillë për Blertën ka qenë 107 km me 5000 metra ngjitje, në Ohër, të cilën e ka përfunduar për 25 orë. "Kjo mbetet një ndër përjetimet më kuptimplotë të jetës time. Fakti që unë si një person i zakonshëm, pa ndonjë të kaluar sportive, mund t'i bëj ballë një sfide të tillë, ma ka ndryshuar perceptimin e kufijve, të asaj se çka mund të bëjë një njeri. Distancat e tilla sfidojnë qëndrueshmërinë njerëzore. Ne që kemi arritur ta mposhtim dhimbjen, pagjumësinë, reaksionet e ndryshme që ndodhin në trupin dhe mendjen e njeriut përgjatë garës, dhe të fokusohemi në çdo hap, të jemi të pranishëm në atë çast, në atë frymëmarrje, në atë rrahje zemre, e kemi kuptuar se sa shumë jetë e forcë ka brenda nesh", thotë Blerta, teksa shton se kjo do të mbetej tërësisht e panjohur po që se nuk do të ishin sfidat, gjatë të cilat njerëzit shtyjnë kufijtë personalë. mNga garat ndërkombëtare të tjera të Blertës, mund të veçohen edhe Istria në Kroaci, 111km/4110m ngjitje dhe Lavaredo në Itali, 50km/2570m ngjitje. "Istria ka qenë distanca më e gjatë që kam bërë ndonjëherë ndërsa Lavaredo, shtegu më i bukur dhe teknikisht më i vështiri", thotë ajo. Tani, grupi po bëhet gati për UTMB në Francë, një garë tejet teknike dhe e vështirë, të cilën e ëndërrojnë vrapuesit malorë nga e tërë bota. Nëntë vrapues nga Kosova presin ta përfundojnë atë këtë vit. Në fund, Blerta bën një ndërlidhje në mes të profesionit, vrapit dhe dy pasioneve të tjera të saj - pikturës dhe kujdesit për bimët - "secila më bën të përjetoj diçka të cilën nuk e kam përjetuar më herët, ma pasurojnë botën time, më sfidojnë, më inspirojnë, më bëjnë të takoj njerëz të ndryshëm, me të cilët ndoshta nuk do të isha takuar po që se nuk do të ishin këto pasione", përfundon Blerta.

me become a better version of myself".

The group with whom Blerta runs every morning is called "KTRA" (Kosova Trail Running Association). Naturally, they have become like a second family for each member. Together, they start running in Gërmia at 5:40 in the morning. Blerta speaks concisely about what Gërmia offers and the bond she has formed with this area.

"Gërmia is our rich resource, and we are blessed that we have roads that are so easily assessable, with a variety of terrain difficulties that can be enjoyed by amateur, passionate, and elite runners", says Blerta.

She emphasizes that Gërmia is suitable for running in every season.

"This makes every morning, for 365 days a year, members of KTRA start running at 5:40. The group has become a second family for each of us and the friendship forged through shared experiences, good moments, and various challenges are more than just running together. This is especially true for those of us that participate in long-distances races, 100 km or more. And one of the most important decisions on these journeys is choosing the friends with whom we share more than 20-30 hours running", she says.

The group participates in ultra-marathon competitions, namely distances that are longer than a full marathon which is 42.195 km. Blerta's first competition in such a level was a 107 km race with 5000 m ascent in Ohrid, which she finished in 25 hours.

"This remains as one of the most meaningful experiences of my life. The fact that I, as an ordinary person

without any sports background, was able to withstand such a challenge changed my perception of boundaries and what a human is able to achieve. Such distances test human endurance. Those of us who succeeded in overcoming pain, insomnia, and the various reactions that take place in human's mind and body during the competition, while maintaining focus on every step and being present in every moment of breath and heartbeat, have realized how much life and vigor resides within us", says Blerta, adding that these perspectives would be altogether unknown if there were no challenges through which people push their personal boundaries.

Other international competitions Blerta partook was that of the Istria race in Croatia (111 km with a 4110m ascent) and the Lavaredo in Italy (50 km with a 2570m ascent).

"Istria was the longest distance I ever ran, while Lavaredo was the most beautiful road and technically the most difficult one", she says.

Now, the group is preparing to partake in UTMB in France, a very technical and strenuous competition, which is yearned from mountain runners from around the world. This year, nine runners from Kosova are about to take part there.

Lastly, Blerta makes a connection between her profession, running, and her two other passions, painting and tending to plants.

"Each one of them makes me experience something that I have not experienced before. They enrich my world, challenge me, inspire me, and give me the opportunity to meet different people that perhaps I would never met without these passions", says Blerta.

Aplikacioni “Kultura”, pikëtakim virtual për dashamirët e kulturës

‘Kultura App’ – The First Virtual Venue for Culture Aficionados



Që prej pandemisë, Kosova shënoi një rekord të papëlqyeshëm për sa i përket gazetarisë së shkruar. Është i vetmi vend në rajon që aktualisht nuk ka asnjë gazetë të shtypur, çka prej kohësh është përjetuar si prospekt i zymtë. Nga kjo ka pësuar edhe komuniteti i kulturës në vend.

Por, një nismë e re synon të prioritetizojë kulturën. Me aplikacionin “Kultura” është menduar që ndjekësve të ngjarjeve kulturore, veçmas atyre në kryeqytet, t’iu ofrohet një mundësi që lehtësisht të gjejnë informacionet më të reja nga kultura dhe ngjarjet kulturore që po mbahen kudo në vend.

“Kultura” është aplikacioni i parë kushtuar kulturës në vend. Me dizajnin e thjeshtë dhe me veçantitë e tij gjithëpërfshirëse, “Kultura” është një mjet i nevojshëm për secilin që ka interese mbi jetën dhe zhvillimet kulturore. E veçanta e këtij aplikacioni, i shkarkueshëm në çdo pajisje, është fakti se bartësit e organizimeve kulturore dhe publiku bëhen njësoj hisedarë në krijimin e lajmeve dhe vendosjen e ngjarjeve në kalendarin kulturor.

Aplikacioni ka disa opsione, ku secili ka nga një rol dhe qëllim të ndryshëm. Kështu, “Faqja Kryesore” është ideuar si një mënyrë e shpejtë dhe e thjeshtë për t’i qasur përmbajtjet më të rëndësishme dhe të rejat më të fundit. Opsioni tjetër është “Kalendari”, i cili i lejon përdoruesit të shfletojnë dhe të kërkojnë për ngjarje kulturore që po ndodhin në zonën e tyre. Opsioni i tretë, mbase ai që i jep identitet aplikacionit, është “Shto ngjarje”. Ky seksion është i projektuar për organizatorët e ngjarjeve dhe individë që duan të promovojnë ngjarje kulturore.

Zbatimi i suksesshëm i projektit për aplikacionin “Kultura” u bë falë ndihmës së dhënë nga Komuna e Prishtinës, dhe lansimi i tij pritet të bëhet së shpejti.

Since the pandemic, Kosovo marked a rather unpleasant record concerning written journalism. It is the only country in the entire region without newspapers, a situation often bewailed as a gloomy prospect. The cultural community has borne the brunt of this situation.

However, a new initiative aims to prioritize culture. Application ‘Kultura’ is thought to offer culture aficionados, especially those in Prishtina, an opportunity to easily access the latest cultural news and events happening in the country.

‘Kultura’ is the first application dedicated to culture. With its simple design and comprehensive features, ‘Kultura’ is a necessary tool for everyone interested in cultural life. The unique aspect of this application, which is downloadable on any device, is that both event organizers and the public evenly participate in creating news and placing them in the cultural calendar.

The app has several options, each of them with a distinct role and purpose. “The Main Page” is



envisaged as a quick and simple way to access the most important content and recent news. The next option is “Calendar”, allowing users to browse and search for cultural events in their area. The third option, perhaps the one that gives this app its identity, is “Add Events”. This section is designed for event organizers and individuals who want to promote cultural events.

The successful implementation of the ‘Kultura’ project has been made possible with support from the Municipality of Prishtina, and its launch will be soon.

Me botën butësisht të egër të Gërmisë

Parku nacional i Gërmisë është shtëpia e një mrekullie të llojllojshme e botës së egër. Albert Krasniqi është një prej fotografëve që pasionin për të eksploruar nëpër botën shtazore të Gërmisë e ka kthyer në detyrim ndaj vetes. Së fundi ka botuar një libër, që përmbledh shumë nga ky diversitet i çmuar në kryeqytet. Gërmia – Bota e egër titullohet libri. Alberti ka ndarë për PrishtinArt disa nga fotografitë dhe përshkrimet e zogjve që, ndër vite, ka arritur t'i fotografojë në Gërmi.

FOTOGRAFITË DHE TEKSTI: ALBERT KRASNIQI

Dallëndyshja e natës

(*Caprimulgus europaeus*)



Zog nate me penda të sipërme gri-kafe me vija të errëta. Me krahë gri me njolla të zbehta, kurse pjesët e poshtme janë gri-kafe, me njolla kafe të zbehta, që e bën tepër të vështirë për t'u parë gjatë ditës kur pushon në tokë ose ulet në degët e pemëve.

Tepër i vështirë për fotografim. Ushqehet me insekte dhe flutura nate, të cilat i kap në fluturim. Është shtegtues dhe dimëron në Afrikën e jugut. Qëndron kryesisht nëpyje gjethegjera dhe zona të hapura. Inkubon 1-2 herë në vit. Nuk ndërton fole dhe dy vezët e tij gri dhe kafe me njolla vendosen drejtpërdrejt në tokë. Ka një gjatësi të trupit prej 24-28 cm, kursegjatësia të hapjessë krahëve - 52-59 cm. Dallëndyshen e natës nuk kemi arritur ta shohim në park, por këndimi i saj dëgjohet gjatë natës në shumë pjesë të parkut.

Qukapiku i zi

(*Dryocopus martius*)



Qukapiku i zi është qukapiku më i madh që jeton në Evropë dhe në Azi. Penda e këtij qukapiku me madhësi sorreështë tërësisht e zezë, përveç një kurore të kuqe. Tek meshkujt, e gjithë kurora është e kuqe, por tek femrat vetëm pjesa e pasme e sipërme është e kuqe, me pjesën tjetër të trupit krejt të zezë. Ka hyrë në listën e kuqe si specie e rrezikuar nga IUCN. Rri në

pyje të vjetra gjethegjera, halore dhe të përziera. Gjatë dimrit zbret në zona të ulëta. Shihet edhe në zona urbane. Nuk shtegton. Ha insektet dhe larvat e tyre, krimba, por edhe fara frutash. Folezon në zgavra dhe vrma pemësh që

i hap vetë. Zgavra e tij është disa herë më e madhe sesa e qukapikëve të tjerë. Inkubon një herë në vit. Ka gjatësi të turpit rreth 45-65, kursegjatësia e hapjes së krahëve është 64-84 cm. Qukapiku i zi shihet thua se në të gjithë parkun, e më së shumti në pyjet e ahut dhe bungut.

Bletëngrënësi evropian

(*Merops apiaster*)



Bletëngrënësi evropian, është një zog truphollë dhe shumëngjyrësh. Ka pjesë të sipërme kafe dhe të verdhë, ndërsa krahët i ka të gjelbër, kurse sqepi e katë zi. Fyt të verdhë që ndahet nga gjoksi dhe

barku blu. Është ndër shpendët më të bukur në Evropë. Megjithë reputacionin e keq që herë pas here sulmon kosheret e bletëve, ndikimi i tij në popullatën e bletëve punëtore shtëpiake në zonat ku jeton është më pak se 1%. Jeton në zona të hapura malore, livadhe, afër lumenjsh dhe afër tokave bujqësore. Në Gërmi shihet në shumë zona. Një koloni me rreth 5 çifte janë në hyrje të parkut në pjesën e pishave ku kanë foletë në zgavrat e një pjese të pjerrët. Folezon në zgavra në formë tuneli që i hap vetë në zona argjilore. Përveç me bletët e malit, ushqehet në fluturim edhe me pilivesa dhe grerëza. Gjatësia e trupit të tij është rreth 25-29, kursegjatësia e hapjes së krahëve është deri në 36-40.

Bufi veshgjatë

(*Asio otus*)



Bufi veshgjatë është grabitqar nate me madhësi mesatare. Puplat i ka ngjyrë kafe me vija vertikale përgjatë gjoksit dhe barkut. Karakteristikë janë veshët e gjatë, që, natyrisht,

In the Gently Untamed World of Gërmia

The National Park of Gërmia houses a sundry miracle of wildlife. Albert Krasniqi is one of the photographers who has rendered his passion for exploring the animal world of Gërmia into an obligation for himself. His recent book conveys much of this rich diversity in the capital of Kosova. “Gërmia – Wild World” is the title of the book. Albert shared with PrishtinArt some of his photos and bird descriptions that he has been able to capture in Gërmia over the years.

European nightjar (*Caprimulguseuropaeus*)



A nocturnal bird with upper gray-brown feathers dotted with dark lines. Its wings are gray with pale spots, and the lower parts are gray-brown with pale brown dots that renders very difficult to observe during daylight when they rest on

the ground or sit in stillness on tree branches. It is very difficult to capture photos of this bird. This nightjar feeds on insects and night butterflies that it catches while flying. It's a migratory bird and winters in South Africa. It mainly resides in broad-leaved forests and open areas. It incubates 1-2 times a year. This bird does not built a nest for its two gray and brown eggs are placed directly on the ground. Its body length is 24-28 cm, with a wingspan of 52-59 cm. We were not able to capture nightjar, but its song is heard over many parts of the park.

Black woodpecker (*Dryocopusmartius*)



The black woodpecker is the largest of its species in Europe and Asia. This crow-sized bird is entirely black save a red crown. In males, the entire crown is red but in females, only the upper back part is red, while the rest of the body utterly black. It is listed among species in danger by the IUCN. The black woodpecker resides old broad-leaved, coniferous, and mixed woodlands.

During winter season, it descends to lower regions and can even be observed in urban areas. It's a non-migratory bird. The black woodpecker feeds on insects, maggots, and tree seeds. It builds its nest in tree hollows that it

excavates, with its hollows being larger than those of other woodpeckers. It incubates once a year. The length of its body is about 46-65 cm, while the wingspan is 64-84 cm. The black woodpecker can be observed all over the park, but mostly in the beech and hornbeam parts of the forest.

European bee-eater (*Meropsapiaster*)



The European bee-eater is a slim-bodied, multicolored bird. It features a brown and yellow upper part, green wings, and a black beak. Its yellowish throat contrasts with its blue chest and belly. It is reckoned among

the most beautiful birds in Europe. Although it has an ill-reputation of occasional attacks on beehives, its impact on domestic bee population is less than 1 %. This bird resides in spacious mountain areas, meadows, riverbanks, and agricultural lands. In Gërmia, it can be observed in many places. A colony with five pairs is to be found at the park entrance, namely in the pine section, where they build tunnel-like nests on tree hollows. Beside mountain bees, it feeds on dragonflies and wasps. The length of the body ranges from 25-29 cm, while the wingspan is from 36 to 40 cm.

Long-eared Owl

(*Asiootus*)



The long-eared owl is a nocturnal, predatory bird of medium size. It features brown feathers intersected with vertical lines along its belly and chest. A peculiarity of this bird is its long ear tufts, which are

longer than those of the short-eared owl. Its face is

janë më të gjatë se tëbufit veshshkurtër. Ka fytyrë nëformë disku dhe sy portokalli. Arsyeja e ekzistencës sëkëtyre tufave të veshit nuk dihen, por mes biologëve dhe ornitologëve mendohet se ato janë mjet i komunikimit mes tyre kryesisht tëgjendjeve emocionale dhe shpirtërore. Rri në pyje gjethegjera, gardhe shkurresh, si dhe në kopshte e parqe të qytetit.Në Gërmi,folezon në hyrje të parkut dhe nuk shtegton. Bufi veshgjatë vështirë shihet gjatë ditës. Ushqehet kryesisht me brejtës. Inkubon një herë në vit dhe shpesh përdor folenë e shpendëve të tjerë. Është i gjatë 31-37cm, kursegjatësia e hapjes së krahëveështë 86-102cm.

Mbretthi

(*Regulus regulus*)



Mbretthi është zog u më i vogël në Evropë dhe peshon vetëm 4.5-7 gramë. Ka shpinë jeshile, krahë në të zezë me vija të bardha dhe barkëngjyrë të zbehtë. Karakteristikë është kreshta e ndritshme e kokës, e verdhë në portokalli dhe e kufizuar me vija të zeza te mashkulli,kurse e verdhë te femra. Ushqehet me

insekte dhe merimanga, duke u zvarritur nëpër degë dhe gjethe. Rri në pyje halore, gjethegjera dhe të përziera, nuk shtegton, por gjatë dimrit zbret në zona të ulëta dhe qëndron në grup.Inkubon 1-2 herë në vit. Folenë e ndërton me myshk dhe likene në degët e pemëve.Gjatësia e trupit të tij është 7-8 cm, kursegjatësia e hapjeve të krahëveështë 13-13.5 cm. Në Gërmi ai shihet në pjesën më të madhe të parkut, kryesisht në pyje halore dhe gjethegjera.

Sqeptrash

(*Coccothraustes coccothraustes*)



Sqeptrash është një zog i rëndë me kokë demi, mjekër të vogël dhe me sqep të trashë, prej të cilit edhe e ka marrë emrin. Kokën e ka ngjyrë portokalli dhe kafe me një shirit te syri, kurse bishtin e ka të zi. Pjesët e sipërme i ka kafe të errëta,

ndërsa pjesët e poshtme portokalli. Krahët i ka të zinj me fund të kaltër të ndezur dhe me një njollë të bardhë në mes të krahëve. Sqepi i trashë dhe i fuqishëm, në formë koni dhe me ngjyrë metalike, i shërben për të ngrënë farat dhe kokrrat e frutave, veçanërisht ato të qershive, të cilat i çan me të. Sqeptrash shihet në të gjithë parkun, ndonëse është vështirë për ta parë. Rri larg njeriut. Gjatë dimrit shihet dhe në Touk-Bahçe. Shihet edhe në parqe dhe kopshte urbane. Dimrit zbret në zona të ulëta.Inkubon një herë në vit. Folenë e ndërton në shkurre ose nëpemë.Gjatësia e trupit të tij është16-18 cm, kursegjatësia e hapjeve të krahëveështë 29-33 cm.

Ujku

(*Canis lupus*)



Ujku është një grabitqar që në natyrë shpesh ngatërrohet me çakejtë, madje edhe me qentë. Karakteristikat dalluese të ujkut janë: kokë më e madhe, fytyrë më e gjerë, veshë më të shkurtër dhe bisht më i gjatë. Ujku ka një trup të

hollë dhe të gjatë. Koka e ujkut është e madhe dhe e rëndë, me ballë të gjerë dhe nofulla të forta. Këmbët janë relativisht të gjata, gjë që i mundëson të lëvizë shpejt dhe të kapërcejë pengesat apo borën e thellë. Ujku është i specializuar për gjueti në grup, për të vlarë gjahun e tij. Ngjyrat e ujkut janë zakonisht e bardha, kafe, gri dhe e zeza me lara, megjithëse mund të jenë i tërii bardhë, ose i zi. Ujqërit janë shumë territorialë dhe luftimet për territor janë ndër shkaqet kryesore të vdekshmërisë. Ujqërit kanë një histori të gjatë me njerëzit, duke u përbuzur dhe gjuajtur në pjesën më të madhe të botës, për shkak të sulmeve të tyre ndaj bagëtive. Megjithëse ekziston frika nga ujqërit, në shumë shoqëri njerëzore, shumica e sulmeve të regjistruara ndaj njerëzve u janë atribuar kafshëve që vuajnë nga tërbimi.

Ujku është kryesisht mishngrënës dhe ushqehet me gjitarë të mëdhenj, si dhe me kafshë më të vogla.

Deri më tani, nga vëzhgimet dhe informacionin e marrë nga terreni, kemi arritur të gjejmë dy familje ujqërish në Parkun e Gërmisë. Një familje me rreth 6 anëtarë dhe një familje me 3 meshkuj (për shkak të gjuetisë së paligjshme brenda parkut, nuk do të specifikojmë territoret e tyre).

Kaprolli

(*Capreolus capreolus*)



Kaprolli, i njohur edhe si kaprolli evropian, është një lloj dreri i vogël, i kuqërremtë dhe gri-kafe, i përshtatur mirë me mjediset e ftohta. Ka brirë të gjatë

rreth 20 cm -25 cm, secili sish me dy ose tre brirë të vetëm. Kur brirët e mashkullit fillojnë të rriten, ata mbulohen me një shtresë të hollë qimesh prej kadifeje, e cila më vonë zhduket. Femra shkon në kërkim të një partneri dhe zakonisht e josh atë në territorin e saj përpara se të çiftëzohet. Habitat i tij janë pyjet e dendura halore ose të përziera, fushat e izoluar në mes të pyjeve, si dhe tokat bujqësore.Ushqehet kryesisht me bar, gjethe, manaferra dhe fruta mali.Kaprolli është në zhdukje e sipër në Parkun e Gërmisë. Për pesë vjet, arritëm ta fotografonim vetëm një herë me kamerë-kurth.

disc-shaped with orange eyes. The purpose of its ear tufts is not known as of yet, but biologists and ornithologists believe they may function as a means of communication for expressing emotional states. This owl resides in broad-leaved forests, tree fences, gardens, and city parks. In Gërmia, it nests near the park entrance and is considered a non-migratory bird. The long-eared owl is barely seen during daylight. It mainly feeds on rodents, while it incubates once a year, often using the nests of other birds. Its body length ranges from 31-37 cm, with a wingspan of 86 to 102 cm.

Goldcrest

(*Regulusregulus*)



The goldcrest is the smallest European bird, weighing only 4.5-7 grams. It has a greenish back, black wings dotted with white lines, and a pale belly. A distinctive feature is its bright crest, with a yellow color varying to orange and confined with black lines in males and yellow in females.

The goldcrest feeds on insects

and spiders, hopping along tree branches and leaves. This bird resides in coniferous, broad-leaved, and mixed woodlands. As a non-migratory bird, it descends to lower areas during winter. It incubates 1-2 times a year, building its nest with moss and lichens in tree branches. The length of bird's body is 7-8 cm, with a wingspan varying to 13-13.5 cm. In Gërmia, the goldcrest can be found throughout most of the park area, especially in the coniferous and broad-leaved sections. During winter season, it often moves in groups.

Hawfinch

(*Coccothraustescoccothraustes*)



The hawfinch is a large bird with a bull-headed outlook and a thick beak, from which its name derives. Its head is of orange-brown with a peculiar eye stripe. Its beard is rather small, while it features a black tail. The

hawfinch's upper parts are dark brown, while the lower parts are orange. Its wings are black with a bright blue tip on the end and a distinctively white spot in the middle. The hawfinch has a thick, huge cone-shaped beak with a metallic tinge, enabling it to crush fruit seeds, especially cherries. This bird can be seen throughout the park area, although it is difficult to see as it keeps its distance from humans. During winter, it descends to lower areas and can even be seen in Taukbashçe, city parks, and gardens. It incubates once a year. The hawfinch nests on bushes and trees. Its body's length consists of 16-18 cm, with a wingspan of 29-33 cm.

Wolf

(*Canis lupus*)



The wolf is a predatory animal often confounded for jackals and dogs. Distinguishing features of a wolf include a large head, broad face, short ears, and a long tail. The wolf's body is slim and long, with a large, heavy head, wide

forehead, and strong jaws. Its legs are comparatively long, allowing to move fast and overcoming obstacles or deep snow. Wolves are specialized for group hunting, and to kill their prey. The colors of a wolf are usually white, brown, gray, and pied black, although they can be all white or black. Wolves are highly territorial, with territorial struggles being a leading cause for their mortality. They have a very long history with humans, often being disdained and hunted in the most part of the world on account of their attacks on livestock. Despite the fear of wolves, in many human societies most recorded attacks are assigned to diseased animals. This species is largely carnivorous, feeding on both large and small mammals. So far, based on observations and grounds reports, we were able to detect two wolf families in Gërmia Park. One with six members and another one with three males (due to illegal hunting within the park area, their territories intentionally are not specified).

Roe deer

(*Capreoluscapreolus*)



The deer, alternatively known as the European deer, is a small species with a reddish and gray-brown coat, well-adapted to cold

environments. It has antlers that grow up between 20 to 25 cm long, usually with two or three horns. In males, these regrown antlers are covered with a thin layer of velvet-like hairs that are shed over time. A female deer seeks out her partner and often lures them into her territory before mating. Its habitats are dense coniferous and mixed woodlands, fields within forests, and agricultural lands. The deer primarily feeds on grass, leaves, blackberries, and mountain fruits. In Gërmia Park, the deer population is nearly extinct. We could extract only one picture recorded through a trap camera in the past five years.

Hajde në Gollak

Come to Gollak

ARTAN KRASNIQI



“Një varg i gjatë, krejt i blertë kodrinash, shihet nga pothuajse të gjitha lagjet verilindore të Prishtinës. Horizonti që takon të gjelbrën e natyrës dhe të kaltrën e qiellit quhet Gollak.

veç për tri prej tyre. E para trashëgimia kulturore, e dyta bukuritë natyrore dhe e treta vetë njerëzit.

Një varg i gjatë, krejt i blertë kodrinash, shihet nga pothuajse të gjitha lagjet verilindore të Prishtinës. Horizonti që takon të gjelbrën e natyrës dhe të kaltrën e qiellit quhet Gollak. Është mrekulli se sa afër kryeqytetit gjendet një zonë që ofron mundësi të mëdha relaksi dhe freskie. Por, në të njëjtën kohë, edhe potencial zhvillimi.

Janë të shumta arsyet se pse duhet vizituar fshatrat e Gollakut. Por në këtë prezantim të shkurtër, le të diskutojmë

Trashëgimia kulturore e Gollakut është e llojllojshme dhe e pasur. Nëse ndalemi te vlerat materiale të këtij thesari, mund të themi se vizitori do të mund t'i prekë lehtë ato kudo nëpër fshatrat e Gollakut. Kjo zonë, është prej atyre trevave të Kosovës që ka përfaqësim të pothuajse të të gjitha periudhave historike. Ta zëmë, aty janë gjetur artefakte që i takojnë epokës së neolitit (rreth 7 mijë vjet para erës sonë), e që janë më të moçmet që janë gjetur deri tash në Kosovë. Sëpatat e neolitit që u gjetën në Badoc, gjurmët



FOTO: ERMAL META

e vendbanimeve të lashta, përfshirë fortifikatat, tumat ilire, objektet e kultit të krishterë (katolik dhe ortodoks), janë artefaktet e luajtshme e sitet arkeologjike që dëshmojnë për rrënjët e thella të krenarisë dhe traditës së jetesës në këtë trevë. Vendësit ruajnë në diskursin e tyre të përditshëm shumë mikrotoponime fortifikatash, të cilat, pos që flasin për një vazhdimësi të jetës në këto vise, janë thesar i çmuar i trashëgimisë kulturore. Populli i quan Kala, Kulinë, Gjytet, Çukë e Sukë, shumë pika të larta të Gollakut, që kanë



“ A wide range of lush green hills can be seen from almost all northeastern suburbs of Prishtina. This horizon, where greenery meets the blue sky, is called Gollak.

It is indeed a marvel that such a place, offering relaxation and freshness, exists so close to Prishtina. Gollak also holds solid potential for development. There are many reasons to visit the villages of Gollak. However, in this brief overview, we are about to focus on three of them: cultural heritage, natural beauty gems, and the local residents.

Cultural heritage of Gollak is both diverse and rich. Regarding the material values of this treasure, it can be safely

stated that a visitor can easily encounter them throughout Gollak. This particular area represents almost every historical period. For instance, there are artifacts pertaining to the Neolithic era (around 7,000 years B.C), which are the earliest discovered so far in Kosova. Neolithic axes found in Badoc, vestiges of ancient settlements, including forts, Illyrian mound burials, and Christian precincts (both Catholic and Orthodox), are real artifacts and



mundur të jenë strategjike për zhvillimin e jetës së paraardhësve dardanë. Veç mikrotoponimeve, në shumë vendbanime shihen gjurmë të këtyre fortifikatave. Xhami të vjetra, me minare prej druri, sikur ajo e Prapashticës, ia shtojnë larushinë këtij thesari. E ndonëse shumë janë rrënuar, monumentet e shekujve XIX dhe XX, si shtëpi banimi, hane, mullinj, hambarë, kroje, drugdhendje, si objekte jetike të përditshmërisë ruajnë ende ndonjë ekzemplar interesant. Shtëpia e Mulla Ademit është një prej tyre. Mullinjtë e Grashticës së Epërme po ashtu. E krejt këto së bashku, ndonëse të shpërndara, janë një ftesë për vizitorin, aq sa edhe një thirrje në ndërgjegjen tonë për ruajtjen dhe promovimin e tyre.

“ Gollaku është një trevë gjeografike, lartësia mbidetare e së cilës sillet rreth 1 mijë metrave. Administrativisht shtrihet në 9 komuna, e në dy shtete. Përpos në Prishtinë, vendësit e quajnë veten si malësorë të Gollakut edhe në Novobërdë (Artanë), Lipjan, Gjilan, Kamenicë (Dardanë) dhe Podujevë (Besianë) në Kosovë, si dhe në Medvegjë, Bujanoc dhe Lebanë, si komuna kryesisht shqiptare sot në Serbi.

Hapësira kodrinore-malore e kësaj zone të jep ndjesinë përrallore, aty ku imagjinata lëshohet lehtas e shkon larg, për

↑ archeological sites attesting to the ancient roots of pride and living tradition in these parts. The locals preserve fort place-names in their daily discourse, which in turn confirm the continuity of life here and are a priceless treasure of cultural heritage. Residents call these places Kala, Kulinë, Gjytet, Çukë, and Sukë, the uppermost parts of Gollak, which were of strategic importance for the well-being of Dardanian dwellers.

Apart from place-names, the vestiges of these forts can still be seen in many places. Old mosques with wooden minarets, such as the one in Prapashticë, add more to the diversity of this treasure. Despite many being ruined, monuments from the past two centuries, such as residential homes, inns, mills, barns, fountains, and woodcarvings, still preserve startling examples of the daily life at the time. The house of Mulla Ademi and the Mills of Upper Grashticë are among them. When pieced together, all these scattered gems are an invitation for visitors, as well as a call for us to preserve and promote them.

Gollak is a geographical area with an altitude of about 1,000 meters above sea level. Administratively, it comprises nine municipalities in two states. Besides in Prishtina, locals identify themselves as Gollak highlanders in Novobërdë (Artanë), Lipjan, Gjilan, Kamenicë (Dardanë), and Podujevë

të mos u tretur sikurse në rrëfimet e gjyshes a gjyshit. Shikimi sfidohet nga largësia e kthjellët.

Shpendë që të sillen mbi kokë në lartësi të ndryshme dhe kafshët e buta – e ndonjë që sfidon veten shtigjeve të shumta malore mund ta takojë edhe ndonjë të egër – janë miqtë më të mirë të qëndrimit në këtë zonë. Imagjinojeni momentin kur zhurma e insekteve të ndryshme bashkë me fëshfërimën e gjetheve dhe qetësia shkrihen në një, si terapi për trurin.

Është e vërtetë, pandemia COVID-19 bëri që shumë njerëz t'i kthejnë sytë kah fshatrat e Gollakut. Nën tryshninë e izolimit, iu rikonfirmua vlera e lirisë, e lidhur me natyrën.

Njerëzit e Gollakut janë prototipi i atij modelit të shqiptarit e shqiptares që përshkruhet në traditë. Aso vlerash që ia numërojmë vetes kur duam të krenohemi. Njerëz të fjalës së mbajtur, tejet miqësorë e fisnikë, mikpritës e solidarë, të ashpër e të butë njëkohësisht. Ndonjëherë modestë deri në tepri. Natyrisht, këto janë vlerat mbizotëruese, me të cilat u kultivuan brezat. Por kjo s'do të thotë se secili që u rrit në Gollak a ka prejardhjen prej atje është një me këto vlera. Fundja, ka kohë që edhe Gollaku ka prekur modernen, dhe individualja është vlerë, po aq sa kolektivja edhe në këtë anë.

Shumë vila e bujtina, restorante dhe variante të tjera të kulinarisë janë ngritur së fundi gjithandej fshatrave të Gollakut. Këto, bashkë me rrugët e ndërtuara dhe ato që priten të ndërtohen, e bëjnë më të lehtë shkuarjen dhe qëndrimin në këtë anë. Por ftesa e njëmendtë për të vizituar Gollakun, më tepër se në to, qëndron minimalisht në aspektet e trajtuara kalimthi në këtë shkrim. Pjesa tjetër e eksplorimit ju takon juve.

(Besianë) in Kosova, and Medvegjë, Bujanoc, and Lebanë in Serbia.

“ The mountainous terrain of this area offers a fairy sensation, a place where imagination easily takes flight and goes far, without fading away as in the stories told by grandparents.

Clear spots on the distant horizon are a common sight. There are birds flying overhead, and domesticated animals are all around – and those who venture on mountain roads may encounter wild animals – are the best friends while staying in these parts. Imagine that blessed moment when the buzzing noises of insects and the rustling of leaves merge with tranquility, offering the much-needed therapeutic experience for the mind. It is true that the pandemic caused many people to look towards

Gollak's villages. In the austere isolation measures, the value of freedom connected with nature was fully confirmed.

Gollak's residents are exemplary Albanians as described in tradition. They embody values that we are fond to take pride. They are loyal people, very friendly and noble, hospitable and solidary, sturdy and gentle at the same time. They are excessively humble at times. These preponderant values have been handed down through generations. However, this does not mean that everyone who born or raised in Gollak shares all these these values. Moreover, Gollak has long been affected by modernity, and individualism is valued there as much as collectivism.

Recently, many villas, motels, restaurants, and other culinary establishments have emerged in Gollak's villages. Along with the newly built roads and those under construction, traveling and staying in these parts has become much easier. Nonetheless, the real invitation to visit Gollak lies beyond these aspects passingly mentioned in this article. The rest of the exploration depends on you.



MODERNIZIMI I JETËS NË
FSHATRAT E GOLLAKUT

Bagëti me GPS

MODERNIZATION OF LIFE
IN GOLLAK'S VILLAGES

Livestock with GPS

NAZIM ZULLUFI

Pas një mungese prej 15 vjetësh, vendosa të ndërmarra një udhëtim njëjavor në fshatrat e Gollakut, rajoni i dashur prej nga vij dhe ku jam rritur. Fshatrat Gllogovicë, Dabishec, Prapashticë dhe Hajkobillë më kanë lënë gjithmonë një ndjesi të veçantë, për shkak të lidhjes së fortë emocionale që kam me to. U nisa me një ndjenjë nostalgjie dhe plot kureshtje, i etur për të parë se si kishte vazhduar jeta në këto vende pas kaq shumë vjetësh.

Që në momentin kur mbërrita, u përballa me një mikpritje të ngrohtë dhe të sinqertë nga banorët, një traditë që kishte mbetur e pandryshuar pavarësisht modernizimit të gjithanshëm. Mikpritja e fshatarëve ishte e vetmja gjë që kishte mbetur po aq e fortë dhe e gjallë sa më parë. Kjo ndjenjë ngrohtësie dhe mikpritjeje

më bëri të ndihem menjëherë si në shtëpi.

Kur mbërrita, u përballa me një pamje krejtësisht të ndryshuar. Këto fshatra, dikur të njohura për thjeshtësinë dhe jetën tradicionale, ishin transformuar në vendbanime moderne dhe të përparuara. Gjatë udhëtitimit tim njëjavor, pata mundësinë të bisedoj me banorët dhe të vëzhgoj nga afër ndryshimet e shumta që kishin ndodhur.

Një nga ndryshimet më të dukshme ishte reduktimi i numrit të banorëve lokalë. Shumë nga fshatarët vendës ishin larguar, ndërsa gjithandej ishin ndërtuar vila moderne, kryesisht për banorët e rinj që po e shohin shkuarjen në këto fshatra si një mundësi për relaks dhe pushim. Kushtet e jetesës ishin përmirësuar dukshëm, duke e bërë jetën në fshat më të rehatshme dhe të përshtatshme për shekullin e 21-të.

After a 15-year absence, I decided to set out a one-week journey to the villages of Gollak, my beloved region where I was raised. The villages Gllogovicë, Dabishec, Prapashticë, and Hajkobillë have always given me a unique feeling stemming from my strong emotional attachment to them. Filled with a pervading nostalgia and curiosity, I commenced eager to see how life progressed in these places after so many years.

Upon my arrival, I was met with warm and candid hospitality from the locals, a tradition that has remained intact despite thorough modernization. Nonetheless, I encountered a scenery that has utterly changed. These villages, once known for their simplicity and traditional lifestyles, have been transformed into modern and developed settlements. During my one-week journey, I had the chance to converse with the locals and closely observe the many changes that have occurred.

One of the most perceptible changes was the shrinking numbers of local residents. Many have migrated, while there are so many modern villas built largely for the new residents that find these villages as an opportunity for relaxation and vacation. Living conditions have greatly changed, making countryside life so comfortable and suitable for the 21st century.

Technology has become deeply ingrained in the daily life of the locals. Cultivation of the land is carried out with modern industrial vehicles,



Teknologjia kishte hyrë thellë në jetën e përditshme të banorëve. Toka punohej me mjete krejtësisht moderne industriale, duke e bërë bujqësinë më efikase dhe produktive. Megjithatë, ajo që më befasoi më shumë ishte sistemi i ri për ruajtjen e gjedheve që kishte sjellë një ndryshim rrënjësor në mënyrën se si barinjtë kujdeseshin për tufat e tyre.

Barinjtë e Gollakut kishin adoptuar teknologjinë më të fundit duke vendosur GPS në gjedhët e tyre. Ky sistem inovativ u lejonte atyre të monitoronin dhe kujdeseshin për tufat duke ndenjur brenda shtëpive të tyre. Me një pajisje të thjeshtë, mund të ndiqnin lëvizjet e gjedhëve në kohë reale, duke u siguruar që asnjë prej tyre të mos humbiste apo të përballej me ndonjë rrezik.

Përmes një aplikacioni të instaluar në telefonat e tyre, barinjtë mund të kontrollonin gjedhët në çdo moment. Nëse një gjedh dilte jashtë zonës së caktuar, sistemi dërgonte një alarm, duke i lajmëruar barinjtë për të ndërmarrë veprimet e nevojshme. Kjo teknologji u ofronte një qetësi mendore



rendering farming much more efficient and productive. However, what amazed me the most was the new system for tending livestock, which has engendered a radical change in the way how herdsmen tend their flocks.

The herdsmen in Gollak have adopted the last technologies, placing GPS on their cattle. This innovative system enables them to monitor and tend to their flocks from their homes. With such devices, they can track cattle's movements in real-time, ensuring that no one go missing or face any danger.

Through an app installed on

their phones, herdsmen could control their livestock at all times. If any of cattle went outside a designated area, the system transmits an alarm, urging them to take measures. This technology provides a sense of security and full control over their flocks, thus minimizing the risk of loss and increasing efficiency in managing livestock. One of them, with whom I happened to converse, Agim, spoke proudly about how this new technology has changed his life. He explained that he can now care of his flock while staying home, an achievement he called most welcome. Agim recounted about past years when he spent

Shumë nga fshatarët vendës ishin larguar, ndërsa gjithandej ishin ndërtuar vila moderne, kryesisht për banorët e rinj që po e shohin shkuarjen në këto fshatra si një mundësi për relaks dhe pushim.

“

Many have migrated, while there are so many modern villas built largely for the new residents that find these villages as an opportunity for relaxation and vacation.

dhe një kontroll të plotë mbi tufat e tyre, duke minimizuar rrezikun e humbjes dhe duke rritur efikasitetin në menaxhimin e blegtorisë. Një prej barinjve me të cilin bisedova, Agimi, tregonte me krenari se si teknologjia e re i kishte ndryshuar jetën. Ai tregonte se si tashmë mund të kujdeset që nga shtëpia për kafshët e tij. E cilësonte këtë ndryshim të madh e të mirëpritur. Ai, po ashtu, tregoi se si dikur kalonte orë të tëra në kërkim të gjedhëve që shpërndaheshin nëpër male, ndërsa tani, falë sistemit të GPS-it, kishte më shumë kohë për familjen dhe për aktivitete të tjera.

Modernizimi i jetës në fshatrat e Gollakut është një shembull i qartë se si teknologjia mund të përmirësojë jetën e njerëzve, edhe në zonat më të thella rurale. Vendosja e GPS-it në gjedhë tregon se si inovacioni mund të përmirësojë jo vetëm efikasitetin, por edhe cilësinë e jetesës së banorëve. Banorët e rinj, por edhe ata të vjetër, po e përqafojnë këtë transformim, duke e bërë jetën në fshat më të rehatshme dhe më të lidhur me

teknologjinë moderne.

Përveç përparimeve teknologjike, këto fshatra kanë përjetuar një evoluim paralel kulturor që i afron gjithnjë e më shumë me qytetet. Aktivitetet kulturore, ngjarjet sociale dhe infrastruktura e re e ndërtuar kanë krijuar një mjedis ku banorët mund të shijojnë një cilësi jete të ngjashme me atë të qytetit, por me përfitimet shtesë të qetësisë dhe bukurisë natyrore që ofrojnë këto zona rurale.

Fshatrat e Gollakut janë një dëshmi e qartë se si teknologjia dhe kultura mund të bashkëjetojnë harmonikisht, duke sjellë një të ardhme më të ndritur dhe më të suksesshme për të gjithë banorët. Kjo ekspeditë më kujtoi se sa e rëndësishme është të ruajmë lidhjet me rrënjët tona, ndërsa përqafojmë ndryshimet që sjell e ardhmja. Gollaku, me ndryshimet dhe përparimet e tij, mbetet një vend i veçantë për mua, një simbol i bashkëjetesës së traditës dhe përparimit, dhe një shembull i shkëlqyer se si mund të evoluojnë fshatrat paralelisht me qytetet.

hours searching for his cattle that roamed back and forth in mountains, while now, thanks to GPS-system, he has more time to spend for his family and other activities.

The modernization of life in Gollak's villages is an outstanding example of how technology can trigger an improvement into people's lives, even in the most remote rural areas. Implementing GPS on cattle showcases how the innovation improves not only efficiency but also enhances the quality of life for locals. Both young and old are embracing these changes, making life much more comfortable and aligned with modern technology.

Beside technological advancements, these villages have undergone a simultaneous cultural evolution that brings them closer to city. Cultural activities, social events, and new infrastructure engendered an environment where residents can enjoy a quality of life similar to that of the city, but with the added benefits of tranquility and natural beauties of these areas.

Gollak's villages provide a tangible evidence how both technology and culture can coexist harmoniously, bringing a brighter and successful future for all residents. This journey made me ponder on the importance of maintaining a connection with our roots while endorsing the changes that future brings. With all its evolutions and advancements, Gollak remains a special area for me, a symbol of coexistence of both tradition and progress as well as an example that villages could fare well with the cities in their evolution.



Prishtina është sofra e madhe, pranë së cilës, gjithkush ndihet i plotësuar. Është qendër e rëndësishme kulturore dhe ekonomike.

Foto (Ermal Meta): Motiv nga shtëpia monumentale e Emin Gjikut, tash pjesë e Muzeut Etnologjik të Kosovës.



Prishtina is a great table where everyone feels fulfilled. It is an important cultural and economic centre.

Photo (Ermal Meta): A motif from the monumental house of Emin Gjiku, now part of Ethnological Museum of Kosova



KOSOVA AIRLINES eurokoha

flyksa.com | eurokoha.eu

